

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6848
E martë, 14 mars 2023
çmimi 0.40 €

NJË RAPORT KUNDËRSHQIPTAR SI AI I DIK MËRTIT!

FAQE 9

Shkruan:
Kudusi LAMA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI THOTË SE JANË DUKE I TRAJTUAR MODELET PËR ASOCIACIONIN

FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të hënën se këshilltarët e tij dhe disa nga ministrat janë duke i trajtuar 15 modelet për Asociacionin që emisari i BE-së për

dialogun, Miroslav Lajčak, ia ka ofruar atij. Kurti ka theksuar se nga këto modele të trajtimit të pakicave kombëtare në Bashkimin Evropian, do të shohin të marrin elementë që

edhe pakicat në Kosovë të jenë në nivelin e duhur. Por, nënvizoi se nuk do të bëjë kompromis me kushtetutshmërinë, ligjshmërinë dhe funksionimin e shtetit

ARRESTOHEN PESË PERSONA TË DYSHUAR PËR PËRFSHIRJE NË TRAFIKIM TË ARMËVE

FAQE 7



LUFTA KUNDËR MIGRIMIT ILEGAL: BE-ja DO MË SHUMË BASHKËPUNIM NGA BALLKANI PERËNDIMOR

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



**LUFTIME TË ASHPRA NË BAHMUT,
RAPORTOHET PËR HUMBJE TË
MËDHA** F. 2

**DEPUTETËT UDHËTOJNË JASHTË
SHTETIT, KËTË JAVË S'KA SEANCË
PLENARE** F. 7

**GUVERNATORI I BQK-SË NJOFTON
PËRFAQËSUESIT E FMN-SË PËR
SEKTORIN FINANCIAR** F. 5

EKONOMI



**MË SHTRËNJTË PRODHIMET "MADE
IN KOSOVA" SE ATO TË HUAJAT** F. 8

**UNIVERSITETI AMERIKAN
MBËSHËTET MINISTRINË E
EKONOMISË NË ZBATIMIN E
STRATEGJISË SË ENERGJISË** F. 8

SPORT



**PRISHTINA SHKARKON
MUNISHIN** F. 10



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Luftime të ashpra në Bahmut, raportohet për humbje të mëdha



KIEV, 13 MARS - Ukraina dhe Rusia janë duke raportuar për humbje të mëdha teksa vazhdon beteja në qytetin ukrainas Bahmut. Moska është duke tentuar që disa muaj që ta fitojë kontrollin e këtij qyteti në lindje të Ukrainës. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se forcat ruse janë përballur me më shumë se 1 100 vdekje në ditët e fundit dhe ka më shumë njerëz të plagosur seriozisht. Rusia ka thënë se ka vrarë më shumë se 220 pjesëtarë të ushtrisë ukrainase në 24 orët e fundit. Analistët kanë thënë se Bahmuti ka vlerë të vogël strategjike, mirëpo e ka marrë vëmendjen kryesore të komandantëve rusë të

cilët janë në kërkim të ndonjë lajmi pozitiv për Kremlinin. Kapja e qytetit do t'i ndihmonte Rusisë për jetësimin e synimit të saj për të kontrolluar gjithë rajonin ukrainas të Donjeckut. Donjecku është një prej katër rajoneve në lindje dhe jug të Ukrainës, që është aneksuar nga Rusia në shtatorin e vitit të kaluar, pas referendumeve që Perëndimi i ka konsideruar të rreme. Para luftës në Bahmut kanë jetuar rreth 70 000 njerëz, mirëpo tani vetëm pak mijëra kanë mbetur aty. Ky qytet dikur është njohur për minierat e kripës dhe veraritë e mëdha. Sikurse Rusia, edhe Ukraina i ka dhënë Bahmutit rëndësi politike,

pasi Zelensky e ka kthyer qytetin në embleme të rezistencës. Sipas vlerësimeve të Perëndimit, mes 20 000 - 30 000 trupa ushtarake ruse janë vrarë apo janë plagosur deri më tani, në apo rreth Bahmutit. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Presidenti kinez bën thirrje që ushtria e shtetit të bëhet "mur i fortë çeliku"

PEKIN, 13 MARS - Presidenti kinez Xi Jinping ka thënë se dëshiron ta kthejë ushtrinë kineze në një "mur të fortë çeliku" teksa ka mbajtur një fjalim në Kongresin Popullor. "Ne duhet të promovojmë modernizimin e mbrojtjes kombëtare dhe formësimin të ushtrisë dhe ta ndërtojmë ushtrinë si mur të fortë çeliku që ruan sovranitetin kombëtar, sigurinë dhe interesat zhvillimore", ka thënë Xi. Këtë vit Kongresi ka miratuar një rritje prej 7.2-përqindësh në shpenzime ushtarake, shifër më e madhe sesa ishte planifikuar në të

kaluarën. Ai ka përmendur edhe planet e Pekinit për "unifikim" me Tajvanin, ndonëse ka folur me ton të kujdesshëm. Presidenti kinez nuk i ka përsëritur deklaratat e së kaluarës se Pekini do ta kontrollojë këtë ishull qoftë edhe përmes forcës ushtarake. "Ne duhet ta implementojmë një strategji të partisë për zgjidhjen e çështjes së Tajvanit në epokën e re, të ecim drejt parimit të një Kine dhe konsensusit të vitit 1992, dhe të promovojmë një zhvillim paqësor të marrëdhënieve, ta kundërshtojmë ndërhyrjen e

forcave të jashtme dhe ta çojmë përpara procesin e unifikimit të tokës armë", ka thënë ai para gati 3 000 delegatëve të Kongresit. Tajvani, ishull që vetëqeveriset, nuk ka qenë kurrë pjesë e Kinës. Ky shtet e ka qeverinë e vet prej vitit 1949, mirëpo Pekini e konsideron Tajvanin vend me 23 milionë banorë si pjesë të territorit të tij. Pas luftës së Rusisë në Ukrainë, e cila ka nisur më 24 shkurt 2022, ka pasur shqetësime se edhe Kina mund ta përdorë forcën ushtarake për t'i zgjidhur pretendimet territoriale me Tajvanin.



Presidenti zviceran mbron neutralitetin



BERN, 13 MARS - Neutraliteti zviceran është më i rëndësishëm se kurrë, tha presidenti Alain Berset në një intervistë të botuar të dielën, duke mbrojtur vendimin e diskutueshëm për ndalimin e transferimit të armëve të prodhimit zviceran në Ukrainë. "Armët zvicerane nuk duhet të përdoren në luftëra", tha ai për revistën e përjavshme "NZZ am Sonntag". Tradita e gjatë e neutralitetit është debatuar ashpër që prej

sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës në shkurt 2022. Vendi i pasur alpin, i cili nuk është anëtar i Bashkimit Evropian, ka ndjekur shembullin e bllokut për sanksionet ndaj Moskës, por deri më tani ka treguar pak fleksibilitet për neutralitetin e tij ushtarak. Pavarësisht prej presionit nga Kievi dhe aleatët e saj, Zvicra nuk ka lejuar që vendet që kanë armë të prodhimit gjerman t'i rieksportojnë ato në Ukrainë.


Berset i tha NZZ-së se politika bazohej në "angazhimin për paqen, për të drejtën humanitare, për ndërmjetësimin aty ku ishte e mundur". Roli i Zvicrës si selia e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Konventave të Gjenevës, si dhe e selisë evropiane të Kombeve të Bashkuara, "pasqyrohet në ligjet tona, përfshirë ato që lidhen me eksportin e armëve", tha ai.

Sërish greva në disa aeroporte gjermane

HAMBURG, 13 MARS - Pasagjerët në Gjermani do të duhet të përgatiten për vonesa të konsiderueshme apo edhe anulime të fluturimeve për shkak të grevave të stafit të aeroporteve. Sipas Sindikatës së Punëtorëve, Verdi, aeroporti i Berlinit

dhe aeroportet e Hamburgut dhe Bremenit, do të jenë në grevë gjithë ditën e hënë. Kjo grevë pritet të ndikojë edhe në aeroportet e tjera. Aeroportet u kanë bërë thirrje udhëtarëve t'i kontaktojnë kompanitë e tyre për të kuptuar më shumë për fluturimet.

Në Hamburg besohet se 2 000 punëtorë do të jenë pjesë e grevës. Sindikata gjermane e punëtorëve Verdi ka thënë në të kaluarën se përpjekjet për ta përmirësuar situatën për punëtorët e këtij sektori kanë rezultuar me pak përparim.



Lufta kundër migrimit ilegal: BE-ja do më shumë bashkëpunim nga Ballkani Perëndimor



BRUKSEL, 13 MARS - Bashkimi Evropian vazhdon të jetë i shqetësuar me numrin e madh të imigrantëve ilegalë të cilët shfrytëzojnë të ashtuquajturën "Rrugë të Ballkanit Perëndimor" për të hyrë në territorin e BE-së, edhe pse disa shifra, sipas Komisionit Evropian, janë në rënie.

Krahas kësaj vazhdon të jetë relativisht i lartë edhe numri i azilkërkuesve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, sidomos nëse merret parasysh se ato konsiderohen "vende të sigurta". BE-ja dëshiron t'i luftojë këto dy fenomene dhe për këtë, thonë në Bruksel, janë duke bashkëpunuar me autoritetet e këtij rajoni.

Problemi më i madh, thonë në BE, është me shtetasit e Shqipërisë të cilët hyjnë në BE, stacionohen në veri të Francës dhe, pastaj, përmes Kanalit Anglez, kalojnë në Britani të Madhe.

Edhe pse Britania e Madhe nuk është më anëtare e BE-së, ky problem paraqet sfidë edhe për autoritetet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, sidomos Francës. Megjithatë, shqetësimi

më i madh në BE, kur bëhet fjalë për rajonin e Ballkanit Perëndimor, ka të bëjë me shtetasit e vendeve të treta që përmes këtij rajoni arrijnë në BE. Numri i tyre është rritur dukshëm në dy vjetët e fundit, duke e bërë këtë rajon ndër rrugët kryesore në Evropë për imigrimin ilegal.

Një prej problemeve, thonë burimet në BE, është politika e vizave që disa vende të rajonit kanë për vendet e treta. Qytetarët e këtyre të fundit kanë shfrytëzuar mundësinë e shkuarjes pa viza në ndonjë vend të rajonit, e pastaj ilegalisht kanë kaluar në BE.

Sipas burimeve të Komisionit Evropian, është një numër i madh i atyre që kanë arritur në vendet e Ballkanit pa viza dhe kanë kërkuar azil në vendet e BE-së.

Ndër vendet më problematike në këtë drejtim është Serbia. Atje mund të udhëtojnë pa viza shtetasit nga Kuba, Tunizia, Burundi, Kina, Rusia dhe disa vende të tjera. Dhe, pikërisht, numri i qytetarëve nga këto shtete që kanë kërkuar azil në vendet e BE-së është rritur.

Këtë e dëshmon edhe rasti i Kroacisë, që ka parë rritje të madhe të azilkërkuesve. Numri më i madh i tyre është nga Burundi, Rusia, Kuba dhe Turqia. Kroacia është bërë anëtare e BE-së në vitin 2013, ndërsa prej 1 janarit të këtij viti është edhe pjesë e Schengenit - zonë e lëvizjes së lirë në Evropë, në të cilën nuk ekzistojnë kontrolle kufitare mes shteteve. Pra, kur dikush hyn në territorin e Kroacisë, ai mund të lëvizë pa asnjë kontroll në rreth 30 vende evropiane.

Vitin e kaluar, përkatësisht deri në nëntor, numri i atyre që kanë hyrë ilegalisht në Kroaci ka qenë mbi 36 000. Shifra paraqet rritje për afër 150 për qind krahasuar me një vit më herët.

Kroacia ka kufirin më të gjatë të jashtëm të BE-së, në gjatësi prej 1 350 kilometrash, i cili, nga 1 janari i këtij viti, është edhe kufi i jashtëm i zonës Schengen. Andaj, BE-ja kërkon që Kroacia ta rrisë sigurinë në kufi.

BE-ja kërkon edhe nga vendet e tjera të Ballkanit që ta përshtatin politikën e tyre të vizave me atë të Bashkimit Evropian. Këtë, madje, e ka përmendur edhe si

kusht për ta mbajtur në fuqi liberalizimin e vizave me to.

Të enjten e kaluar, kur është miratuar vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën, është përmendur bashkëpunimi i Kosovës në përshtatjen e politikës së vizave me atë të BE-së.

Serbia, vendi që, deri më tash, është shfrytëzuar më së shumti si transit për të kaluar në BE, ka premtuar se do ta përshtatë regjimin e vizave. Kjo, sipas zyrtarëve të BE-së, është duke dhënë tashmë rezultate.

Strategji të tjera të bashkëpunimit janë edhe përshtatimi i procesit të ripranimit dhe bashkëpunimi i autoriteteve të vendeve të rajonit me Frontex-in, agjencinë evropiane për ruajtjen e kufijve. Frontex tash e disa vjet ndodhet në kufijtë e vendeve të rajonit me vendet e BE-së, ndërsa tash janë duke u përgatitur edhe marrëveshje, sipas të cilave, do të shtohet prania e personelit të Frontex-it edhe në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Një prej ndryshimeve të rëndësishme është mundësia që personeli i Frontex-it të veprojë

brenda territorit të vendeve të rajonit e jo vetëm në kufijtë e tyre. Pjesëtarët e Frontex-it do të kenë mundësi që t'i kontrollojnë personat, apo mjetet e dyshuara të transportit jo vetëm në kufirin e Bosnjë-Hercegovinës me Kroacinë, por edhe në atë me Malin e Zi dhe Serbinë.

Në BE e shohin këtë si të rëndësishme sepse, siç thuhet, do të rritet mundësia që të vëzhgohen lëvizjet e imigrantëve ilegalë edhe brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor përpara se ata të hyjnë në territorin e Bashkimit Evropian.

Disa ministra të Brendshëm të vendeve të BE-së kanë thënë, po ashtu, se do të kërkohet nga vendet e Ballkanit që t'i pranojnë jo vetëm shtetasit e tyre që i dëbon BE-ja, por edhe shtetasit e vendeve të tjera për të cilët dëshmohej se kanë kaluar përmes tyre drejt BE-së.

Në BE thonë se edhe e drejta ndërkombëtare parashihet që imigrantët ilegalë të kthehen në vendin nga i cili kanë hyrë, e që konsiderohet vend i sigurt. Statusin e "vendit të sigurt" e kanë të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. /REL/



Kurti thotë se janë duke i trajtuar modelet për Asociacionin

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të hënën se këshilltarët e tij dhe disa nga ministrat janë duke i trajtuar 15 modelet për Asociacionin që emisari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, ia ka ofruar atij. Kurti ka theksuar se nga këto modele të trajtimit të pakicave kombëtare në Bashkimin Evropian, do të shohin të marrin elementë që edhe pakicat në Kosovë të jenë në nivelin e duhur. Por, nënvizoi se nuk do të bëjë kompromis me kushtetutshmërinë, ligjshmërinë dhe funksionimin e shtetit

se ekzistojnë disa modele ekzistuese funksionale për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ai pati theksuar se këto modele për të drejtat e minoriteteve janë në përputhje me standardet evropiane. Kurti pritet ta zhvillojë raundin e ri të bisedimeve me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Ohër të Maqedonisë së Veriut më 18 mars. Në këtë takim pritet që palët të diskutojnë për planin e zbatimit

të propozimit evropian për normalizimin e raporteve. "Para të shtunës ne do ta dimë agjendën dhe pikat më përmbajtësore se çfarë do të diskutohet atje. Në kuadër të negociimit të planit për zbatimin e marrëveshjes tashmë të dakorduar sipas propozimit evropian, pa u ndryshuar asgjë", ka thënë Kurti. Palët janë pajtuar se nuk ka nevojë që për këtë propozim që Kosovës dhe Serbisë u është

dorëzuar vitin e kaluar të ketë negociata shtesë. Propozimi synon që t'i çojë palët drejt një marrëveshjeje ligjërishit të obligueshme për normalizimin e raporteve.

Në këtë dokument prej 11 nenesh, që është bërë publik nga Bashkimi Evropian më 27 shkurt, nuk përmendet në mënyrë specifike njohja e ndërsjellë, që Qeveria e Kosovës ka thënë se duhet të jetë në qendër të një marrëveshjeje

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 13 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se janë duke i trajtuar 15 modelet evropiane të ofruara nga Bashkimi Evropian për krijimin në Kosovë të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Kurti, gjatë një vizite që pati të hënën në Kamenicë, nuk deshi t'i përmendte modelet që BE-ja ua ka ofruar autoriteteve të Kosovës, por tha se disa janë më të hershme e disa edhe rishtazi, që përdoren në shtetet evropiane ku jetojnë pakica kombëtare. "Unë besoj se ato

janë modele nga të cilat ne do të mund të marrim elementë në mënyrë që jo vetëm të drejtat e njeriut, por edhe të drejtat e pakicave kombëtare të jenë në nivelin e duhur edhe në vendin tonë. Ato po trajtohen nga këshilltarët e mi, nga disa prej ministrave në mënyrë që ta shohim se çka është më e favorshme. Natyrisht, kushtetutshmëria, ligjshmëria, barazia, funksionimi i shtetit janë diçka me të cilat ne nuk bëjmë asnjëherë askund kompromis", ka thënë Kurti për gazetaret.

Në fillim të marsit i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë

Çfarë parasheh Asociacioni?

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe parashikohet të mbledhë rreth vetes dhjetë komuna në Kosovë të banuara me shumicë serbe: Mitrovicë e Veriut, Kllokot, Partesh, Ranillug, Graçanicë, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Leposaviq dhe Shtërpçë. Sipas marrëveshjes, Asociacioni ka për qëllim t'i përfaqësojë interesat kolektive të këtyre komunave, veçmas në fushën e arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural si dhe të ekonomisë.

Marrëveshja e vitit 2013 për Asociacionin thekson se ai do të krijohet me statut dhe strukturat

e tij, mbi bazën e statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Po ashtu, thuhet se Asociacioni do të ushtrojë edhe përgjegjësi të tjera shtesë, varësisht se si delegohen nga autoritetet qendrore dhe që do të ketë një rol përfaqësues tek autoritetet qendrore.

Sipas marrëveshjes të vitit 2015 për parimet për krijimin e Asociacionit, objektivat kryesore të Asociacionit janë: ushtron vështrimin e plotë për zhvillimin e ekonomisë lokale; ushtron vështrimin e plotë në fushën e arsimit; ushtron vështrimin e plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e

sekondare dhe përkujdesjen sociale; ushtron vështrimin e plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural; aprovon masa për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë; zhvillon, koordinon, lehtëson aktivitete hulumtuese dhe zhvillimore; promovon, shpërndan, dhe avokon për çështjet me interes të përbashkët të anëtarëve të tij dhe i përfaqëson ata përfshirë tek autoritetet qendrore; vendos marrëdhënie dhe hyn në marrëveshje bashkëpunimi me asociacionet e tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare etj.

Bislimi pret në takim ambasadorin e ri të Turqisë në Kosovë

PRISHTINË, 13 MARS - Në takimin e parë zyrtar me ambasadorin e ri të Republikës së Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili, zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, i uroi mirëseardhje e suksese ambasadorit në detyrën e tij, duke potencuar marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Turqisë. Ambasadori u shpreh falënderues për mikpritjen në Kosovë si dhe theksoi mirënjohjen e thellë për ndihmën dhe solidaritetin e ardhur nga Republika e Kosovës ndaj popullit turk në rastin e tërmetit të fuqishëm që goditi Turqinë.

Në këtë takim u bisedua për mundësitë e thellimit të marrëdhënieve bilaterale, veçanërisht në ekonomi, ku ekziston potencial madhor për rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve tona. Zëvendëskryeministri Bislimi foli dhe për objektivat strategjike të Kosovës, siç janë anëtarësimi në Këshillin e Evropës, rrugëtimi drejt Bashkimit Evropian, përfundimi i procesit të liberalizimit të vizave dhe aplikimi në Partneritetin për Paqe në NATO. Palët potencuan dhe rëndësinë e nevojën për stabilitet, paqe dhe siguri në rajonin e Ballkanit Perëndimor si dhe biseduan edhe për procesin e dialogut.



Guvernatori i BQK-së i njofton përfaqësuesit e FMN-së për sektorin financiar

PRISHTINË, 13 MARS - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka takuar përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar, të udhëhequr nga shefi i Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, Gabriel Di Bella dhe

Stephanie Eble, përfaqësuese e zyrës regionale për Ballkanin Perëndimor. Në këtë takim është biseduar për zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe angazhimet e BQK-së në avancimin e mëtejshëm të këtij sektori.

Guvernatori Mehmeti i njoftoi të pranishmit se sektori financiar po vazhdon trendin pozitiv edhe këtë vit, duke qenë likuid dhe me performancë pozitive, duke rritur aktivitetin kredihënës për ekonominë dhe qytetarët. Ai falënderoi FMN-në për

mbështetjen e vazhdueshme dhënë Kosovës dhe BQK-së në veçanti përgjatë gjithë këtyre viteve. Nga ana tjetër, udhëheqësi i misionit të FMN-së për vendin tonë, Gabriel Di Bella, falënderoi guvernatorin Mehmeti për

bashkëpunimin, ndërsa shprehu gatishmërinë për vazhdimin e mbështetjes dhe realizimit të projekteve të ndryshme së bashku me BQK-në, përmes të cilave do të përfitonin qytetarët dhe ekonomia në përgjithësi.



eventuale për normalizim të raporteve. Megjithatë, në nenin 2 të propozimit përmendet që palët duhet të respektojnë pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të njëra-tjetrës. Propozimi, po ashtu, përfshin zotimin e palëve për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në proceset integruese. I dërguari i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, Miroslav Lajčak, pas vizitës që pati në Prishtinë, ka nisur të hënën vizitën në Beograd në kuadër të përgatitjeve për takimin e radhës në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb

Aleksandër Vuçiq më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut. Para takimit me Lajčakun, Vuçiqi ka thënë se do të diskutojë se çfarë mund të bëhet në lidhje me normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. "Por nëse dikush nuk është i gatshëm as të flasë, e lëre më ta zbatojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, atëherë nuk ka kuptim", ka deklaruar Vuçiqi. Më 9 mars Lajčaku ka thënë se ka pasur bisedime konstruktive dhe shumë të rëndësishme me Kurtin për zbatimin e marrëveshjes dhe ka shtuar se takimi i ka përbushur pritshmëritë e tij. Pas takimit me Kurtin, diplomati slovak ka thënë se të dyja palët duhet të pajtohen për aneksin e zbatimit, sepse marrëveshja nuk

do të jetë ligjrisht obliguese pa të. Lajčaku ka thënë se beson që marrëveshja do të zbatohet të paktën pjesërisht, nëse jo plotësisht, dhe se harmonizimi "i një pjesë të mirë" të udhërrëfyesit do të përbente sukses. Lajčaku gjatë vizitës së tij në Kosovë ka zhvilluar takim edhe me përfaqësuesit e partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka shprehur rezervat e tij dhe partisë që drejton në raport me këtë marrëveshje, e cila, sipas tij, është e pamjaftueshme dhe mundësi e humbur për një progres final të

cilin e kishim pritur të gjithë. Ai ka theksuar se kjo marrëveshje, duhet thënë qartë, heq dorë prej arritjes së njohjes së ndërsjellë. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka kërkuar sqarime nga Lajčaku në lidhje me dy nene të planit evropian. "LDK-ja përsërit se Kosovës i duhet një marrëveshje e përqendruar te njohja e ndërsjellë dhe se asnjë marrëveshje tjetër nuk garanton normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Heqja dorë nga njohja është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e kryeministrit Kurti dhe e institucioneve të tjera kushtetuese të Kosovës. Në takim, z. Lajčak i kërkonte sqarime në lidhje me tekstin e marrëveshjes së propozuar, në mënyrë të veçantë në lidhje me preambulën, me nenin 7, nenin 10 dhe me planin implementues

të marrëveshjes së tanishme", ka theksuar Abdixhiku. Ndërkaq lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, i ka rikonfirmuar Lajčakut mbështetjen e tij dhe të AAK-së për këtë marrëveshje. "Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës kjo marrëveshje është me interes nacional, pasi që e siguron rrugëtimin tonë të qëndrueshëm drejt integriteteve euro-atlantike", ka thënë shprehur Haradinaj. Kosova dhe Serbia i kanë nisur negociatat e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian më 2011. Tani për tani të dyja vendet kanë synime të ndryshme për marrëveshjen finale. Kosova insiston në njohje reciproke, Serbia kërkon zgjidhje kompromisi.

Vendoset gurthemeli i shkollës "Fan S. Noli" në Kamenicë

KAMENICË, 13 MARS - Në Kamenicë të hënën u vendos gurthemeli i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Fan S. Noli". Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, të shoqëruar nga kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, e në praninë e

mësimdhënësve dhe nxënësve, ishin pjesë e ceremonisë së organizuar me këtë rast. Para tyre ai tha se përkujtimi i përvjetorit të vdekjes së rilindësit Fan S. Noli, përmes emërimit të shkollës, është simbolikë domethënëse dhe zotim për ta vazhduar angazhimin në rrugën e dijes. Shkolla e re Fillore e Mesme e

Ulët në Kamenicë do të ketë sipërfaqe bruto prej 4.500 m², me 20 klasë, 5 kabinete, 1 bibliotekë, dhe mensë moderne për ngrënie e hapësira adekuate sportive. E financuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, vlera e projektit të shkollës së re është 1.7 milion euro.



Policia kufitare kap në kamionin me targa serbe 90 mijë kokrra vezë pa dokumente përkatëse

PRISHTINË, 13 MARS - Të dielën në mbrëmje rreth orës 20:40 policia kufitare në një pikë kontrolli ka ndaluar një automjet transportues me targa të Serbisë në të cilën ndodheshin i dyshuari A. S., drejtues i mjetit, mashkull, shtetas i Serbisë dhe pasagjeri J. A., shtetas i Serbisë. "Policia e Kosovës, në vazhden e kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sundimit të ligjit, lufton dhe parandalon dukuritë negative dhe paligjshmërinë, ku si rezultat i kësaj me datën 12.03.2023 rreth orës 20:40 njësitë policore nga policia kufitare gjatë mbajtjes së një pike kontrolli kanë ndaluar një automjet transportues me targa të Serbisë në të cilën ndodheshin i dyshuari

A. S. drejtuesi i mjetit mashkull shtetas i Serbisë dhe pasagjeri J. A. shtetas i Serbisë", ka njoftuar policia. Sipas këtij njoftimi, gjatë legjitimitetit të tyre është vërtetuar se ata kanë tentuar të bëjnë kalim ilegal të vendkalimit kufitar nga Republika e Kosovës në drejtim të Serbisë, ku me këtë rast është realizuar një kontroll te personat e lartcekur dhe në kamionin e tyre janë gjetur rreth 257 pako me rreth 90 000 kokrra vezë për të cilat të dyshuarit nuk posedonin dokumente përkatëse. Lidhur me rastin, automjeti është dërguar në terminalin doganor në Mitrovicën e Jugut, ndërsa pas intervistimit, me urdhër të prokurorit, të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt.



Studentët e Fakultetit Juridik radhiten në pesë ekipet më të mira në garën ndërkombëtare "Philip C. Jessup"

PRISHTINË, 13 MARS - Studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës kanë marrë pjesë në raundet evropiane të garës prestigjioze për studentët e drejtësisë "Philip C. Jessup" e cila është mbajtur në Gjenevë të Zvicrës më 9 dhe 11 mars. Në këtë garë ekipi përfaqësues i Fakultetit Juridik/UP (i përbërë nga studentët: Art Sylaj, Daorsa Berisha, Ernesha Shala, Lea Meraku dhe Diellza Mujaj - trajnere e ekipit) kanë arritur suksese të jashtëzakonshme duke u radhitur në mesin e pesë ekipeve me të mira. Për më tepër, studentja Lea Meraku është shpërblyer me çmimin e oralistes së 4-t më të mirë në mesin e 60 pjesëmarrësve. Kjo garë është në mesin e tri garave më prestigjioze



ndërkombëtare për studentët e drejtësisë në botë, ku Fakulteti Juridik (UP) përfaqësohet, e të cilat nga viti 2022 janë pjesë e programit të përhershëm të fakultetit.

I njëjti ekip përfaqësues i Fakultetit Juridik për garën "Philip C. Jessup" do të marrë pjesë edhe në raundet finale që mbahen në Uashington D.C. nga 8-15 prill 2023.

Ministria e Infrastrukturës hap procedurat e prokurimit për rrugën Kijevë - Dollc



KAMENICË, 13 MARS - Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka njoftuar se janë hapur procedurat e prokurimit për rrugën Kijevë - Zahaq, përkatësisht për segmentin Kijevë - Dollc. Sipas Aliut, buxheti i planifikuar për këtë projekt është 32 milionë euro, i ndarë në katër pjesë. "Janë

hapur procedurat e prokurimit për ndërtimin e Rrugës Nacionale N9 Kijevë - Zahaq, përkatësisht segmenti Kijevë - Dollc. Rruga është e ndarë në 4 lote me gjatësi totale 12.8 km dhe me buxhet të planifikuar prej 32 milionë eurosh", ka shkruar Aliu në "Facebook".

Fillon projekti për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në kryeqytet

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se ka filluar projekti për

zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik pas një neglizhimi për një kohë shumë të gjatë. "Projekti, i ndarë në katër lote,

ka përfshirë më shumë se 100 rrugë të cilat nuk kanë pasur asnjëherë ndriçim. Falë punës fantastike të ekipit, Prishtina

në një frymë krejtësisht të re, ndriçim publik efikas e rrugë të sigurta për qytetarët", ka shkruar Rama në "Facebook".



Arrestohen pesë persona të dyshuar për përfshirje në trafikim të armëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 MARS - Me urdhër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, më 12 mars Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, në vazhden e realizimit të objektivave strategjike dhe planeve operacionale, që kanë për qëllim luftimin e veprimtarive kriminale, që ndërliken me fushën e krimin të organizuar, ka realizuar një operacion policor në rajonin e Mitrovicës Jugore dhe Prishtinës, i cili ka përfshirë pesë lokacione të ndryshme, ku ka rezultuar me arrestimin e pesë personave të dyshuar për trafikim me armë. “Të dyshuarit në mënyrë të organizuar si grup i rrezikshëm kriminal, dyshohet se kanë kryer veprat penale ‘Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar’ nga neni 277 lidhur me veprat penale ‘Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi,

ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse’ nga neni 364 dhe veprën penale ‘Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’ nga neni 366. Gjatë operacionit janë arrestuar pesë persona me inicialet S. S., S. S., E. Xh., Sh. D. dhe Sh. J., si dhe gjatë kontrollit dhe bastisjeve të kryera në prona/shtëpi banimi, në cilësi të provave materiale, janë sekuestruar: njëzet armë (AK-47), njëzet karikatorë AK 47, dy automjete, gjashtë telefona si dhe dokumente relevante për rastin”, bëhet me dije në komunikatën e përbashkët të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Speciale.

Prokuroria Speciale ka theksuar se mbetet e përkushtuar për hetimin e plotë të këtij rasti si dhe të gjitha rasteve të cilat janë në kompetencë të kësaj prokurorie.

Me vendim të prokurorit kompetent pesë të dyshuarit e arrestuar janë dërguar në mbajtje për 48 orë, për të vazhduar procedurat e



mëtejme ligjore. “Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit mbeten të përkushtuara për realizimin e detyrave dhe

autorizimeve ligjore në interes të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, parandalimit të veprimtarive të ndryshme

kriminale dhe sjelljen para drejtësisë të personave të dyshuar”, theksohet në komunikatën për medie.

Specializantët protestojnë kundër vendimit të ShSKUK-së: Na detyron të punojmë pa pagesë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 MARS - Këshilli i Specializantëve i QKUK-së ka protestuar të hënën para administratës qendrore të QKUK-së për shkak të pagesës së kujdestarive në kundërshtim me Ligjin e Pagave dhe vendimeve të qeverisë. Sipas tyre, ky vendim i detyron ata të punojnë pa pagesë dhe në kundërshtim të vendimit të qeverisë. Ata kanë thënë se nuk do të ndalen dhe se protestat do të vazhdojnë edhe në ditët e ardhshme.

Kryetari i Këshillit të Specializantëve, Arianit Zajmi, ka thënë se protestat nuk do t'i ndalin dhe se do t'i ndjekin rrugët ligjore për t'i kërkuar të drejtat e tyre. “Ne sot kemi vendosur të protestojmë kundër vendimit të ShSKUK-së i cili është marrë më 1 mars 2023,

vendim i cili na detyron të punojmë në kundërshtim të ligjit të punës dhe na detyron të punojmë pa pagesë. Në të njëjtën kohë, ajo që është më e rënda në aspektin penal, ky vendim është duke na detyruar të punojmë kundër rregullores e cila është miratuar më 3 shkurt 2023. Prej 1 marsit, sipas vendimit të ShSKUK-së dhe sipas letërës rekomandues, ne do të paguhemi në mënyrë të jashtëligjshme”, ka thënë ai.

E Veton Kurti, specializant i Radiologjisë, ka kërkuar që këto probleme të zgjidhen njëherë e përgjithmonë. “Çdo dy-tre muaj po kemi këso probleme. Ju jeni dëshmitarë të asaj që para dy-tre muajve kemi qenë këtu për të njëjtin problem. Shpresoj që njëherë e mirë të zgjidhet ky problem, sepse edhe ne nuk jemi duke dalë këtu nga qeji, por nga zori”, ka thënë Kurti.

Deputetët udhëtojnë jashtë shtetit, këtë javë s'ka seancë plenare

Prishtinë, 13 mars - Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se këtë javë nuk do të ketë seancë parlamentare për shkak se dy delegacione do të jenë në udhëtim jashtë shtetit. Ajo ka thënë se seanca do të vazhdojë javën e ardhshme. “U konfirmua se në këtë javë nuk do të ketë seanca plenare sepse dy delegacione të vendit do të jenë në udhëtime jashtë vendit. I bie që seancat e radhës të jenë

në javën e ardhshme. Të gjitha komisionet do t'i vazhdojnë mbledhjet”, ka bërë me dije Kusari-Lila.

Lidhur me shtrenjtimin e energjisë elektrike, Kusari-Lila ka thënë se mbetet të shihet në ditët në vijim se cili do të jetë modeli final që do të përdoret nga muaji prill. Ajo është deklaruar edhe rreth bisedimeve midis Kosovës dhe Serbisë dhe pajtueshmërisë rreth planit evropian, për çka

pritet të mbahet takimi i radhës në Ohër më 18 mars. “Pala e Kosovës ka prezantuar gatishmërinë për t'u dakorduar për një plan që rrjedh nga propozimi evropian. Presim qasje konstruktive edhe pse mund të flasim vetëm për njëjër palë. A do të ketë sukses takimi në Ohër mbetet të shihet. Sa i përket përmbajtjes së planit, është ende në proces. Është në mes të palëve”, është shprehur Kusari-Lila.



Më shtrenjtë prodhimet “Made in Kosova” se ato të huajat

PRISHTINË, 13 MARS - Prodhimet e Kosovës shpesh kanë çmim të njëjtë me produktet e ngjashme të importuara e, në disa raste, janë edhe më të shtrenjta.

Ekipi i “Radios Evropa e Lirë” vizitoi javën e kaluar disa dyqane ushqimore në Prishtinë, ku hasi në sheqer më të shtrenjtë se sheqeri i importuar, në salcë më të shtrenjtë apo në peceta më të shtrenjta. “Nuk e di pse... por mendoj se produktet vendore do të duhej të ishin më të lira”, thotë Ndue Kalaj, një banor në Prishtinë.

Vebi Mjeku, bashkëqytetar i tij, thotë se blen pak produkte vendore - vetëm nëse janë më

Kosovës pohojnë ngjashëm.

Kryetari Lulzim Rafuna thotë se, sipas informacioneve që ka, bizneset në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe disa vende të tjera prej nga importon Kosova, kanë politika më të mira fiskale dhe subvencionohen nga shteti. “Energjia elektrike për prodhuesin në Kosovë nuk është e subvencionuar, ndërsa në vende të tjera kanë lehtësira. Në disa vende prodhuesit janë të liruar edhe nga tatimet për ambalazhe, ndërsa në Kosovë nuk janë”, thotë Rafuna për “Radion Evropa e Lirë”.

Shteti, sipas tij, duhet të intervenojë te politika fiskale, goftë me zbritjen e tatimit mbi



të lira. “E shikoj edhe cilësinë, por më shumë çmimin”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Përfaqësues të bizneseve dhe të kompanive prodhuese në Kosovë thonë se çmimet ndikohen nga politikat fiskale, sipas tyre, aspak të favorshme. “Referuar shteteve përkatëse - Serbisë, Maqedonisë së Veriut e të tjera - ato kanë politika të avancuara fiskale dhe kompanitë e tyre kanë subvencionime të ndryshme nga shteti. Këto politika që ata i kanë, na penalizojnë, sepse ne nuk i kemi”, thotë Isa Rakovica, drejtor i shitjes në kompaninë “Liri” në Prizren, e cila merret me prodhimin e produkteve të ndryshme ushqimore. Ai thotë se punon me një marzhë më të vogël të fitimit për të nxjerrë në treg çmime sa më të lira.

Në Odën Ekonomike të

vlërën e shtuar, të tatimit doganor e të tjera. Ai thotë se nga viti 2019 asnjë politikë fiskale nuk ka ndryshuar në favor të prodhuesve. Sipas Rafunës, Ligji për masat anti-damping duhet të vihet në zbatim.

Dampingu shkaktohet kur një vend eksporton në Kosovë produkte me çmime më të lira se vlera normale e tyre dhe, rrjedhimisht, dëmton industrinë e brendshme prodhuese. Në atë rast, mekanizmi anti-damping nënkupton vendosjen e një takse që duhet ta paguajë eksportuesi.

Kosova ka miratuar Ligjin për masat anti-damping në vitin 2014. Për herë të fundit e ka zbatuar në vitin 2021 kundër disa produkteve të Serbisë.

Ministria e Financave, Punës

dhe Transfereve e Kosovës nuk iu përgjigj kërkesës së “Radios Evropa e Lirë” për të diskutuar në lidhje me këtë temë.

Në programin katërvjeçar të qeverisë aktuale qëndron zotimi për orientimin e ekonomisë kah prodhimi dhe eksporti. “Qeveria do t’i mbështesë bizneset në blerjen e makinerisë prodhuese dhe përpunuese, duke synuar digjitalizimin e procesit të përpunimit dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe prodhuese”, thuhet në planin e qeverisë, por nuk është e qartë se deri ku ka arritur zbatimi.

Kosova importon shumicën e produkteve nga shtetet fqinje dhe ato të Bashkimit Evropian

ndonëse, sipas të dhënave zyrtare, ka rreth 2 400 kompani prodhuese.

Vendi, prej vitesh, përballet me deficit të lartë tregtar - duke importuar më shumë dhe eksportuar më pak - gjë që, siç thonë ekspertët, e pengon edhe rritjen ekonomike. Sipas vlerësimeve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, rritja ekonomike gjatë vitit 2023 pritet të jetë 3-4 për qind.

Gjatë vitit të kaluar si konsumatorët ashtu edhe prodhuesit i ka goditur edhe inflacioni i lartë. Kosova e ka mbyllur 2022-shin me normë mesatare të inflacionit gati 12 për qind.



Universiteti amerikan mbështet Ministrinë e Ekonomisë në zbatimin e Strategjisë së Energjisë

PRISHTINË, 13 MARS - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka nënshkruar të hënën memorandum të bashkëpunimit me Universitetin e Columbias në Nju-Jork të përfaqësuar nga profesori Jenik Radon i cili specializon në menaxhim strategjik dhe të riskut,

sovrانيتet dhe të drejta të njeriut, veçanërisht mjedisore si dhe transparencë.


Përmes memorandumit të nënshkruar, Universiteti i Columbias do ta mbështesë Ministrinë e Ekonomisë për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë së Energjisë 2022 - 2031 përmes studimeve e

hulumtimeve akademike, përfshirë intervista e takime në terren. Dy pika të fokusit të hulumtimit e raportit të tyre do të jenë zhvillimi i skemave konkurruese për integrim të burimeve të ripërtërishme në Kosovë si dhe skemave mbështetëse për rritje të efijencës së energjisë.



NJË RAPORT KUNDËRSHQIPTAR SI AI I DIK MARTIT!

(Disa arsytetime e qëndrime ndaj shkrimit "Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor", nga kryetari i ASHAK, akademik Mehmet Kraja, në dhjetor 2022).



Shkruan: Kudusi LAMA

1. Arsytetim

Të shfrytëzosh funksionin që ke dhe dijen që ke, të cilat i ke marrë nga populli yt, për ta sulmuar e përdhosur popullin tënd, për ta kriminalizuar historinë e popullit tënd, në emër të popullit tënd, nuk është as etike, as funksionale, as intelektuale, as profesionale, as logjike, as qytetare.

Të urresh është krejt normale, por të urresh atë që të ushqen, që të mban të sigurt dhe që të krijon perspektivën e jetës është djallëzore.

Një gjykatë naziste, që ka dalë nga shinat dhe rrokulliset në humnerën e kundërligjit për interesa të kundërpolitikës, po na e dënon historinë më të lavdishme të atdheut e kombit. Këtë e kam kuptuar, por që një akademik, të marrë atributet e një gjykate kundërkombëtare për ta kriminalizuar historinë e kombit të cilit i përket për nga vendlindja dhe generalitetet, kjo është shumë e dhimbshme.

E, prej këtej lind pyetja: A kemi nevojë vërtet për një raport numër dy të Dik Martit, të shkruar tashmë

jo nga serbët, por nga një akademik shqiptar, për të na e dënuar krejt historinë, sepse raporti numër një, na e ka dënuar veç Luftën Çlirimtare të Kosovës? Është shumë e dhimbshme të flitet me papërgjegjësi dhe me përbuzje e urrejtje për gjithçka, për një kohë, për një komb, për një popull, për një atdhe, të cilëve u përket, sikur je një gjysh analfabet që nuk kupton asgjë nga çfarë është vlerë dhe çfarë antivlerë, çfarë është interes dhe çfarë kundërinteres, çfarë është shkencore dhe çfarë është politikë e rrugës etj.

Në këtë pozitë vlerësojmë se ka rënë kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Mehmet Kraja. Dhe, po t'i referohemi titullit të shkrimit të tij dhe adresës, rezulton se nuk është e saktë. Aty shkruhet: *Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor - Analizë e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës*. E, duke lexuar përmbajtjen e këtij shkrimi, gjithkush do të pyeste: Ku qëndron e reja në këtë shkrim? Cili është zbulimi? Cila është analiza? Çfarë

është përfundi kombëtar nga ky punim? Po përfundi ballkanik, cili është?

Duke lexuar shkrimin kuptohet se thjesht janë renditur disa copëza historie, të cilat i ka vënë në evidencë gjithkush që ka shkruar diçka për Shqipërinë dhe shqiptarët. Por edhe ato janë paraqitur sikur i paraqesin serbët. Janë paraqitur sikur synimi i tyre është të tremben shqiptarët dhe të rrinë larg serbëve, sepse mund të kenë pasoja. Çudi më duket të shkruhet me këtë frymë!

Po kështu, ky punim emërtohet analizë? Po ku është analiza këtu? Çfarë faktorësh analizohen, peshohen, ballafaqohen, arsyetohen, për të nxjerrë një përfundim? Çfarë avantazhesh dhe disavantazhesh paraqiten dhe si do të trajtohen ato për ta bërë situatën më të favorshme për shqiptarët? Për problematikën që duhet të shtrohen në një analizë e që nuk janë shtruar, duhet përcaktuar edhe cilat janë pikat e forta, cilat janë mundësitë, cilat janë dobësitë, cilat janë sfidat dhe si duhen zhvilluar të gjitha këto në interes të forcimit të sigurisë e të

zhvillimit të vendit: Ku janë këto në atë shkrim?

Sipas fjalorit të gjuhës shqipe, *analizë* është: "Një metodë studimi me të cilën e tëra zbërthehet në pjesët e veta përbërëse, me qëllim që të zbulohet ndërtimi i së tërës dhe lidhjet ndërmjet pjesëve. Shqyrtimi i një çështjeje duke zbërthyer dhe duke vështruar nga të gjitha anët me imtësi."ⁱ

Derisa *analizoj* është: "Shqyrtoj një çështje duke e zbërthyer e duke e parë nga të gjitha anët."ⁱⁱ Çka do të thotë se duhet të arsyetohet me përbërës konkretë dokumentesh, shqyrtimesh, përfundimesh, dëshmitarësh, studimesh, tezash, zbërthimesh, vështrimesh, shkaqesh, vetish, konsultash dhe ballafaqimesh, për të ardhur në një përfundim të pranueshëm dhe me vlerë për fushën në të cilën bëhet analiza përkatëse.

Ndërsa në punimin: *Analizë e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me titull: Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin perëndimor*, nuk vërehet asgjë nga ato elemente të analizës dhe nuk ka asgjë që të mos jetë e njohur e botuar dhe e publikuar me dhjetëra herë.

Përveç që më ngjason si një kopje e dy memorandumëve të Beogradit: Memorandum i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve – i vitit 1986 dhe Memorandum i Kishës serbe për Kosovën – i vitit 2003. Këto dy memorandumë dhe kjo analizë ngjasin si dy pika uji veçse me ndryshimet e domosdoshme për përkatësinë e autorëve dhe kohën "e deklarimit". Kështu që kjo analizë mund të ishte një memorandum, që në kuptimin shqip do të thotë: *qëndrim për një çështje të caktuar*.

Por edhe ky qëndrim për çështjet e sigurisë, siç pretendohet, duket se është shumë i shpërqendruar, sikur të jetë punuar duke mos ditur çfarë të thuhet. Duket sikur është dëshiruar për t'u marrë me gjithçka e për të mos thënë asgjë. Sikur nuk është kuptuar as objekti i asaj për të cilën është dëshiruar të flitet e shkruhet.

2. Shkrim që nuk thotë asgjë të re

Që në fillim thuhet: "Ky dokument është një analizë e përgjithshme e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për t'ia tërhequr vëmendjen opinionit të brendshëm dhe faktorit ndërkombëtar se politikën e Serbisë ndaj Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor kanë njohur së fundi një trend riciklimi, duke u bërë gjithnjë e më agresive dhe destabilizuese për rajonin dhe duke krijuar një vazhdimësi të pakëputur të politikave që ndjek Serbia ndaj

Kosovës, që nga vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar."ⁱⁱⁱ Referuar këtij citimi lindin pyetjet e thjeshta: Përse politikën e Serbisë qenkan bërë agresive në këtë kohë, a nuk ishte Serbia që diktoi katër luftëra vetëm në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit të 20-të? Cilat janë arsytet që Kosova, Ballkani Perëndimor dhe rajoni, Europa e bota nuk e shohin dhe nuk e vlerësojnë këtë politikë agresive të Serbisë? Çfarë zbulohet me këtë studim diçka që nuk e dinë politikën e Kosovës e të gjithë Europës? Dhe, pse këto politika të Serbisë qenkan bërë agresive pas viteve '80 të shekullit të kaluar, kaq paqësore e të sigurt paskan qenë këto politika para këtyre viteve?

Nëse ky shkrim do të kishte thënë diçka për këto çështje, duke dhënë argumente për ta vënë Kosovën, botën dhe gjithë shqiptarët përpara një pasqyre të asaj që ata nuk e njohin, do të kisha thënë se vërtet ia vlen.

Po kështu, në hyrjen e këtij punimi thuhet: "Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është krijimi i një pasqyre të përgjithshme të rrethanave të krijuara në marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë, duke analizuar shkaqet, rrënjët e konfliktit dhe prapavijën e tij në kontekst të politikave rajonale, duke dashur t'ia tërheqim vëmendjen bashkësisë ndërkombëtare se perspektivat e errëta që ofron Serbia për rajonin do të njohin përshkallëzim në ditët, muajt dhe

vitet e ardhshme."^{iv} Duke u marrë me këtë shkrim nuk arrij të shikoj dhe të kuptoj se cilat janë rrethanat që qenkan krijuar e që kanë qenë të panjohura deri tani dhe që duhen të mësohen? Nuk arrij të kuptoj ku është analiza e shkaqeve, cilat konsiderohen rrënjët e konfliktit, si dhe cila konsiderohet prapavijë e kësaj situatë, që qenka krijuar dhe e cila paska mbetur e panjohur deri tani.

Mesazhet e pasigurisë së politikave të Serbisë për fqinjët e njëkohësisht edhe për shqiptarët, i njohim prej vitit 1846 kur Ilia Garashanini përpunoi "Naçertanian", si dhe në programet e vijueshme e edhe prej kur në vitin 1986 është deklaruar Memorandum i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, nëpërmjet të cilit na janë thënë të gjitha për atë politikë destabilizuese. Që në atë program është thënë se "...kriza politike të është afruar pikës kritike të destabilizimit të plotë të Jugosllavisë. Kosova është shenja më e dukshme e saj."^v Prej nga shihet se Kosova ishte barometër i ekzistencës së Jugosllavisë, sepse e kishin shumë të qartë se ishin në tokë të huaj dhe po sundonin një popull me të cilin nuk i lidhte asgjë, përveç faktit që e kishin të pushtuar.

3. Përfundime pa arsytetime

Por pa dashur të zgjerohem më tej për këtë, më çudisin përfundimet që nxirren që në fillimet e këtij shkrimi kur thuhet: "Ngecjet në reforma dhe në demokratizim, pastaj krizat e njëpasnjëshme politike, korrupsioni dhe krimi i organizuar në të cilat janë përfshirë shoqëritë ballkanike, në përgjithësi kanë krijuar ambient të përshtatshëm për depërtim të papenguar të ndikimeve politike të financuara nga fuqitë me ndikim në rajon, siç janë Rusia, Kina dhe Turqia."^{vi} Sepse për të ardhur në këtë përfundim kaq madhor, duhet të marrësh referencë studime të bëra nga institute e organizata të fuqishme shkencore jo vetëm në Kosovë e rajon, por edhe në hapësirat botërore, duhet t'u referohesh vendimeve e organizatave ndërkombëtare, duhet të referohesh në vendimet e gjykatave për këto çështje, duhet të referohesh në bilance të shteteve e pasqyrave të veprimtarive ndërshtetërore, duhet të mbështetesh në konferenca, simpoziume e tryeza shkencore të vendit e të huaja etj. Por thjesht të thuash se kanë ngecur reformat dhe demokratizimi, se janë krijuar kriza të njëpasnjëshme politike, se korrupsioni dhe krimi i organizuar ka përfshirë shoqëritë ballkanike dhe të gjitha këto veç se them unë (siç thotë autori i këtij raporti në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës), më duket e paarsyeshme dhe humbje e rëndë e autoritetit të institucionit që merret me shpifje të tilla. Dhe, më tej, për çudi qenka krijuar një mjedis i përshtatshëm për depërtim të papenguar të ndikimeve politike të financuara nga fuqitë me ndikim në rajon, siç janë Rusia, Kina dhe Turqia. Po pse ky përfundim? A ka fakte të arsytuar që ka ndodhur një gjë e tillë? Pse nuk hiqet kjo perde të shohim edhe ne atë çfarë shikon kjo Akademi e shkencave dhe autori i raportit? Unë di se në qershor të vitit 1999, forcat ushtarake ruse tinëzish u futën në Kosovë dhe e pushtuan në një mënyrë Aeroportin e Prishtinës. Por brenda tri ditëve u detyruan të ikin nga sytë këmbët. Dhe, në atë kohë ishim shumë më të dobët se sot. Çfarë ka ndodhur, pra, që e ka trembur kaq shumë Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës? Nuk shoh asnjë rrezik të tillë. Por raporti nuk ndalet me evidencimin e të këqijave të shoqërisë ballkanike e mëtej, pasi në vijim theksohet: "Për shkak të mënyrës së keqe të qeverisjes, Ballkani Perëndimor gjithnjë e më shumë po largohet nga politikat e BE-së dhe të NATO-s dhe po bëhet pjesë e boshteve asimetrike që lidhen me Euro-Azinë. Po krijohen koalicionet e panatyrshme, të cilat në mënyrë strategjike i kundërvihen BE-së në planin ekonomik dhe politik, kurse NATO-s në planin e sigurisë. Këto koalicionet janë duke suspenduar reformat e BE-së, në të cilat kanë ngecur këto shtete dhe

janë duke siguruar dominimin ekonomik dhe politik të Serbisë në rajon, për të realizuar politikat e saj strategjike, kryesisht të nxitura nga Rusia."^{vii} Nga nxirren përfundime të tilla? Sepse kështu si paraqiten ato, janë thjesht deklarata. Nuk është dhënë qoftë edhe një arsytim apo ankesë nga BE-ja se keqqeverisja në Ballkanin Perëndimor po e largon atë nga politikat e saj. Po kështu dihet se Sllovenia dhe Kroacia janë anëtare të BE-së, ndërsa Shqipëria, Kosova, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut kanë bërë kërkesa të jenë në përbërje të BE-së dhe po punojnë me intensitet për të përmbushur të gjitha kërkesat që kjo organizatë u ka vënë për të kryer si detyra paraprake për të mundësuar pranimin në organizatë. Ashtu sikurse nuk është e mundur të mendohet e të deklarohet se shtetet e Ballkanit Perëndimor po i kundërvihen NATO-s në planin e sigurisë, kur dihet se NATO-ja sigurinë e ka për mision dhe në Ballkanin Perëndimor ka anëtarë të saj Shqipërinë, Kroacinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, por edhe Slloveninë. Ndërsa po të merret si shembull Kosova, duhet thënë se ajo është akoma më e avancuar, pavarësisht se nuk është juridikisht anëtare e NATO-s, por Kosova NATO-n e ka ushtri të saj, sepse realisht sot ushtri e Kosovës është edhe KFOR-i, krahas Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila po merr përmasat e një ushtrie plotësisht sipas standardeve të NATO-s. E, siç shihet, vetëm Serbia ende nuk është anëtare e NATO-s, megjithëse do të kishte shumë dëshirë të ishte, ashtu si do të kishte shumë dëshirë të ishte anëtare e BE-së, dhe këto shihen në lojën e saj politike.

4. Frika e madhe prej Serbisë nuk ka bazë të qëndrojnë

Pse, pra, gjithë ky shqetësim e gjithë kjo frikë në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës? Mirë, ndoshta kanë frikë për vete, por, përse duhet të bëhen përpjekje të frikësohen shqiptarët? Çfarë borxhi u kanë? Nuk mendoj se me përpjekje për të bërë të diturin duhet të merremi me montime thashethemesh të kafeneve dhe me paragrafë të historisë se çfarë mendojnë serbët për shqiptarët e për trojet shqiptare, sepse ato janë të stërthëna. Me rëndësi është që ne të kemi një program të interesave kombëtare, ashtu siç i bën Serbia për vete, sepse kemi mbetur akoma në programin kombëtar të Sami Frashrit, "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet", të publikuar para 120 vjetësh. Prandaj nuk e shoh të arsytshme t'u themi shqiptarëve trembuni nga Serbia. Duhet t'u themi se Serbisë ia kemi parë bishtin në vitin 1999 dhe nëse do të guxojë, ne jemi ata që ia shohim bishtin përsëri e përsëri. Por raporti nuk ndalet duke bërë thirrje për t'u trembur nga Serbia! Dhe, këtë nuk e bën vetëm për

shqiptarët, nuk e bën vetëm për Kosovën e Shqipërinë, por edhe për Bosnjën, Malin e Zi e shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Duke vlerësuar se Serbia synon "...të krijojë pasiguri në rajonin e Ballkanit Perëndimor; në favor të Rusisë dhe Kinës, në politikat e tyre kundër NATO-s dhe BE-së."^{viii} - krijohet kështu ideja sikur të shpresojmë të mos dojë Serbia, se po iu shkrej në mendje asaj, ne kemi marrë fund. Jo kështu, nuk është serioze të bëjmë deklarata të tilla. Nuk ka fuqi as Serbia e askush tjetër të lëkundë a të kërcënojë politikat e BE-së apo të bëjë të pasigurt Ballkanin Perëndimor. Dhe më tej në këtë raport lexojmë: "Tashmë është bërë praktikë e njohur e Serbisë që, sa herë që krijohen "çarje" të mëdha ose të vogla me Perëndimin, ose të ketë ngecje në avancimin e marrëdhënieve me BE-në, përfshirë edhe ndonjë ngecje në ndihmat financiare që përfiton nga BE-ja, Serbia gjen mënyrë ta shantazhojë NATO-n dhe BE-në, duke forcuar aleancat me Kinën dhe Rusinë, veçmas me Rusinë, herë duke i bërë shtetit rus ndonjë koncesion ekonomik ose tregtar, por më shpesh me marrëveshje ushtarake ose kontrata milionëshe për blerje armësh. Në përgjithësi, të gjithë faktorët politikë rajonalë dhe europianë tashmë e kanë kuptuar se Serbisë i bëhen koncesione nga ana e BE-së dhe NATO-s për shkak të interesave të tyre strategjike, por tanimë është bërë krejt e qartë se këto koncesione kanë filluar të rrezikojnë seriozisht sigurinë në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përreth tij."^{ix} Përsëri befasi! Serbia ka fuqi jo vetëm të na fundosë në shqiptarëve, jo vetëm të shkatërrojë Ballkanin Perëndimor, por ka fuqi të vlerësojë edhe problemet dhe hatërmbetjet brenda BE-së dhe pas kësaj me fuqinë e saj Serbia arrin të shantazhojë edhe NATO-n e edhe BE-në. Ore, seriozisht e keni këtë, zotërinj akademikë? Unë e di se këtij raporti i ka dalë për zot kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademiku Mehmet Kraja, por po flas në shumës, sepse në internet akoma figuron si raport i asaj Akademie. Prandaj nuk dua të keqkuptohem a të keqinterpretohem, sepse qëllimi im është thjesht të sqaroj çështjet që vlerësoj se duhen parë me syrin e realitetit e jo me ndjenjën e frikës. Është mirë të mos shkojmë me mendimin se Serbia mund të bëjë si të dojë me NATO-n e me BE-në, sepse nuk merremi seriozisht, pa folur që nuk ka asnjë argument për të arsytuar deklaratimet e këtij raporti.

5. Të jemi të kujdesshëm me historinë

Ndërkohë duhet të jemi të kujdesshëm kur shkruajmë se bëjmë lapsuse të tilla, që pastaj na vjen turp nga vetja. Në raport kanjë shënim ku deklarohej se ishin "mbi 170 mijë shqiptarë të shpërngulur nga Serbia jugore pas Kongresit të Berlinit...,"^x Pa u marrë me shifrën

se për këtë ka të dhëna të ndryshme, por si mund të thuhet nga Serbia jugore, këtë nuk e kuptoj?! Ne kurrë nuk kemi pasur "fatin" të pushtojmë territore serbe. Përkundrazi, serbët kanë pushtuar territoret tona. Por mendoj se duhet të jetë një lapsus, ose një shënim i marrë nga ndonjë literaturë serbe. E ka përdorur këtë term gjenerali Klark, në librin e tij "Të bësh luftë moderne", për të cilën edhe i kam thënë se ka gabuar. Por atij i falet se nuk mund të pretendojmë të jetë njohës i historisë dhe i gjeografisë sonë. Ndërsa akademiku Kraja nuk ka vepruar mirë, duke na bërë pushtues të tokave serbe dhe prej të cilave na paskan shpërngulur. Në raport ka një fjali që më tërheq vëmendjen kur thuhet: "Marrëdhëniet shqiptaro-serbe shpesh janë përkufizuar si marrëdhëniet më të vështira mes dy popujve të Europës."^{xi} Po, përse? A është normale kjo gjuhë vlerësuese? Cilat kanë qenë përgjegjësitë? Cilat kanë qenë përgjegjësitë e shqiptarëve? Përse zotëri na vë në balancë me Serbinë, duke na bërë të barabartë? Unë nuk di të kemi bërë diçka ne shqiptarët për të cenuar serbët. Përkundrazi, jemi masakruar prej tyre historikisht dhe natyrisht kemi luftuar kundër tyre për t'u çliruar, çka nuk e kemi realizuar ende plotësisht. E, këtu nuk ka asnjë barabarësi ndikimi në marrëdhëniet shqiptaro – serbe. Theksoni, zotërinj, çështjet ku shqiptarët janë përgjegjës që paskan krijuar vështirësinë e këtyre marrëdhënieve. Në Memorandumin e Kishës Serbe për Kosovën thuhet: "Pasi të lexohet ky Memorandum i Kishës Ortodokse Serbe askush nuk do të mundë t'i përsërisë fjalët keqdashëse të një diplomati të huaj të nivelit më të lartë, i cili para pak kohe ka deklaruar se serbët, me atë që e kanë bërë gjatë dhjetë vjetëve të fundit, e kanë nxitur te shqiptarët dëshirën tejet të madhe për hakmarrje. Nga dokumentet e theksuara këtu, secili lexues do ta shohë se gjithnjë ka pasur dhunë, sa herë që pas dëshirës së shqiptarëve për ta marrë atë që nuk është e tyre ka qëndruar ndonjë nga Fuqitë e Mëdha në botë, prej Perandorisë turke e deri me sot."^{xii} Pra, shihet se na mjaftojnë shpifjet e serbëve, edhe të kishës së tyre për të justifikuar veprimet kundër shqiptarëve. Mendoj se nuk kanë nevojë për ndihmë as prej institucioneve tona shkencore e as prej shkencëtarëve tanë, qoftë edhe me tituj akademikësh, sepse vetë kanë bërë programe shumë intensive kundërshqiptare. Prandaj kur thuhet në raportin në fjalë se marrëdhëniet shqiptaro-serbe janë përkufizuar të vështira, është pikërisht fjala për atë që thotë kisha serbe në memorandumin e saj, se ka pasur dhunë, sa herë që ka pasur dëshirë të shqiptarëve për ta marrë atë që nuk është e tyre. Duhet qartësuar mirë çka shkruhet, sepse nuk është mirë që punimet tona të jenë kundër nesh, pasi mjaftojnë ato që shkruajnë serbët. Dhe, kam dëshirë të dihet se deri tani janë mbi 28 mijë tituj

librash të shkruar nga autorë sllavë për Shqipërinë dhe shqiptarët, të cilët kanë shkruar si është më zi. Nëse nuk e dini a besoni këtë shkoni dhe hulumtoni në bibliotekën e Vjenës. Atje do të mësoni edhe se shkencëtarët tanë që bëjnë të diturin këtu në atdhe, nuk kanë asnjë shkrim për të zhvleftësuar ata tituj sllavë librash kundërshqiptar.

6. Nuk jemi bashkëfajtorë me Serbinë, prandaj nuk duhet shpifur shqip

Raporti nuk ndalet këtu. Në vijim thuhet: "...të dy popujt kanë gabimet dhe fajet e tyre në të shkruarën, se ata kanë histori të përgjakshme dhe se e ardhmja duhet të ndërtohet duke i tejkaluar armiqësitë dhe animozitetet e kohëve të shkuara."^{xiii} A besoni se ka shqiptarë që mund të pranojnë dhe të dakordohet me këtë? Cilat janë gabimet që paskan bërë shqiptarët ndaj serbëve? Çfarë duhet të kishin bërë ndryshe shqiptarët që historia të mos ishte e përgjakshme? Apo duhet të arsyetohet memorandumimi i kishës serbe për Kosovën, ku thuhet: "Me shqiptarizimin e popullit serb të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, i cili ishte pa të drejta. Kur Imperia turke ka filluar të dobësohet, atëherë islamizimi i dhunshëm është bërë gjithnjë e më shumë, kurse shqiptarët fatkeqësisht në atë proces janë bërë grusht kryesor goditës otoman dhe kamxhik i përgjakur për banorët e krishterë ortodoksë të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Ballkanit të gjerë."^{xiv} Besoj se është e qartë që edhe kisha që duhet të merret me punët e qiellit, ka vendosur të rregullojë punët e tokës, por nuk kuptohet përse ne duhet t'i ndihmojmë në këtë mënyrë, duke u përpjekur që të barazojmë historinë tonë me atë të Serbisë. Ndërkaq se ne duhet t'i kalojmë armiqësitë, pajtohemi plotësisht, por pasi të vendoset drejtësia. Tejkalimi i armiqësisë nuk është i njëanshëm dhe nuk bëhet për hatër të askujt. Atë e sjell në mënyrë krejt të natyrshe vendosja e drejtësisë dhe pranimi i të këqijave që janë bërë e kthimi i të drejtave që janë marrë e janë nëpërkëmbur. Nuk mund të ketë tejkalim të armiqësive nga shqiptarët për hatër të askujt. Shqiptarët nuk kanë treguar armiqësi ndaj askujt në gjithë historinë e tyre. Shqiptarët gjithnjë kanë luftuar të mbijetojnë dhe të çlirohen nga pushtimet. Kurse tani na del se ne i kemi shqiptarizuar edhe serbët! Ata që merren me çështjet e kësaj natyre është mirë ta arsyetojnë se si i pushtuari mund të shkombëtarizojë pushtuesin. Kur më tej në këtë memorandum të kishës serbe thuhet: "Mirëpo, qysh në dhjetëvjetëshat e parë të shekullit të 18-të, shqiptarët në mënyrë masive kanë zbritur nga malet e veta në vise më pjellore të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës dhe, duke i formuar çetat e njohura për krime, ose duke u paraqitur vullnetarisht si jeniçerë, me çka kanë fituar

privilegje të veçanta te turqit, kështu pastaj i kanë plaçkitur dhe i kanë konfiskuar fshatrat e serbëve, kishat dhe manastiret e pastaj aty edhe janë vendosur.^{xv} Pra, siç vlerësojnë ata, në ato treva kemi ardhur nga malet dhe paskemi ardhur rreth një mijë vjet pas serbëve e, megjithatë, i paskemi shqiptarizuar. Por kjo është gjuha serbe dhe është mjaft e ashpër, nuk kemi pse t'i ndihmojmë në mënyrat siç edhe u theksua më lart në këtë raport të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

A ka nevojë të bëhet përpjekje për një përafrim kriminal ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve? E, po të thuhet se "shqiptarët dhe serbët nuk kanë histori të njëjtë dhune, nuk kanë histori të njëjtë pushtimesh e aktesh gjenocidale mbi njëri-tjetrin."^{xvi} Duket qartë që nuk ka njohje të nevojshme të historisë së konfliktit shqiptaro – serb. Kur mendojmë dhe deklarojmë se nuk kanë histori të njëjtë pushtimesh e aktesh gjenocidale, nënkupton që aty diku janë të dy palët njëllor. Por unë nuk e di se si mund të jenë njëllor gjyshi im, xhaxhai im, dy kushërinj të parë të babait tim, si dhe 93 burra të Kalisit në Lumë, atje rrëzë Korabi, të cilët as nuk e kanë ditur se ku është Serbia, kur në vitin 1913 janë masakruar në Kalis, vetëm pse në vitin 1912 kanë qenë pjesëmarrës në Luftën e Lumës, për të mos lejuar pushtimin e krahinës nga forcat pushtuese serbe. A mundet akademik Kraja të vërë shenjën e ngjashmërisë midis këtyre dy palëve, meqenëse po thotë se në peshë nuk janë të barabarta, të paktën, të na tregojë ngjashmëritë se unë personalisht nuk gjej asnjë ngjashmëri, e të tilla janë për mua të gjitha përballjet serbo – shqiptare.

7. Nuk është e mundur të ndërrojmë fenë që të na duan nëse ajo është pengesë

Shumë interesant është fakti që akademik Kraja ka edhe një shqetësim tjetër. Dhe shqetësimi i tij vjen kësaj: "Të paktë janë ata nga bashkësia ndërkombëtare që arrijnë të kuptojnë se rreth 98% e kosovarëve janë popullsi myslimane jo pse ata e zgjedhën myslimanizmin si besim dhe bindje fetare të kohëve moderne, por nga një trashëgimi e kohëve të errëta të historisë. Konvertimi i kosovarëve nga të krishterë në myslimanë ka qenë një proces i gjatë i pushtimit, i detyrimit dhe i dhunës sistematike të Perandorisë Otomane, në njërin anë, kurse më anë tjetër ka ardhur si rezultat i luftës së gjatë mes kishës së Lindjes dhe të Perëndimit, të cilat i lanë besimtarët e tyre në Ballkanin Perëndimor pa udhëheqës shpirtërorë."^{xvii} Prej këtej duket se ky shqetësim i akademikut Kraja është shumëplanesh: Së pari duhet bindur opinionin botëror se shqiptarët nuk e zgjedhën vetë fenë islame, por ua diktoi pushtuesi osman. Së dyti, islami nuk qenka fe e kohëve moderne,

por një trashëgimi e kohëve të errëta të historisë. Dhe, së treti, shqiptarët paskan mbetur në atë kohë pa udhëheqës shpirtërorë nga kisha e krishterë.

Çudia është se nuk e di pse feja Islame nuk qenka fe e kohëve moderne, ndërsa krishterimi qenka e tillë. Pse duhet të ekzistojnë mendime të tilla te intelektualë siç është zotëri Kraja, nuk arrij të kuptoj. Me sa di unë, si feja islame, ashtu edhe ajo e krishterë sot besohen secila prej rreth dy miliardë qytetarëve të kësaj bote. Kështu që më duket një kundërislamizëm primitiv dëshira për të kërkuar modernen te krishterimi dhe të prapambeturën te islami.

Për mua feja nuk ndikon për ta bërë njeriun më të zhvilluar ose më të prapambetur. Unë kam lexuar librin "Historia botërore dhe qytetërimi", në dymbëdhjetë vëllime, i cili është botuar edhe në shqip. Vepër e autorit Carl Grimberg, e cila edhe në gjuhën shqipe është konsideruar një vepër madhore, një enciklopedi e vërtetë që i rrok thujtë të gjitha fushat e jetës. Por që kur e lexon të lëshijë të hidhur, sepse flet kryesisht për të fuqishmit, se për shqiptarët nuk flet fare, se gjen kohë e vend të shkruajë edhe për të dashurat e Luigjit të 14-të të Francës, por nuk gjen vend të shkruajë për luftën 25-vjeçare të shqiptarëve nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Ashtu sikurse të gjithë shqiptarët e shpërngulur e të vendosur në Kalabri e në Sicili të Italisë, i quan grekë, sepse nuk ka asnjë ide se ata janë shqiptarë. Po kështu për këtë autor, që të jesh i ditur, që të jesh trim, që të jesh i zoti, që të jesh i bukur, që të jesh i fortë, duhet patjetër të jesh i krishterë. Ndërsa po je mysliman, duhet patjetër të kesh trup të imët, me fytyrë të shëmtuar, që nuk di as të vishesh, nuk di as të ushqehesh, nuk di as të organizohesh, je frikacak, nuk di të luftosh, nuk je i zgjuar etj.

Kjo histori është përkthyer në shqip nga akademikët shqiptarë, por nuk ka as parathënie prej tyre, nuk ka as një qëndrim për këto pasaktësi vlerësimi, nuk ka as një oponencë a reçencë prej një studiuesi a akademikut për mosqenien e shqiptarëve pjesë e kësaj historie, megjithëse në ato kohë që akademik Kraja i quan të errëta, kombi ynë i ka pasur të ndritura dhe ka mbrojtur Europën nga pushtimi i asaj perandorie "të prapambetur" osmane. Prandaj do të këshilloja që akademikët tanë të nderuar, të mos kërkojnë të na e errësojnë historinë, por të tregojnë para botës se ajo ka qenë e ndritur dhe se pa të ndoshta sot Europa do të fliste osmanisht.

Për fund, duhet të pranohet se asnjë komb në Europë nuk ka bërë aq luftë sa shqiptarët kundër pushtimit osman, megjithëse nëpër frontet e luftës përballë osmanëve kanë qenë shqiptarët myslimanë dhe deri edhe hoxhallarët shqiptarë. Për ta sqaruar këtë më mirë, lind pyetja: a e di akademik Kraja se sa dëshmorë hoxhallarë kanë rënë

vetëm në Lutën Çlirimtare të Kosovës? Nëse nuk e di, është mirë të jetë i interesuar ta mësojë. Megjithatë, unë mund t'i them atij e kujtdo që mendon si ai, se janë 26 hoxhallarë që kanë rënë dëshmorë të atdheut vetëm gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, duke qenë luftëtarë të asaj ushtrie të lavdishme çlirimtare që barti këtë luftë. Ky është një tregues për të kuptuar se kur zotëri Kraja si kundërislam ikte nga sytë këmbët prej frikës së krismave të luftës, në Kosovë luftonte një popull me mbi 95 për qind i fesë islame bashkë me atë pjesë të shqiptarëve të fesë së krishtere, për çlirimin e Kosovës nga serbët modernë të krishterë.

Më bën përshtypje shumë gjithashtu shprehja e deklaruar në këtë raport të punuar nga akademik Kraja, kur thotë: "Gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX, në Kosovë myslimanizmi tradicional ishte praktikuar gjerësisht, ndërsa pas vitit 1999, për shkak të këtyre fondacioneve dhe të klerit mysliman kosovar që përfitonte prej tyre, situata u përkeqësua ndjeshëm. Në këtë kuadër, veçanërisht u reflektua negativisht në Kosovë qëndrimi i luhatsëm i Turqisë në raport me fundamentalizmin islamik."^{xviii} Shihet se zotëri Kraja për çudi shqetësohet që qenka përkeqësuar ndjeshëm situata me shtimin e myslimanëve pas vitit 1999. Po pse duhet të shqetësohemi? Siç duket Serbia që na kishte pushtuar deri në vitin 1999, nuk paska lejuar që të shtohen myslimanët në Kosovë dhe paska vepruar mirë. E, largimi i Serbisë i paska lënë rrugë të lirë Turqisë që të na prishë. Këtë besoj nënkupton akademik Kraja me sa shprehhet. Por kjo rrugë është e pakthyeshme. Ne shqiptarët kemi mbijetuar se unitetin tonë e kemi mbështetur te atdheu e kombi dhe jo te feja. Ne kemi mbijetuar dhe kemi fituar se armikun nuk e kemi vlerësuar i çfarë feje është, por e kemi luftuar si pushtues edhe kur kemi qenë në të njëjtën fe me të.

Dhe, çudia nuk përfundon këtu, sepse në vijim thuhet: "Më anën tjetër, të nxitur nga ideja e kërcënimit nga islamizmi radikal që mund të vinte nga Kosova dhe Bosnja, disa shtete të BE-së, nga fundi i shekullit të kaluar, filluan ta projektonin Serbinë si "vijën e parë të frontit" kundër radikalizmit islamik."^{xix} Një monstruoizet, që nuk mund të imagjinohet! Në përfundime të tilla dalin vetëm mendjet e sëmura. Unë nuk kam dëgjuar deri sot që Europa i ka shpallur luftë islamit. Përkundrazi, ajo çdo ditë e më tej po bëhet strehë edhe për të gjithë ata myslimanë që kanë nevojë për të jetuar në Europë. Fakt është që sot Gjermania, Franca, Italia, Spanja, Anglia, Suedia, Norvegjia e mjaft shtete të tjera të Europës kanë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së tyre të përkatësisë islame, që shkon në 10 për qind e më shumë dhe nuk ndihen as të shqetësuar e as të kërcënuara. Pse, pra, duhet të shpifë zotëri Kraja ndaj Europës, duke e akuzuar se i ka shpallur luftë islamit dhe se paska projektuar Serbinë për të qenë vija e parë e frontit të kësaj

lufte? Dhe, pse qenkemi radikalë ne myslimanët? Radikalizmi sipas fjalorit të terminologjisë së gjuhës shqipe është një rrymë dhe qëndrim politik, që kërkon ndryshime rrënjësore në programin e një partie a të një qeverie. Ashtu sikurse konsiderohet edhe një proces me të cilin individët kalojnë nga moderuara të zakonshme, në mbështetjen e pikëpamjeve ekstreme ideologjike. Pra, radikalizmi është dukuri shoqërore, jo dukuri islame. Këtë duhet ta kenë të qartë intelektualët.

8. Serbia kurrë nuk do ta mundë e nuk do ta destabilizojë Kosovën

A është normale t'i ftojme shqiptarët të kenë frikë nga Serbia? Mendoj se jo. Por, zotëri Kraja duket se edhe për këtë ka menduar, kur shpreh: "Serbia destabilizon të gjitha shtetet e rajonit me pretekste të ndryshme, por gjithmonë në funksion të hegjemonizmit serbomad. Ajo e destabilizon Kosovën, sa herë që mund ta përdorë këtë rrethanë për politikale e brendshme, për të nxitur nacionalizmin, ose për t'i bërë obstrukcion bashkësisë ndërkombëtare."^{xx} Dëshira mund të ketë shumë Serbia. Por që të destabilizojë Kosovën këtë le ta harroj se nuk ka për ta arritur e për ta bërë më kurrë. Prandaj, le të thotë akademik a politikani, le të thotë ushtaraku a spiuni, le të thotë drejtuesi a intelektual, nuk do të ndodhë. Shqiptarët duhet të jenë të vendosur për të bërë detyrën e tyre ndaj atdheut e jo të tremben se po i ha Serbia! Kush të trembet, le të shkojë të jetojë e të jetë i qetë në Serbi. Është krejt e palogjikshme të shihet armiku si superior, se tremb qytetarët e vendit tënd. Për një mendim dhe deklarim të tillë ligjërisht duhet të mbahen qëndrime të repta.

Le të lexojmë në vijim: "Pavarësisht ndryshimeve gjeostrategjike që kanë ndodhur në hapësirat ballkanike dhe më gjerë përgjatë tridhjetë vjetëve të fundit, Serbia ka vazhduar e patrazuar përpunimin dhe jetësimin e strategjive politike për dominim rajonal dhe rikthim të agjendave luftënxitëse. Ajo vazhdon të jetë faktor destabilizues në Bosnjë, në Mal të Zi dhe në Kosovë, madje edhe në Maqedoninë e Veriut (siç ishte rasti me zgjedhjet e fundit lokale, ku supozohet se pati ndërhyrje të Serbisë në fitoren e krahut nacionalist proserb të VMRO-së), duke tërhequr në anën e vet, përmes floskulave politike të kamufluara, edhe shtete të tjera të paqëndrueshme të Ballkanit, si Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Përmes nismave dhe aleancave rajonale të llojit "të mini-Shengenit" ose të projektit "Ballkani i hapur", Serbia synon të vendosë primatin politik dhe ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Këtë primat ajo nuk mendon ta arrijë përmes bashkëpunimit dhe zhvillimit, por duke destabilizuar shtetet përeth, duke shantazhuar BE-në dhe NATO-n dhe përmes

aleancave subversive ekonomike dhe politike me Rusinë dhe Kinën.^{xxi} Edhe në këtë citim shihet se vijon të hiperbolizohet fuqia e Serbisë, duke e bërë atë zot të Ballkanit, pa dhënë asnjë argument për këtë, por veç thjesht se ka frikë akademik dhe kërkon që frikën e tij ta çojë te shqiptarët dhe të tjerët në Ballkan. Mendoj se politikën e këtyre shteteve ballkanike nuk janë aq në nivel mediokër sa trajtohen në këtë raport, pasi në jemi dëshmitarë të zhvillimeve dhe bëjmë vlerësimë të ngjarjeve. Masat për sigurinë merren në çdo shtet dhe secili prej tyre ka një strategji të sigurisë. Nëse akademik Kraja do të kishte marrë në analizë këto strategji të sigurisë së shteteve ballkanike, duke bërë edhe krahasimet midis tyre e duke treguar se cila prej tyre ka më shumë avantazhe e cila jo dhe të kishte thënë se cila konsiderohet më e arrirë e çfarë duhet shtuar e saktësuar në ato strategji, do t'i bënte një shërbim të mirë shtetit të Kosovës, shteteve të tjera të Ballkanit dhe do të jepte një shembull se si mund të ndihmohet siguria e vendit. Por ai thjesht ka frikë dhe thërret kam frikë! Por unë nuk e di a ka vërtet frikë, apo i bën këto deklarata me porosi. Sepse mënyra si flitet në këtë raport është shumë zhvlerësuese për politikën e shteteve ballkanike krahasuar me politikën e Serbisë, e cila është një politikë që mund të shkatërrojë gjithçka në Ballkan, prandaj ne duhet të dridhemi nga frika e të nënshtrohemi se nuk ka rrugë tjetër.

9. "Ballkani i hapur" - një çështje që kërkon analizë, jo akuzë

Në vijim kalohet në një fazë kur zotëri Kraja flet për nismën e "Ballkanit të hapur", për të cilin thuhet: "Në këtë kontekst të përgjithshëm duhet parë edhe nismat e Serbisë njëherë për "mini-Shengenin" dhe pastaj për projektin "Ballkani i hapur", si: i) obstrukcion ndaj NATO-s dhe BE-së, ii) hapësirë për depërtime të reja politike dhe ekonomike të Rusisë dhe të Kinës në Ballkan, iii) fuqizim i mëtejshëm i Serbisë në rajon, dhe iv) anashkalim i Kosovës në të gjitha proceset politike dhe ekonomike rajonale. Për pikën e fundit, pra, për anashkalimin e Kosovës, kërkohet një shqyrtim i veçantë, por me këtë rast mjafton të themi se çështjen e Kosovës, që kur ajo ka marrë atributet e një problemi të mpërtë politik, Serbia është përpjekur ta zgjidhë përmes Shqipërisë, e nxitur nga një traditë e hershme, ashtu siç e ka ndihmuar pacifizimin e saj mbreti Zog përmes marrëveshjeve me Mbretërinë Jugosllave (Pashiqin), apo komunistët shqiptarë dhe jugosllavë përmes përkimeve ideologjike dhe organizimeve të përbashkëta politike. Në të vërtetë, lojaliteti i tanishëm i Shqipërisë ndaj të gjitha nismave rajonale të Serbisë, përveç përfitimeve të tjera, kanë në prapavijë edhe "nostalgjinë ideologjike" të Shqipërisë, e cila, në rrethanat e ndonjë krize të



Shkruan: Kudusi LAMA

brendshme ose të krizës në marrëdhënie me Perëndimin, i kthehet lindjes ish-komuniste, pavarësisht faktit se Shqipëria që herët është dukur sikur është distancuar nga ky konstelacion politik, kulturor dhe botëkuptimor.^{xxii} Është befasues fakti që këtë nismë rajonale ky raport e konsideron si nismë të Serbisë.

Unë e di se Procesi i Berlinit është një iniciativë e udhëhequr nga Gjermania me mandat për ta lehtësuar bashkëpunimin rajonal ndërmjet gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, si: Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë – për t'u mundësuar këtyre vendeve që t'i bashkohen BE-së. Kjo agjendë e lidhshmërisë u fillua si një komponent i rëndësishëm që synonte lidhjen e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në fushat e transportit dhe energjisë, që më vonë u zgjerua në shkëmbime rinore dhe marrëdhënie ekonomike etj.

Po citoj fjalën e Kancelarit të Gjermanisë Sholz në Samitin e Berlinit për Ballkanin Perëndimor, kur thotë: "Ju, gjashtë vendet e Ballkanit i përkisni Europës së lirë dhe të plotë dhe anëtarësimi juaj në BE është në interesin tonë. Të gjithë ne duhet të shtojmë angazhimin tonë për të përmbushur pritshmëritë e ngritura gati njëzet vjet më parë në Selanik. Premtimi për të ardhmen europiane për qytetarët dhe vendet tuaja është punë jona për ta kthyer premtimin

në realitet dhe kjo na ka bërë bashkë sot. Më vjen mirë që ky vizion ndahet nga të gjithë ju... Së bashku jemi të bindur që procesi i Berlinit jo vetëm që do të ndihmojë në çlirimin e potencialit të plotë të bashkëpunimit rajonal, por do të përshpejtojë anëtarësimin në BE të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor..."^{xxiii} Duke u mbështetur edhe në arsyetimet e kësaj fjale të kancelarit të Gjermanisë, mendoj se "Ballkani i hapur" dhe Procesi i Berlinit nuk kanë ndonjë ndryshim. Po t'u referohesh marrëveshjeve, duket se thjesht bëhet shtrirja në praktikën e terrenit të atij procesi. Prandaj, do të doja që ky proces të merret si zhvillim. Dhe, të zhvillosh nuk do të thotë të mos kesh kujdes për të avancuar interesat e shtetit tënd. Kjo është normale. Por të shkruash se po të hapet Ballkani na ha Serbia, ky është mentalitet i kohës së luftërave ballkanike a të Perdes së Hekurt. Por ato kohë kanë ikur me gjithë mendësitë e tyre. Mbyllja e dha provën e saj me Shqipërinë e viteve 1980-1990, që solli atë masakërdemokraci, që na shkatërroi me gjithçka kishim. Po në Shqipëri në vitet 1991-1997 ligjin e kanë bërë agjenturat e huaja, edhe UDB-ja e Jugosllavisë dhe Asfalia e Greqisë. Por ata gjetën terren sepse depërtuan deri në çdo qelizë të politikës në kushtet e demokracisë, pasi demokracia u kuptua se mund të bësh çfarë të duash pa i dhënë llogari askujt, pa i dhënë llogari as ligjit. Kjo është arsyeja që edhe sot nuk po e merr fuqinë ligji, që të bëjë ligjin.

10. Shqipëria kundër Shqipërisë - një shpifje e madhe

Ndërsa të paraqitesh sot me mendimin se Shqipëria qenka me mendësi komuniste dhe nostalgjike për Serbinë, duke anashkaluar Kosovën, do të thotë të jesh armik i tërbuar i shqiptarëve dhe i shqiptarizmit në përgjithësi. Mos qoftë e thënë të kemi të tillë ndër shqiptarët.

Por duket se zotëri Kraja e paraqet veten si kundërshqiptar, veçse për çudi, për të ka dy kategori shqiptarësh. Shqiptarë të Republikës së Shqipërisë dhe shqiptarë të Republikës së Kosovës, por që ata shqiptarë të Republikës së Shqipërisë historikisht as kanë dashur të dinë për shqiptarët e Republikës së Kosovës. Kështu që zotëri Kraja është kundërshtar i egër dhe përçmues i asaj pjese të shqiptarëve që banojnë në Republikën e Shqipërisë, që i vjen keq për këtë pjesën e shqiptarëve që banojnë në Republikën e Kosovës, por që në fakt duke u përpjekur t'i ndajë, i bën një shërbim të madh Serbisë, se edhe ajo historikisht është përpjekur t'i ndajë në 'Shiftari' dhe 'Allbanci'. Por le të lexojmë çfarë thotë zotëri Kraja për këtë: "Në përgjithësi, politikën e Shqipërisë ndaj Kosovës që nga viti 1912 kanë qenë kontradiktore, jokonsekuente, në shumicën e rasteve të tilla që kanë sakrifikuar idealizmin e Kosovës për pragmatizmin politik të shtetit shqiptar. Klasa politike e Shqipërisë

ka qenë e vetëdijshme se potenciali i këtij shteti është i pamjaftueshëm për ta zgjidhur çështjen e Kosovës, por as aleancat e mundshme të Shqipërisë me fuqitë botërore nuk e kanë pasur ndonjëherë këtë synim. Shqiptarët e Shqipërisë nuk do ta përfshijnë në memorien e tyre historike faktin se gjatë luftërave ballkanike dhe më pas (1913-1915), Serbia do të ushtrojë gjenocid jo vetëm ndaj shqiptarëve të Kosovës, por edhe në brendi të Shqipërisë, ta zëmë në fshatrat e Elbasanit, ku, siç thotë Tucoviqi, ushtria serbe dogji njerëz të gjallë. Shqiptarët e Shqipërisë nuk do ta kenë të lehtë ta kuptojnë se projektet e Garashaninit, Andriqit dhe Çubrilloviqit nuk kishin të bënin në mënyrë specifike vetëm me Kosovën, por me krejt popullin shqiptar."^{xxiv} Edhe unë nuk do ta kuptoj se cili ka qenë qëllimi i Serbisë, meqenëse jam qytetar i Republikës së Shqipërisë, që Serbia, vetëm pse kanë qenë luftëtarë kundër pushtimit prej saj, më ka vrarë gjyshin, xhaxhain dhe dy kushërinj të parë të babait! Pse këto akuza e fyerje? Zotëri Kraja, shtëpinë time të djegur nga Serbia në vitin 1913, pasi e i kishte vrarë të gjithë burrat e shtëpisë dhe që ishte mbajtur ashtu nga gratë e familjes me riparime të pjesshme, e kam prishur unë pas 53 vjetësh për ta bërë të re. Kjo ka ndodhur në vitin 1966. Kujdes zotëri Kraja, se deklarime të tilla përbëjnë krim kundërkombëtar.

Mendoj se nuk bën të bëhen ndarje të shqiptarëve sipas kufijve shtetërorë, sepse po të vlerësohen

ashtu, duhet të ndahen edhe shqiptarët në Maqedoni, edhe shqiptarët në Serbi, edhe shqiptarët në Mal të Zi, edhe shqiptarët në Greqi e edhe shqiptarët në diasporë etj. Na bëhen kështu shtatë hapësira e kategori shqiptarësh. Këtë ka dëshirë zotëri Kraja, t'i copëtojë shqiptarët? Jo, zotëri, mendoj se shqiptarët janë shqiptarë kudo që janë. Nuk e quaj normale të mendohet, jo më të shprehet, se shteti shqiptar prej vitit 1912 e deri sot paska bërë veprime jo konsekuente duke arritur deri atje që të sakrifikojë idealizmin e Kosovës. Nuk mund ta kuptoj një deklaram të tillë të një intelektualit të Kosovës, siç është edhe zotëri Kraja, vetëm nëse këtë e ka shkruar dikush në Beograd.

Mbaj mend se në vitin 2005, kur në Gjenevë të Zvicrës, nën kujdesin e bashkatdhetarëve bëhej përrurimi i librit tim "Kosova dhe Ushtria Çlirimtare", një nga pjesëmarrësit në promovim, kur unë mora fjalën, më bëri një pyetje: - Ne jemi të njoftuar se Enver Hoxha e ka shitur Kosovën, nga ti ta duash Kosovën e të luftosh për të, kur ti ke lindur dhe je rritur nën pushtetin e Enver Hoxhës?

Kurse përgjigja ime ishte: - Enver Hoxha nuk dilte shtatëdhjetë herë në ditë në televizion siç dalin këta të sotmit. Ai dilte në televizion jo më shpesh se një herë në gjashtë muaj. Dhe, këto dalje bëheshin ose kur i thoshin duhet të dalësh në televizion se ka dëshirë populli të të shohë ose kur kishte për të dhënë ndonjë mesazh, që kërkohet të

jepej drejtpërdrejt nga Enver Hoxha në sytë e popullit. Kështu që edukimi atdhetar nuk ishte detyrë e politikës, por e shkollës. Për këtë ishte i angazhuar gjithë sistemi arsimor që kishte ngritur politika e shtetit. Kështu që, në shkollë, unë kur bëja histori, shteti nuk m'i kishte hequr flamujt e shtrirjes së pushtetit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit edhe në Ulqin, Tivar, Podgoricë, Plavë e Guci, Nish, Vranjë, Prokuple, Kumanovë, Shkup, Strugë, Ohër, Dibër e Madhe, Manastir e Tetovë, Gostivar e Kërçovë, Kostur, Janinë, Artë e Prevezë. Ashtu si në Tiranë, Durrës, Korçë e Shkodër. Prandaj unë gjithnjë e kam ditur ku është atdheu im dhe çfarë detyrimesh kam ndaj atdheut tim. E, Enver Hoxha kurrë nuk na tha që të shkullim flamurin nga ndonjë pjesë e hapësirës kombëtare se e kam shitur atë. Përkundrazi, me shumë forcë u bënë përpjekje ta dimë mirë deri ku është Shqipëri.

Ndërkaq, sot vjen zotëri Mehmet Kraja nga detyra e kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e u thotë shqiptarëve që banojnë në Republikën e Kosovës të bëjnë kujdes e të ruhen nga shqiptarët që banojnë në Republikën e Shqipërisë se ata e shpërdorjnë idealizmin e tyre dhe përftojnë për interesat e tyre nga ky idealizëm. Singulisht, befasohe! Nuk kam menduar se mund të ketë një shqiptar të zakonshëm që të mendojë kështu, jo të kemi një akademik me funksion epror që të deklarojë publikisht e botërisht përfundime të tilla përçarëse për kombin të cilit i përket.

Por të ballafaqohesh me vlerësimet e mëposhtme të këtij raporti, më duket se realisht deklarime të tilla nuk mund të bëhen nga ndonjë shqiptar sadopak i përgjegjshëm për kombin e tij. Të shohim çfarë thuhet tjetër në këtë raport: *"...në memorien historike të Shqipërisë edhe sot do të ushtrojë ndikim të madh fakti se Jugosllavia ishte eksportuesja kryesore e ideve komuniste në Shqipëri. Ajo ishte themeluese e Partisë Komuniste të Shqipërisë, duke e përfshirë lëvizjen komuniste të Shqipërisë në agjenturat e Kominternit dhe duke ia caktuar Shqipërisë vendin në hemisferën lindore të ndarjeve ideologjike pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse marrëdhëniet me Jugosllavinë u prishën shumë shpejt (1948), komunistët shqiptarë e panë si ideal edhe për shumë kohë (madje me kompleks inferioriteti) Jugosllavinë e Titos dhe socializmin e saj vetëqeverisës. Historikisht është e njohur se afrimi i Shqipërisë në çfarëdo mënyre me Jugosllavinë ose Serbinë, doemos duhet të eklipsonte çështjen e Kosovës, madje shpesh ta sakrifikonte atë."*^{xxv} Të njohësh historinë e Shqipërisë dhe të mendosh e deklarosh se Jugosllavia ishte eksportuesja kryesore e ideve komuniste në Shqipëri është vërtet për të ardhur keq. Por më keq akoma të deklarosh pa detyrim se Partinë Komuniste të Shqipërisë e kanë themeluar jugosllavët, kur dihet se lëvizja komuniste në Shqipëri ka filluar që në vitin 1925 me krijimin

në Vjenë të "Komitetit Nacional Revolucionar" (KONARE) nga Fan Noli dhe elementë të tjerë revolucionarë, si organizatë që mori kontakte dhe bashkëpunoi me Internacionalen Komuniste. Prandaj, ta quash lëvizjen komuniste shqiptare pjesë të agjenturave të Kominternit, duket sikur jemi duke u marrë me konspiracionizëm të kulluar, ku mund të thuash çfarë të të shkrepet mjafton ta artikulojë në mënyrë bindëse për të kënaqur vetveten pavarësisht nga vërtetësia historike. Për çudi, që sot po zbulojmë edhe diçka shumë interesante, të cilën nuk e paskemi ditur, se shteti - Republika e Shqipërisë paska qenë gjithnjë inferior ndaj Jugosllavisë së Titos dhe socializmit të saj vetëqeverisës. Dhe, më interesant del "fakti" që Republika e Shqipërisë për hir të afrimit me Jugosllavinë ose Serbinë, paska eklipsuar çështjen e Kosovës e aq më rëndë e paska sakrifikuar atë.

Nuk e kuptoj çfarë interesi ka Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, në veçantë kryetari i saj, të flasë me kaq përbuzje për Republikën e Shqipërisë. Përse nuk ka dëshirë ky institucion që të tregohet e vërteta, por shpif në një mënyrë të tillë që do ta kishin zili edhe akademikët serbë! Si ka mundësi të shprehen mendime të tilla sot, kur shqiptarët janë më të fuqishëm se kurrë në historinë e tyre? Pse e pengon këtë Akademi fuqizimi i shqiptarëve në Ballkan? Kurrë nuk kam për ta kuptuar pse deklarohet kështu, nëse këto nuk janë deklarime të formuluar në Beograd!?

11. Një raport kundërshqiptar, më i rëndë se raporti i Dik Matit

Realisht unë kam kuptuar që ky është një raport kundërshqiptar, më i rëndë se raporti i Dik Matit, i cili merret me një periudhë të caktuar dhe të shkurtër akuzash kundërshqiptare dhe kryesisht kundër Luftës dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kurse ky raport i dytë, që për fat të keq shkruhet nga një shqiptar në emër të institucionit më të lartë shkencor të Republikës së Kosovës, përpigjet të na e përbaltë gjithë historinë nga kohët e hershme deri në ditët tona. Nuk kishim nevojë për këtë raport alla Dik Marti, që e shumëfishon fuqinë goditëse kundërshqiptare! Dhe, më tej, pa asnjë argument vijohet të thellohet pa kurrfarë nevojë hendeku imagjinar i zotëri Krajës për ndarjen e shqiptarëve nëpërmjet këtij paragrafi: *"Pavarësisht se shoqëria shqiptare gjatë këtyre tridhjetë vjetëve të fundit është shoqëri pa ideologji, recidivizmi ideologjik herë pas here rishfaqet në disa forma: si nostalgji, si majtëzim ekstrem, si lidhje klanesh, si refuzim ndaj Kosovës dhe, herë pas here, si lidhje me e ngushtë botëkuptimore me Serbinë dhe me proveniencën lindore."*^{xxvi} Kjo vjen thjesht si një cikël shpifjesh të nivelit më të ulët të mundshëm. Sepse nëse do të kishte argumente, që zakonisht

përbëjnë një analizë të mirëfilltë shkencore, siç pretendon të jetë ky raport, do ta kishim duartrokitur. Por kjo mënyrë e ulët shpifjeje më çudit deri në atë masë, sa të pyes veten se si mund e duhet të jetë portreti i një akademie të shkencave a e një akademiku? Sikur edhe thjesht të ishte bërë shpjegimi i termave që janë përdorur, ky raport do të ishte më funksional. Por aty vetëm sa janë renditur me shumicë elemente të negativitetit shoqëror, politik, mjedisor dhe gjeopolitik, por që në asnjë mënyrë nuk mund të jenë askund në botë elemente të një kombi siç janë shqiptarët, të cilët zotëri Kraja paska alergji t'i shikojë bashkë, të mos themi për t'i parë të bashkuar që nuk di çfarë do të kishte bërë për t'i ndarë e copëtuar. Madje arrihet deri në ekstrem: *"Më anë tjetër, në Shqipëri tashmë është ngulitur ideja se Kosova paraqet pengesë të bezdisshme për marrëdhëniet miqësore me Serbinë dhe me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe se përfitimet ekonomike të Shqipërisë nga këto marrëdhënie, po të mos ishte problemi i Kosovës, do të ishin shumëfish më të mëdha, veçmas në fushën e turizmit dhe të transportit. Prandaj, që 20 vjet e kënde, çështja e Kosovës për Shqipërinë politike dhe ekonomike kundrohet si sakrificë, të cilën ajo e bën në dobi të një ideje tashmë të vjetruar nacionaliste!"*^{xxvii} O zot, deri ku shkon mendja e sëmurë njerëzore?! Vetëm kjo besoj se nuk i ka shkuar në mendje askujt përveç raportshkruesit. Mos mor zotëri, na lë more të bëjmë jetën tonë kombëtare siç dimë ta bëjmë ne shqiptarët. A ke parë ndonjë ëndërr zotëri që Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës kanë dërguar ushtritë e tyre në kufi përballë njëra-tjetrës? Se vetëm këtë ke lënë mangut pa e thënë në këtë raport!?

12. Raport i zi për shqiptarët, që nuk duhet marrë seriozisht

Nuk mjafton që në këtë raport bëhet thirrje që Republika e Kosovës të bëjë kujdes e të ruhet nga rreziqet e kërcënimit që i vijnë nga Republika e Shqipërisë, por shkohet edhe më tej, duke vajtuar se Republika e Shqipërisë paska prishur edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe e paska bërë të vajtueshme gjendjen e saj, madje deri edhe kundërshtare të Republikës së Kosovës prej kur nga ky shtet është larguar Gruevski. Vlerësoni çfarë thotë raportshkruesi: *"Rëndësia e pjesëmarrjes së gjerë të shqiptarëve në jetën politike të Shkupit, që mund të konsiderohej si një lloj katalizatori i stabilitetit, duke ruajtur balancat politike të brendshme dhe të jashtme të vendit, përnjëherësh u përmbyës dhe u zhvlerësua. Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk janë më faktorë relevantë, as në politikën e brendshme, as në politikën e jashtme të këtij shteti, sepse peshën e tyre qeveria e Shkupit e ka zëvendësuar, ose synon ta*

zëvendësojë me një afrim të drejtpërdrejtë me Tiranën, duke e anashkaluar ose duke e bërë të parëndësishëm faktorin e brendshëm shqiptar. Pranimi në NATO i Maqedonisë së Veriut nuk u lexua në Shkup vetëm si forcim i sigurisë dhe i pozitës ndërkombëtare të këtij shteti, por më shumë si mundësi për të bërë ndryshime strukturore në politikën e brendshme dhe të jashtme, siç është afrimi me Serbinë dhe anashkalimi i faktorit të brendshëm shqiptar, si përcaktues i konfigurimit politik të vendit. Në të vërtetë, që me largimin e Gruevskit nga Maqedonia përmes një marrëveshjeje Zajev - Ahmeti - Rama dhe më pas Vuçiq, u pa qartë se ky koalicion në të ardhmen do të forcohet edhe më shumë, duke e kthyer faktorin shqiptar të Maqedonisë së Veriut në shërbyes të tij."^{xxviii}

Ndërkaq, unë që mendoj se e njoh gjendjen edhe në Maqedoninë e Veriut, mund t'u them me siguri të plotë jo vetëm shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, por të gjithë shqiptarëve në Ballkan dhe kudo ku jetojnë në mbarë botën, se shqiptarët më të fuqishëm se sot për të qenë me dinjitet dhe të sigurt në trojet e tyre nuk kanë qenë kurrë. Pavarësisht se nuk pretendohet se janë arritur majat, mund të them se shqiptarët në Ballkan, të cilët kanë një histori të pasur e dinamike, ndryshe nga errësira që përhap akademiku Kraja; në këtë kohë që jetojmë, historisë së tyre i kanë vënë kurora lavdie. Dhe, lavdi historike konsideroj Luftën Çlirimtare të Kosovës, që krijoi shtetin e Kosovës, duke i bërë të lirë dy milionë shqiptarë dhe duke bërë që Kosova të jetë një shtet i njohur nga më shumë se gjysma e shteteve të botës. Po ashtu një kurorë lavdie konsiderohet sakrificat e burrave të Kosovës Lindore, që bënë Luftën për Çlirimin e Kosovës Lindore dhe nëpërmjet së cilës bënë që bota të kuptojë përfundimisht se ato treva janë treva të banuara prej shqiptarëve historikisht. Kurora tjetër është Lufta Çlirimtare në Maqedoninë e Veriut, e cila i bëri shqiptarët autoritet në atë shtet, që deri dje i vriste vetëm pse protestonin për universitet. Prandaj, duhet të bëjmë vlerësime reale për zhvillimet historike dhe është madhështi t'u themi faleminderit të gjithë atyre që ndërmorën dhe udhëhoqën këto luftëra, që i bënë shqiptarët më të autoritetshëm se asnjëherë më parë.

Unë nuk mund të justifikoj faktin që zotëri Kraja, duke luajtur me modelin serb të viktimës, po përpigjet ta bëjë Kosovën viktimë të politikës shqiptare në Maqedoni, sepse sipas tij, Maqedonia e Veriut nuk e do Kosovën, mbasi ajo paska mundësi ta emancipojë kundërfetarisht, por që Maqedonia e Veriut qenka e interesuar t'i manipulojë me islamin, duke mos e lënë Kosovën të shkojë dhe t'i zhvillojë ata që të bëhen të pa fe. Por cila është arsyeja që ky zotëri mendon se Kosova është e pa fe nuk e kuptoj, dhe shteti i Maqedonisë së Veriut

qenka shumë i interesuar "...iv) të shmangë Kosovën nga agjenda politike, duke e identifikuar atë si burim të nacionalizmit, për ta relativizuar peshën e saj të faktorit shqiptar i Maqedonisë së Veriut; dhe v) të shmangë lëvizjet emancipuese nga Kosova, që ushtrojnë ndikim te shqiptarët, në mënyrë që t'i krijohet hapësirë e patrazuar manipulimit fetar islamist, duke vazhduar traditën e hershme të kohës së ish-

Jugosllavisë."^{xxix} Por zotëri Kraja nuk na thotë se në cilën kohë jeton, pasi mendon se ende është koha dhe mendësia politike e Jugosllavisë. Për ta fuqizuar shkëputjen e Kosovës nga Maqedonia, duke i bërë shqiptarët në këtë shtet të çorientuar, të cilët duke u lidhur me Tiranën, siç shprehet akademiku, e paskan lënë anash Kosovën. Çudi! Por, për këtë të shohim më poshtë në këtë raport të zi: *"Mirëpo, shkëputja e lidhjeve tradicionale të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut me Kosovën do të shkaktojë pashmangshëm disa pasoja të rënda dhe do t'i sjellë dëme të mëdha jo vetëm komunitetit shqiptar, por edhe vetë shtetit maqedonas, siç është shtrirja më agresive e radikalizmit islamik, i pabaraspeshuar dhe "i pakontrolluar" nga ndikimi emancipues i Kosovës; radikalizimi i një pjese të faktorit politik shqiptar; i cili nuk do të ndihet mirë nën ombrellën anacionale të Tiranës; përçarjet e brendshme të faktorit politik shqiptar (sipas modelit të Tiranës), që mund të çojnë deri te destabilizimi i Maqedonisë së Veriut etj. Për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, Kosova ka qenë dhe vazhdon të jetë lidhje shpirtërore, që nuk mund të minimizohet, aq më pak të*

mënjanohet tërësisht."^{xxx} O zot, çfarë terroristi është ky zotëri, akademik shqiptar? Nuk di se si mund ta shprehë urrejtjen më reptë një njeri. Nuk di se pse e sheh të keqen e shqiptarëve te shteti i Shqipërisë, pasi deri me gjithë informacionin që ekziston, me gjithë dokumentet historike, me gjithë veprimtarinë praktike, Shqipëria, pavarësisht nga problemet që ka pasur e ka brenda vetes, pavarësisht nga gjendja e saj edhe ekonomike, mbasi demokracia i ka sjellë disa pëshëjllime, Shqipëria për trojet shqiptare jashtë kufijve të saj dhe për shqiptarët që i banojnë ato, historikisht ka punuar dhe punon me përkushtim dhe deri tash, veç të mirave, asnjë të keqe nuk u ka sjellë as Kosovës, as Maqedonisë e as Malit të Zi dhe as Kosovës Lindore. A ka bërë sa duhet të bënte, nuk mund ta them po, por mund të them se edhe rrethanat nuk kanë qenë gjithnjë të favorshme. Por të bëhet thirrje publikisht që Kosova dhe Maqedonia nëse duan të shpëtojnë, duhet të shkëpusin çdo kontakt me Shqipërinë, këtë e bën vetëm zotëri Kraja nga pozita e kryetarit të Akademisë së Kosovës. Veprim i tmerrshëm, i turpshëm dhe kundërshqiptar!

Megjithatë, kam dëshirë që për të gjithë ata që kanë kuriozitetin të jenë të qartë ku mbështetet politika e shtetit të Republikës së

Shqipërisë, dua të citoj preambulën e kushtetutës së këtij shteti të miratuar me referendum popullor në vitin 1998, ku thuhet: "Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim të zoti dhe llogaritje të vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të drejtë, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit."^{xxxvi} Vetëm këtë po të kishte lexuar e vlerësuar zotëri Kraja nuk do të kishte guxuar të fliste, të deklaronte e të shpifte aq ndyrë dhe armiqësisht ndaj Republikës së Shqipërisë.

13. Njohjet nga shtetet dhe territoret e Kosovës, një shqetësim pa bazë

Zotëri Kraja edhe çështjen e njohjeve nga shtetet e tjera të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur e vë në dyshim, pasi thekson se "... zhvillimet brenda vetë Kosovës ndikuan negativisht në njohjet ndërkombëtare, veçmas qeverisja e keqe, korrupsioni dhe krimi i organizuar bënë që shumë shtete ta shikojnë me skepticizëm të ardhmen e Kosovës, ndërsa Serbisë i krijuan argumente lehtësisht të përdorshme për propagandën e saj kundër njohjeve..."^{xxxvii} Nuk e kuptoj vërtet ky zotëri ende mendon se mund të kthehet Kosova në Serbi? Nëse ka këtë mendim, gabon rëndë dhe ia largoj unë merakun, se kjo nuk ka për të ndodhur kurrë sa të ketë shqiptarë në këto hapësira shqiptare.

Kurse për këto që thekson në vijim, se "... hapja e çështjeve territoriale në dialog me Serbinë, që u pranua si opsion nga një pjesë e elitës politike të Prishtinës, ishte dëmi më i pariparueshëm për pozitën ndërkombëtare të Kosovës, sepse nga një "çështje e mbyllur", e bëri Kosovën "çështje të hapur", posaçërisht për një numër shtetesh ende të pavendosura..."^{xxxviii} Unë dua të shtroj një çështje për të gjithë ata që nuk di si e kuptojnë këtë proces. Por di se Kosova me Shqipërinë ka një kufi të njohur ndërkombëtarisht, me Maqedoninë e Veriut, mbas bisedimesh e debatesh të gjera, duke humbur një hapësirë tokësore, Kosova përfundimisht ka përcaktuar kufijtë e njohur ndërkombëtarisht; po kështu ka vepruar edhe me Malin e Zi, ku përsëri ka humbur hapësira tokësore, por ka vendosur kufijtë e njohur ndërkombëtarisht. Ndërsa me Serbinë ende nuk e ka bërë këtë, së pari se ende nuk është arritur në atë shkallë, por që do të

shkohet edhe në këtë aspekt. Pas kësaj panorame, duhet bërë pyetja: Kur të fillojnë bisedimet me Serbinë për këto çështje, a do të fillohet përsëri të bëhet shaka nga zotëri Kraja e ndonjë tufë politikanësh?

Po kështu, duke folur për njohjet e shtetit të Kosovës prej shteteve të tjera, është befasuese akuza e akademikut Kraja, pasi ai shkurt e shqip thotë: "Kosova bëri gabim të madh që pranoi njohje të sponsorizuara në mënyrë korruptive..."^{xxxix} Singerisht më duket se të bësh akuza të tilla për shtetin tonë, që jo vetëm nuk ka ditur e nuk di se si mund të korruptojë shtetet e tjera, por as nuk ka fuqi ta bëjë këtë, sepse nëse ekziston ky lloj korrupsioni, është korrupsion i rëndë, nuk kalohet me një kafe. Por këtë e di akademikun e do të ishte mirë ta bënte publike mënyrën se si korruptohen shtetet. Ndërsa për sa i përket asaj që akademikun Kraja e quan ndarje të Kosovës, unë nuk e kam dëgjuar kurrë të dokumentuar këtë term, përveç në debatet politike dhe analizat mediatike, ku secili flet si i pëlqen dhe i jep vetes të drejtë.

Por unë kam dëgjuar qysh para çlirimit të Kosovës dhe pas çlirimit për ndryshim të kufijve të Kosovës për të kaluar në atë të ndryshuar nga Beogradi në vitin 1953, kur edhe Kosova Lindore ishte pjesë e Kosovës, dhe unë me dëshirë që nesër do ta bëja këtë ndryshim kufijsh, pa më shkuar fare në mendje se po gaboj kombëtarisht. Por të deklarosh se është kërkuar e pranuar që të ndahet Kosova, duke thënë "...u paraqitën ide, të cilat kishin synim ta zgjidhnin çështjen e Kosovës me një "prerje" radikale, duke e ndarë territorin e saj dhe duke e "pajtuar" Serbinë me humbjen e paevitueshme të Kosovës..."^{xl} Kjo më jep shije të hidhur. Dhe, është interesant, se këtë veprim kundër atdheut të tyre, po e bëkan luftëtarët që e kanë çliruar me armë, të gatshëm të japin edhe jetën për ta parë të lirë. Po e mbron zotëri Kraja, i cili kur në Kosovë luftonin ata që ky i akuzon, nuk dihet ku ishte, por vetëm në luftë e në Kosovë nuk ishte.

14. A qëndron mendimi, që, sipas këtij raporti, është krijuar një grup armiqësor kundërshqiptar?

Ajo që të befason është fakti se akademikun ka aq guxim, sa të krijojë një grup kundër-Kosovë, në të cilin ndër të tjerë janë Çubrilloviqi, Qosiqi dhe Hashim Thaçi. Se me çfarë logjike është folur në këtë çështje, nuk arrij të bindem se një njeri normal mund ta bëjë një vlerësim të tillë nëse nuk është nën ndonjë trysni të papërbalueshme ose përbalë ndonjë rreziku fatal.

Dhe, për ta korrigjuar raportin e tij, akademikun Kraja, meqenëse iu duk pak vetëm Hashim Thaçi në grupin kundër-Kosovë, pas disa ditësh që e publikoi këtë raport, do të shkruante: "Pasi u kuptua se ish-liderët e UÇK-së mund të ishin objekt i Gjykatës Speciale, u

intensifikuan edhe ecejaket e emisarëve "diplomatikë", të cilët filluan të lëviznin me një shpejtësi në prapaskenat e qendrave politike vendimmarrëse, pothuajse në të gjitha shtetet që mund të kishin ndikim në këtë zhvillim."^{xli} Pra, tashmë në këtë grup armiqësor kundër-Kosovë nuk është vetëm Hashim Thaçi, por të gjithë udhëheqësit e Luftës Çlirimtare të Kosovës. Mbetet vetëm për të bërë evidencën, por nuk e di deri në çfarë niveli do të zbresë zotëri akademikun Kraja. A do të përfshihen edhe komandantët e zonave e brigadave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo do të mjaftohet vetëm me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, nuk mund ta di. Të shpresojmë të mos i shkojë mendja për ndonjë ndryshim të ri, se mund të të akuzojë ndoshta edhe të gjithë luftëtarët e UÇK-së. Por nuk më vjen çudi, pasi e di se Serbia na ka dënuar edhe dëshmorët me nga njëzet vjet burg në mungesë, një vit pas rënies së tyre në altarin e kombit. Shikoni aktgjykimet e Serbisë.

Po e njëjta gjë ndodh edhe me pjesën tjetër, atë të Maqedonisë së Veriut, pasi në variantin e parë ngarkon me përgjegjësi vetëm zotëri Ali Ahmetin, në variantin e korrigjuar nuk e lë as atë vetëm, prandaj thotë: "Më anë tjetër, mbështetja që mori nga disa liderë shqiptarë të Maqedonisë së Veriut, se do ta pranonin në qetësi ndarjen e Kosovës, duke mos kërkuar që ata të bashkoheshin me Kosovën ose me Shqipërinë dhe duke mos e copëtuar këtë shtet, nuk kishte asnjë garanci se me një agjendë të këillë nuk do të rrënohej njëkohësisht edhe paqja e brishtë në Maqedoninë e Veriut."^{xlii} Pra, edhe atje u duk pak vetëm Aliu dhe duheshin përfshirë edhe të tjerë, megjithëse ndoshta jo të gjithë. Kështu duket se në Maqedoninë e Veriut paska ndonjë që Akademiku nuk dëshiron ta akuzojë si pjesë e grupit armiqësor kundër-Kosovë. Megjithatë, unë kam dëshirë t'ia heq merakun akademikut Kraja se Maqedonia e Veriut kurrë nuk do të shpërbëhet. Shqiptarët nuk do të jenë për asnjë arsye kërkuar të shpërbërjes së Maqedonisë dhe nuk do të jenë shtojcë as të Shqipërisë, as të Kosovës. Ata kanë aq forcë dhe guxim sa ta shohin Maqedoninë e Veriut si shtetin e tyre dhe të kontribuojnë për ta zhvilluar atë sepse janë në tokën e tyre, në të drejtën e tyre dhe ndërtojnë shtetin e tyre. As mos u merr më me këtë çështjen e shpërbërjes së Maqedonisë së Veriut se nuk të dëgjojnë edhe sikur të jesh shumë i interesuar për këtë.

15. Raport që tenton të ligjërojë akuzat kundër Luftës Çlirimtare të Kosovës

Qëndrimi që i vë vulën gjithë kundërshqiptarizmit të këtij raporti është fakti që akademikun Kraja, nuk e di për çfarë arsyesh ligjëron akuzat ndaj Luftës Çlirimtare të Kosovës, në nivelin që

i ngre ato raporti i Dick Marty-t. Dhe këtë akademikun Kraja e shpreh kështu: "Megjithatë, sido që të ishte sistemi gjyqësor i Kosovës dhe pavarësisht nga fakti se në mënyrë jo të drejtë u vendos një shenjë barazimi midis agresorit (Serbisë) dhe viktimës (Kosovës), në periudhën e luftës dhe menjëherë pas saj u kryen krime, disa prej të cilëve mund të kualifikoheshin si krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, vetëm se një pjesë e mirë e krimeve të kësaj natyre u kryen jo vetëm si hakmarrje ndaj serbëve lokalë, por edhe ndaj kundërshtarëve politikë

shqiptarë."^{xliii} Duhet marrë në konsideratë se të gjitha këto që akademikun Kraja i ligjëron si krimet të luftës e krime kundër njerëzimit, në aktakuzën e gjykatës kanë rënë thuajse të gjitha, për arsyen e thjeshtë se ishin të montuara e të përpunuara nga prokuroria serbe në Beograd së bashku me ligjërues të tillë si akademikun Kraja. Tashmë, meqenëse këto akuza të formuluar nga Dik Marti kanë rënë, siç duket doli një dëshmitar i ri, i cili realisht duhet të shkojë në Hagë ta vërtetojë akuzën e tij. Ky është zotëri Kraja, i cili ndoshta ka informacione më të thelluara se prokuroria e Serbisë.

Po kështu, thuajse i vjen në ndihmë Memorandumit 2 të Akademisë së Shkencave të Serbisë, në të cilin, ndër të tjera, thuhet se synimi i këtij dokumenti: "- Zvogëlimi i përgjegjësisë së Serbisë për krimet dhe shkatërrimet, akuzat, ndjekjet dhe proceset e montuara kundër shtetasve të BiH, Kroacisë dhe Kosovës dhe vendosja në pozitën e barabartë me shtetet përreth.

- Destabilizimi i qeverive të vendeve fqinje, provokimi i pakënaqësive të brendshme dhe trazirave dhe dobësimi i mprehtësisë së akuzave kundër Serbisë.

- Me aksione pendese vendosja e Serbisë në pozitën e njëjtë me të vuajturit dhe të dëmtuarit."^{xliiii} Dhe, besoj për gjithkënd është e qartë se sa mirë bën përpjekje raporti i akademikut Kraja për t'i barazuar krimet, duke deklaruar se edhe Kosova, më saktë Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë krime si Serbia.

Ndërsa në vijim akademikun Kraja thekson: "Po ashtu, tashmë është krijuar bindja se Gjykata Speciale, e themeluar nën trysinë e faktorit ndërkombëtar, as do të formohej dhe as do të niste nga puna, ...sikur nomenklatura politike e Kosovës, trashëgimtare e drejtpërdrejtë e UÇK-së, të mos e uzurponte pushtetin dhe institucionet vendore."^{xliiii} Nuk e di përse partitë politike në Kosovë nuk janë distancuar nga qëndrime të tilla, mbasi sistemi politik në Kosovë prej çlirimit është sistem demokratik dhe nuk kam asnjë informacion se në Kosovë është bërë grushtshteti, por, përkundrazi, luftëtarët kur kanë mbetur në opozitë si rrjedhojë e votës së popullit, kanë qëndruar mjaft mirë në opozitë. Prandaj, mendoj se ky vlerësim në raportin e akademikut Kraja përbën precedent për të sotmen dhe të ardhmen që kush merr pushtetin

të quhet ose hajdut votash ose puçist. Partitë politike nuk duhet të pajtohen me këtë raport se do të dëmtojnë veten dhe pushtetin e tyre në të ardhmen.

Ndërsa në një paragraf më poshtë të raportit të tij, akademikun Kraja bën një vlerësim të çuditshëm: "Më anë tjetër, ish-krerët e UÇK-së u përpoqën disa herë ta zhbënin Gjykatën Speciale, synuan të përdornin fuqinë e tyre të votës në Parlament dhe, mbi të gjitha, të nxitnin opinionin publik kundër Gjykatës, duke u mbështetur te ndjeshmëria e popullit të Kosovës ndaj vlerave të UÇK-së dhe të luftës për liri."^{xliiii} Dua t'i kujtoj zotëri Krajës se ajo gjykatë speciale u ngrit me votat e atyre që ai i akuzon se nuk deshën ta lejonin e se deshën ta zhbënin atë gjykatë.

Ndërsa dua të qartësoj për të gjithë qytetarët e Kosovës, gjithë shqiptarët kudo që janë dhe të gjithë qytetarët e botës, që janë të interesuar të dinë se luftëtarët në politikë e në Parlamentin e Kosovës, që votuan themelimin e kësaj gjykate speciale, që në fillimet e veprimtarisë së kësaj praktike e kanë ditur se do të jenë të akuzuar prej saj. Por për hatër të pastimit të historisë së Kosovës e të luftës që ka bërë për t'u çliruar, kanë pranuar të përballen me këto akuza dhe për ta pastruar veten dhe gjithë Kosovën nga llumi që përpiqen t'ua lëshojnë në shpinë të gjithë ata që u është prishur interesi duke u çliruar Kosova e duke u bërë shtet sovran dhe i pavarur.

Uroj që akademikun Kraja të mos e ketë deklaruar këtë raport të rëndë kundërhistorik për Kosovën dhe gjithë shqiptarinë i nxitur a i detyruar.

16. Reagime ndaj këtij raporti nga intelektualë e politikanë shqiptarë

Duke lexuar disa nga reagimet ndaj këtij raporti alla Dik Marti, më tërheqin vëmendjen me mençurinë dhe kthjelltësinë e tyre disa intelektualë e politikanë, reagimet e të cilëve arrita t'i lexoj për të krijuar një ide të qëndrimeve që mbahen. Dhe, fillimisht u ndala te reagimi i prof. dr. Sabit Syla, në Institutin e Historisë, në Prishtinë, të titulluar: "Reagim lidhur me analizën politike të Mehmet Krajës, "Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor". Këtë reagim, pasi e lexova, evidencova disa çështje të ngritura prej tij, me të cilat jam plotësisht dakord dhe nuk besoj se ka nevojë për komente shtesë. Në fillim të këtij reagimi realisht shkencor thuhet: "... Mehmet Kraja do të duhej të synonte në bashkimin e kërkuar dhe studiuvesh të shkencave të disiplinave albanologjike, për të diskutuar, vlerësuar dhe ridimensionuar studimet tona të përbashkëta, që me argumente shkencore, të pavarura e neutrale, të dalim para botës me teorinë për vijimësinë iliro-shqiptare, trashëgiminë etnike dhe kulturorë të shqiptarëve në hapësirat ballkanike, për studimet letrare, antropologjike, kulturore e muzikore, e hartimin e objektivave

dhe platformave për zgjidhjen e çështjes kombëtare, apo të paktën me platformë për punën me shqiptarët jashtë atdheut gjatë periudhës së ardhshme.”^{xlii} Sa mirë do të ishte të kishim një angazhim të tillë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, por nuk lë mundësi akademiku Kraja, sepse “...ai del me analiza politike tejet të dëmshme, siç është e ashtuquajtura analizë “Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor”. Sikurse dëfton emri i këtij dokumenti, qëllimi primar në thelb del ulja e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, e në linjë me këtë edhe të asaj politike e atdhetare.”^{xliii} Kjo është superabsurde. Një qëndrim të tillë nuk e gjejmë në asnjë dokument të shkruar diku për interesat kombëtare të një kombi.

Dhe në vijim profesor Sylja thotë: “Analiza politike e akademik Krajës, për Ilirët, Mesjetën e për shqiptarët në përgjithësi që flet prej shekullit XVIII e këndeje, ka sjellë shumë pasaktësi në shkencë dhe në opinionin publik. Madje ka vazhduar t'i kultivojë e përterijë edhe disa nga teoritë historiko-politike të fushës së historiografisë serbe...”^{xliv} Dhe mund të them se për këtë jam plotësisht i bindur, pasi librin e Konstandin Jeriček “Historia e Serbisë” e kam lexuar, sepse është i përkthyer edhe shqip pa asnjë lloj oponente pikërisht nga shkencëtarët që e kanë përkthyer, mbasi siç duket ka akoma të tillë që duan të instalojnë në memorien e shqiptarëve ato që thonë e deklarojnë serbët për shqiptarët.

Po kështu, profesor Sylja qartëson dhe orienton, për paraqitjen e këtij raporti e vlerat e tij edhe kur vjen te vlerësimi në këtë raport i Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe ushtrisë që e bëri atë. Për këto lexojmë arsyetimet: “Nga përmbajtja e materialit shikohet qëndrim mjaft i ashpër ndaj ish-drejtesve të luftës çlirimtare. Tërheq vëmendjen edhe fakti, që analiza e Krajës del në momentet që siç dihet pritet gjykimi i drejtuesve të luftës çlirimtare. Andaj jo pa qëllim filloi kjo fushatë e ndërmarrë në këtë drejtim për të intensifikuar më tej, të gjitha veprimtaritë antishqiptare, për gjykimin e liderëve të luftës. Në vend që z. Kraja të punonte për të frenuar një proces të tillë, mbi bazën e fakteve dhe argumenteve shkencore, pasi në zhvillimet historike, në rrjedhën e viteve dhe shekujve, ka ngjarje që për domethënien e tyre, qëndrojnë si udhërrëfyese në udhëkryqet e mëdha të historisë e ajo që zë vend nderi në histori është Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. UÇK-ja pavarësisht lëkundjeve nëpër kundërthëniet e kohës tashmë 23 vite me radhë, ka ngel projektit themeltar i shtetit modern shqiptar në Kosovë, shkëlqimi i së cilës nuk shuhet kurrë.”^{xlv} Nuk besoj se gjendet dikush ndër shqiptarët e të gjitha kategorive që mund të arsyetojë të kundërtën e këtij qëndrimi, përveç shkruarit të raportit që merret në analizë.

Dhe, në vijim profesor Sylja thotë: “Mobilizimi dhe armatosja e

serbëve vendorë kishte karakter masiv. Një raport nga mbledhja e Shtabit të MPB të mbajtur me datë 28 korrik 1998 thuhej se ishin formuar 243 njësi të policisë rezervë në të cilat bënë pjesë banorët e fshatrave/çyteteve përkatëse dhe ishin armatosur rreth 54.683 njerëz, 12.170 prej të cilëve u armatosën nga MPB kurse 34.716 nga UJ, derisa 7.797 ishin armatosur qysh më herët. Për më tepër raporti thekson se në Kosovë kishin arritur edhe 5.070 armë shpërndarja e të cilave ishte duke vazhduar. U vlerësua se në këtë proces duhej të armatoseshin rreth 60.000 persona.^[66] Kjo shifër prej 60.000 serbësh vendorë jep të kuptohet se ishin mobilizuar pothuaj të gjithë meshkujt serbë të aftë për armë. Këto të dhëna të mësipërme janë nga pala serbe, andaj për çfarë civilësh flisni, pasi ata ishin të armatosur?”^{xlvi} Është krejt e vërtetë, veçse dua të saktësoj se në numërimin përfundimtar, në Kosovë gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës kanë qenë 63 mijë civilë serb, banorë të Kosovës të armatosur dhe të organizuar ushtarakisht për luftë. Këta serbë të armatosur u shtoheshin rreth 70 mijë trupave ushtarake, 12 mijë trupave policore, 8 mijë trupave paramilitare dhe 5 mijë trupave kriminale vullnetare të liruara nga burgjet për të luftuar në Kosovë e për të bërë krime me kushtin e lirim nga burgu pas përfundimit të luftës. Kështu që 158 mijë trupa të armatosura të pushtuesit në Kosovë nuk kanë lënë vend për të bërë UÇK-ja si të dëshironte, por vetëm mund të shfrytëzonte malet për të luftuar kundër pushtuesit e mbrojtur qytetarët që kishin braktisur shtëpitë e tyre dhe ishin strehuar në to për të shpëtuar prej masakrave.

Një tjetër reagues, Mirlind Behluli, shprehet se “... gjuha e përdorur shpesh është politikisht jo korrekte, duke i ngjarë më shumë një fletërrufeje sesa analizës së mirëfilltë.”^{xlvii} Ky vlerësim më ktheu vërtetë në vitet '70 në Shqipëri, kur funksiononte sistemi i fletërrufeve, që duke bërë përpjekje të korrigoreshin të metat nxiheshin portretet e njerëzve dhe të institucioneve me deklarime pikërisht si të këtij raporti. Ashtu edhe akademiku Kraja, nën pretekstin e korrigjimit të të metave në jetën kombëtare shqiptare, e ndynë me sa fuqi ka historinë kombëtare, e nxinë gjithë jetën kombëtare, e pëshytyrë gjithë politikën shqiptare nëpër kohë, e thyen gjithçka me vlerë dhe tenton të krijojë përçarje ekstreme kombëtare shqiptare.

Zoti na ruajt nga akademiku, sepse po të ketë më tepër fuqi nuk di çfarë do të kishte bërë mbi kombin të cilit ndoshta për fatin e tij të keq i përket, mbasi duket se ky komb nuk është i denjë për të pasur të vetin një figurë si e tij.

Se sa të rrepta janë përpjekjet përçarëse në këtë raport e thotë qartë edhe reaguesi në fjalë, kur shprehet: “Për më shumë, dokumenti ka ... gjuhë paranojake e paragjyquese ndaj Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Partisë Socialiste e Partisë Demokratike të

Shqipërisë dhe fesë islame.”^{xlviii} Çka lë të kuptohet se Kosova vetëm nga shqiptarët nuk duhet t'i kthejë sytë dhe qytetarët e Kosovës duhet të largohen nga feja Islame. Uroj që Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës të distancohet nga mendime e deklarime të tilla të çartura. Sepse, siç thotë reaguesi i mësipërm në këtë raport “...ASHAK-u i komenton edhe Serbinë, Kishën Ortodokse, BE-në, Planin e Ahtisarit, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Edi Ramën, Vetëvendosjen, Ali Ahmetin, BIK-un, Turqinë, fundamentalizmin islamik, Gjykatën Speciale e shumë çështje të tjera. Për më tepër, ASHAK-u e akuzon edhe shtetin e Kosovës se “pranoi” njohje të sponsorizuara të shtetësisë në mënyrë korruptive.”^{xlix} Gjuha e përdorur është shumë-shumë e rëndë e problematike për historinë shqiptare. Veçse po të kishte të drejtë e të kishte bërë vërtet analizë për të nxjerrë mangësitë dhe sfidat, do të deklaroja me të madhe që ka të drejtë. Por ky punim është thjesht një raport kundërshqiptar. Vërtet, gjëra nga këto që janë shkruar në këtë raport mund të fliten e përliten në mjedise kafenesh nëpër Kosovë. Por një analizë shkencore nuk është dhe nuk mund të jetë një përmbledhje e fjalëve që thuhën nëpër kafene. Kështu që, akademik Kraja mund të ketë evidencuar fjalë kafenesh, por nuk ka bërë një analizë shkencore. Ai thjesht ka bërë një evidencë tip raporti kundërshqiptar, pa e vrarë mendjen për analizë. Sepse aty nuk ka asnjë arsyetim, asnjë ballafaqim, asnjë dokument, asnjë analizë të mëparshme, asnjë pasqyrë debati për këto çështje, asnjë referim mbi debatet politike e diplomatike, asnjë akt gjyqësor të gjykatave të Kosovës a të gjykatave ndërkombëtare etj.

Ndërkaq, Armand Matoshi, në informacionin e tij, tregon qëndrimin e vetë Akademisë ndaj këtij raporti dhe autorit të tij, duke theksuar: “Me qasjen e tij joakademike dhe veçanërisht me publikimin e këtij dokumenti joshkencor, të hartuar nga vetë ai, si drejtues i një institucioni prestigjioz shkencor, artistik dhe kulturor, sjell përçarje me pasoja të rënda për vetë Akademinë”, thuhet mes të tjerash në komunikatë.”^l Evidencimi i kësaj komunikate ka rëndësi të madhe, sepse hedh hapa për ta pastruar institucionin nga qëndrimet personale qoftë edhe të vetë kryetarit të këtij institucioni, pasi e konsideron se me ato qëndrime dhe vlerësime Akademisë dhe publikut të gjerë i është shkaktuar dëm.

Ndërsa zotëri Memli Krasniqi këtë publikim do ta quajë një pamflet kundërshqiptar, me qëndrimin e të cilit pajtohem plotësisht. Pasi ai vlerëson se “me këtë sulm të ulët nga teksti i dalë prej këtij institucioni, të paguar nga taksapaguesit e Kosovës, konfirmohen e noterizohen tezat serbe, duke sulmuar drejtpërdrejt liderhipin e UÇK-së, si dhe duke ushqyer albanofobinë kundrejt kosovacentrizmit ekstremist, por edhe retorikën neokolonialiste

kundër aleatëve perëndimorë.”^{li} Ashtu sikurse vë në dukje se “...teksti sulmon të gjithë aktorët dhe faktorët e rëndësishëm e mbështetës të Kosovës, duke filluar me akuzat ndaj SHBA-së, BE-së dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë, se kinsë janë bashkëfajtorë për politikën hegjemoniste aktuale serbe, për të vijuar me akuzat ndaj elitës politike të shqiptarëve të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut.”^{lii} Kjo vërehet plotësisht në raportin e publikuar dhe krijon një atmosferë mbytëse për gjithçka që krijon vlerë kombëtare shqiptare. Zotëri Behxhet Pacolli shprehet: “Duke lexuar atë pamflet që ju e publikuat, u habita jashtëzakonisht se si një person që pretendon se e do vendin e vet, përmes një pamfleti politik dhe propagandistik bëhet zëdhënës i denjë i propagandës së Ministrisë së Jashtme të Serbisë.”^{liii} Kjo mendoj se del e pasqyruar mjaft mirë në raportin në fjalë të akademikut Kraja, e ku zotëri Pacolli me qëndrimin e tij shkon edhe më tej kur vë në dukje se “po shihet qartë se ju jeni profesionist në shqiptimin e qëndrimeve të shteteve që sfidojnë dhe luftojnë shtetësinë e Kosovës.”^{liv} Është shumë interesant ky qëndrim, pasi dihet se kemi të bëjmë me qëndrimin e ish-Presidentit të Kosovës, ish-zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Kosovës dhe ish-ministrit të Punëve të Jashtme të Qeverisë së Kosovës. Prandaj mendoj se të vlerësohesh nga një personalitet i tillë, që ka njohje të plota për zhvillimet, me këtë notë negative duhet ulur dhe vënë gishtin kokës, sepse vërtet duket se janë bërë abuzime të rënda me të drejtën e fjalës dhe me funksionin që ushtrohet në emër të Kosovës. Më tej zotëri Pacolli, duke iu drejtuar akademikut Kraja, thotë: “Është për t'u mërzhitur sepse ju flisni pikërisht me narrativën e Beogradit dhe zyrtarëve shtetërorë atje. Njohjet e Kosovës që kanë ardhur bazohen në lobim të mirëfilltë dhe të mirëkoordinuar me partnerët tanë duke paraqitur të vërtetën dhe të drejtën tonë si shtet.”^{lv} Ndaj shihet qartë qëndrimi i atij që merret me thashetheme përballë qëndrimit të zotëri Pacollit, që është marrë me këtë çështje prej 15 vjetësh dhe vijon të jetë i angazhuar për të. Më tutje zotëri Pacolli i tërheq vëmendjen akademikut Kraja duke i thënë: “Nuk kam dëgjuar kryetarin e Akademisë sonë, një institucion që paguhet nga buxheti i Kosovës, të reagojë kur u dëshmuar nga ambasadorët perëndimorë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për diplomacinë e korruptuar të Serbisë, apo kur mediet në mbarë botën shkruanin për diplomacinë e korruptuar të Serbisë, përfshirë raportet e Amnesti International për dërgimin e armëve në Afrikë. Nuk kam dëgjuar që ju u keni shkruar homologëve tuaj për diplomacinë e korruptuar të Serbisë, as nuk keni marrë mundimin të shkruani në mediet ndërkombëtare.”^{lvi} Artikulim më të qartë se çfarë duhet të kishte bërë akademiku Kraja dhe çfarë ka bërë nuk mund të ketë. Kjo është një

pasqyrë ku secili duhet të shikojë portretin e tij. Zotëri Pacolli me shumë të drejtë i tërheq vëmendjen akademikut Kraja edhe për këto çështje. Pa folur për pretendimet dhe këshillimet e mëtejshme.

Më bën përshtypje edhe një vlerësim tjetër nga zotëri Behxhet Shala, i cili, ndër të tjera, shprehet: “Raporti “analitik” i Mehmet Krajës, më i dëmshëm se raporti i Dik Martit! Ky “raport analitik”, sipas një miku tim të mirë është: “fund e krye antievropian”,

antiperëndimor, konspirativ dhe pa asnjë argument shkencor, fjalë rrugësh e pallavra kafesh, pa fije turpi, njolllosje njerëzish dhe moralizim publik.”^{lvii} Dhe, realisht më i dëmshëm se raporti i Dik Martit! Kemi folur më lart për këtë raport dhe përmasat që ka në krahasim me atë të Martit. Prandaj, edhe pajtohem me zotëri Behxhet Shalën kur vlerëson se “... pamfleti politik që është edhe faja tjetër e zezë e raportit të Dik Martit –

varianti kosovar...”^{lviii} Një raport ky gjithëpërfshirës kundërshqiptar që e fuqizon raportin e Dik Martit do të arsyetoja unë dhe, siç duket, është punuar si ushqim për të, për të arsyetuar se jo vetëm aq sa thotë ai ne jemi të ndyrë, por e kemi të ndyrë gjithë historinë tonë dhe jetën tonë, se ne nuk mund të jemi një komb i bashkuar dhe se ne rrezikim e kemi nga vetvetja e jo nga pushtuesit e në veçanti nga Serbia.

Dhe në vijim evidencojmë reagimet e një profesionisti të ligjshmërisë, i cili ka dhënë prova se bën vlerësime ligjrisht të sakta për çdo qëndrim individual a kolektiv, di dhe për veprimet e vendimet e institucioneve. Ky është zotëri Enver Hasani, ish kryetari i Gjykatës Kushtetuese, i cili në reagimin e tij shprehet: “... teksti ka pasaktësi, të cilat prodhojnë një orientim antievropian dhe antiperëndimor të autorit të

tekstit.”^{lix} Në vijim thekson: “Interpretimet në esencë të Mehmetit sa i përket historisë aktuale të Kosovës dhe vendeve përreth karakterizohen me dy gjëra: e para, urretje e shfrenuar ndaj Shqipërisë si shtet, në të gjitha periudhat e zhvillimit të saj; dhe, e dyta, në portretizimin e atyre që janë në Hagë si njerëz të padenjë për politikë dhe potencialisht të inkriminuar në vrasje të njerëzve.”^{lx} Po kështu juristi i mirënjohur Enver Hasani, që ka bërë emër në atë çfarë quhen vlerësime ligjore në Kosovë e më gjerë, do të saktësojë: “Ajo që dikton tempon dhe përmbajtjen e politikës së jashtme të shtetit shqiptar nuk është dallimi veri e jug, por arsyeja shtetërore, që formohet dhe diktohet nga dinamikën ndërkombëtare të secilës kohë, e që Mehmeti nuk i merr vesh. Sikur t'i merrte vesh, do kishte një qasje tjetër ndaj interpretimit të idesë dhe praktikës mbi Ballkanin e hapur, që aktualisht përbën orientimin kryesor të politikës së jashtme të shtetit shqiptar.”^{lxi}

Vetvetiu lind një pyetje: Përse akademiku Kraja duke qenë edhe në detyrën e Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të

Arteve të Kosovës, nuk ndërmoni hapa për të thirrur në konsultë personalitete profesioniste të botës akademike siç është zotëri Hasani, për të bërë atë që është më e mira për Kosovën e gjithë kombin shqiptar të cilëve u detyrohet t'u shërbejë, por përpunoi një raport kundërshtiqiptar në një mënyrë të themi gjysmilege dhe ta deklarojë, duke krijuar ide edhe që mund ta ketë marrë diku të gatshëm dhe vetëm ta ketë firmosur?

Më tej prof. Hasani vlerëson: "Pasi konstatoj se Hashim Thaçi akuzohet për kohën e të ashtuquajturës Qeveri e Përkohshme në Kosovë, që nuk është e saktë sipas aktakuzës kundër tij, Mehmeti nis e përpunon vetë aktakuzën. Për ata që nuk e dinë sikur Mehmeti, ata në Hagë akuzohen për ndërmarrje të përbashkët kriminale, element i qenësishëm i së cilës është vazhdimësia e veprimtarisë kriminale të të akuzuarve. Kjo do të thotë se, cilësimi i Hashim Thaçit si autoritar dhe si lider efektiv i një strukture qeveritare që nuk njihet ndërkombëtarisht, nënkupton konfirmimin e elementit qenësor të veprës penale për të cilën ai dhe të tjerët akuzohen." ^{lxii} Duket, pra, keqdashja e akademikut Kraja ndaj heronjve të Luftës Çlirimtare të Kosovës, siç arsyetonte zotëri Hasani. Duket sikur ai po hakmerret ndaj këtyre heronjve, por ata ndonjë borxh zotëri Krajes nuk i kanë, prandaj lind edhe një pyetje që realisht kërkon një përgjigje: Në emër të kujt po hakmerret zotëri Kraja dhe për interesat e kujt po i bën të gjitha këto akuza? Unë nuk mund të jap përgjigje për këtë konstatim që bën zotëri Hasani, që zotëri Kraja përpunon vetë aktakuzën.

Është e turpshme nëse vërtet do të ndodhë ajo që paralajmëron zotëri Hasani kur thotë: "Eseja e Mehmetit, jam shumë i sigurt, do të merret si provë dhe si një dëshmi e prokurorisë për të vërtetuar natyrën autoritare të të akuzuarit kryesor, si dhe për veprimtarinë e tij kriminale në vazhdimësi." ^{lxiii} Kjo do të ishte një vepër shumë e rrezikshme antikombëtare nëse vërtet edhe prokuroria speciale në Hagë do të binte në nivelin e marrjes në konsideratë edhe të një raporti si ai i Dik Martit, por të përpunuar shumë dobët, në interes të Serbisë prej një shqiptari. Më tej përsëri zotëri Hasani tërheq vëmendjen duke arsyetuar: "E keqja e Mehmetit këtë radhë është se, me përdorim të narracionit konspirativ, ka ndikuar dukshëm në inkriminim të mëtejshëm të atyre që janë në Hagë. Këtë nuk ia ka pasur borxh Kosova Mehmetit, të cilin e ka edukuar, shkolluar dhe mbajtur që nga dita e parë kur ka shkelur në të, por nuk ia kanë pasur borxh as ata në Hagë dhe familjet e tyre." ^{lxiv} Ngelem pa fjalë pas këtij deklarimi të zotëri Hasanit.

Reaguesi i fundit që kam marrë për të sjellë në këtë qëndrim timin ndaj këtij raporti kundërshtiqiptar është zotëri Imer Topanica, i cili vë në evidencë se ky raport i akademikut Kraja "...në veçanti targeton disa entitete, ndoshta më tepër për ta

tërhequr vëmendjen nga problemet e mëdha me të cilat ballafaqohemi si shoqëri. Në këtë vazhde, Turqia dhe myslimanët* janë dy ndër to." ^{lxv} Për të arsyetuar ky zotëri ndalet me shumë saktësi në të gjithë çështjet e këtij raporti, për të cilin trajton me saktësi dhe ashpërsi çdo element që është evidencuar për të sjellë dëme në arenën kombëtare shqiptare. Por unë po sjell vetëm një qëndrim të tij kur thotë me plot arsye: "Po pse Turqia nuk është anëtare e NATO-s? Nuk është aleate e Shteteve të Bashkuara të Amerikës? Patjetër që po, por, siç e thamë, ASHAK-u ka ngelur në vitet e komunizmit, sepse, si është e mundur që një Turqi, duke i pasur synimet e njëjta me armiqët e Perëndimit – Kinën edhe Rusinë, ta njohë Republikën e Kosovës, ta mbështesë atë në kauzën shtetformuese, ta ndihë atë në aspektin politik, ekonomik, ushtarak, shëndetësor, arsimor e kulturor? Mbi 40 marrëveshje të protokolluara janë nënshkruar ndërmjet Turqisë dhe Kosovës. Gatishmëria e saj për ta ndihur Kosovën, kurrë nuk është vënë në dyshim, përveç në raste përjashtuese (sikur ky nga ASHAK-u)." ^{lxvi} Kjo është e vërteta dhe ky akt e bën me turp këtë Akademi nëse nuk distancohet nga ky raport famëkeq kundërshtiqiptar, që e konsideroj vazhdimësi dhe kopje e keqe e Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave të vitit 1986.

17. Përfundime

Pas përfundimit të këtij qëndrimi përballë këtij raporti të dëmshëm kundërshtiqiptar, kam arritur në këto përfundime:

1. Ky raport i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i shkruar nga kryetari i saj, akademik Mehmet Kraja, duket se nuk zbulon asgjë, nuk analizon asgjë, nuk sjell asgjë të re, si dhe prej tij nuk mund të gjendet asnjë përfundim kombëtar, shtetëror e ballkanik, siç pretendohet. Por thjesht janë paraqitur disa çështje, si të ishin paraqitur nga institucionet e Serbisë, me synimin për të trembur shqiptarët që të rrinë larg serbëve, sepse mund të kenë pasojë.

2. Ky shkrim nuk jep asnjë arsytim për të qartësuar përse politikë e Serbisë qenkan bërë agresive në këtë kohë dhe nuk ishin aq agresive kur ajo bëri katër luftëra në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit të 20-të. Nuk tregon cilat janë arsyet që Kosova, Ballkani Perëndimor, rajoni, Europa e bota nuk e shohin dhe nuk e vlerësojnë këtë politikë agresive të Serbisë.

3. Në përgjithësi ky raport bën deklarata, nuk nxjerr përfundime sipas arsytimit apo ankesë nga BE-ja se keqeverisja në Ballkanin Perëndimor po e largon atë nga politikë e saj, kur një pjesë e këtyre shteteve janë pjesë

e BE-së e pjesa tjetër janë kandidatë dhe në rrugetim për në BE. Ashtu edhe me NATO-n janë të njëjtat raporte si me BE-në, kështu që gjithë pasiguritë duket se janë thjesht imagjinatë e paarsyetuar.

4. Do të ishte mirë që sa merren me trembjen e shqiptarëve, Akademitë e Shkencave shqiptare dhe akademikët e nderuar, të mblidhen siç do të duhej të mblidheshin, të diskutonin, të analizonin, të nxirrin përfundime dhe të bënin një program të interesave kombëtare shqiptare, sepse këtë e kanë për detyrë. Nëse do të bënin këtë, do të ishin vërtet akademikë, por siç po veprojnë si deri sot, ata kanë tituj akademikë, marrin edhe paga shumë të larta nga populli i tyre, por nuk bëjnë asgjë për të qenë të tillë e për të shpërblyer pagesën që marrin pikërisht për ta bërë këtë.

5. Raporti është një thirrje për t'u trembur nga Serbia! Dhe këtë nuk e bën vetëm për shqiptarët, nuk e bën vetëm për Kosovën e Shqipërinë, por edhe për Bosnjën, Malin e Zi e shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Duke krijuar kështu idenë se duhet të shpresojmë të mos dojë Serbia, se po iu shkrep në mendje asaj, ne kemi marrë fund. Sepse Serbia paska fuqi të na fundosë ne shqiptarëve, të shkatërrojë Ballkanin Perëndimor dhe të shantazhojë NATO-n dhe BE-në.

6. Marrëdhëniet shqiptaro-serbe vihen në një barabarësi, gjë që i intereson mjaft Serbisë, sepse pikërisht për këtë po punon fort, të krijojë mjegullën e saj të mashtrimit. Kështu ky raport nuk përcakton përgjegjësitë e kësaj barabarësie, por thjesht e deklaron si të vërtetë të padiskutueshme, duke u bërë palë me Serbinë përballë të vërtetave dhe interesave shqiptare.

7. Thirrjen në këtë raport që ne duhet t'i kalojmë armiqësitë e pranoj, por jo siç e kërkon raporti, pa kushte. Pajtimi duhet dhe do të vijë, por pasi të vendoset drejtësia. E, drejtësia nuk është në barabarësi siç e trajton ky raport. Shqiptarët askujt nuk i kanë dhënë armiqësi, gjithnjë kanë luftuar të mbijetojnë dhe të çlirohen nga pushtimet e armiqve dhe mes tyre më agresivë dhe të dëmshëm kanë qenë serbët e Serbia.

8. Gjuha e shpifjeve serbe është mjaft e ashpër, sa shkon deri atje, sa të pretendojë se shqiptarët i kanë shqiptarizuar edhe serbët. Megjithëse, siç vlerësojnë ata, ne në ato treva kemi ardhur nga malet, dhe paskemi ardhur rreth një mijë vjet pas serbëve, megjithatë, i paskemi shqiptarizuar. Por kjo është gjuha serbe, nuk kemi pse t'i ndihmojmë në mënyrat siç edhe evidencohet në këtë raport të Arteve të Kosovës.

9. Nuk duket normale të pretendohet për të bindur opinionin botëror se shqiptarët nuk e zgjedhën vetë fenë islame, por ua diktoi pushtuesi osman. Se islami nuk qenka fe e kohëve moderne, por një trashëgimi e kohëve të errëta të historisë. Shqiptarët paskan mbetur në atë kohë pa udhëheqës shpirtëror nga kisha e krishterë, pasi nuk mund të arsyetohet që feja islame nuk qenka fe e kohëve moderne, ndërsa krishterimi qenka e tillë. Kështu që duket një kundërislamizëm primitiv dëshira për të kërkuar modernitetin e krishterimi dhe të prapambeturën te islami. Për mua feja nuk ndikon për ta bërë njeriun më të zhvilluar ose më të prapambetur. Për të thënë në vijim se kombi ynë në mesjetë historinë nuk e ka pasur të errët, por të ndritur. Ashtu sikurse në gjithë historinë tonë luftërat kundërosmane i kanë bërë më së shumti shqiptarët myslimanë. Besoj se Akademia e Shkencave do ta njohë Abdyl Frashrin, Imer Prizrenin, Sylejman Vokshin, Iljaz pashë Dibrën, Hasan Prishtinën, Isa Boletin, Bajram Currin etj., që nuk besoj se duhet t'i konvertojmë në të krishterë e as t'i fshijmë nga historia pse ishin myslimanë. Ndërsa gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, përballë serbëve të krishterë modernë për çlirimin e Kosovës, kanë rënë në altarin e kombit 26 hoxhallarë duke u bërë dëshmorë të atdheut. Dhe, kjo sepse shqiptarët për të mbijetuar, unitetin e kanë mbështetur te atdheu e kombi dhe jo te feja. Armikun nuk e kemi vlerësuar se i çfarë feje është, por e kemi luftuar si pushtues edhe kur kemi qenë në të njëjtën fe me të. Gjithashtu vlerësoj se deri sot Europa nuk i ka shpallur luftë islamit. Përkundrazi, ajo çdo ditë e më tej po bëhet strehë edhe për të gjithë ata myslimanë që kanë nevojë për të jetuar në Europë. Fakt është që sot Gjermania, Franca, Italia, Spanja, Anglia, Suedia, Norvegjia e mjaft shtete të tjera të Europës kanë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së tyre të përkatësisë islame, që shkon në 10 për qind e më shumë dhe nuk ndihen as të shqetësuara e as të kërcënuara.

10. Pavarësisht nga dëshira që mund të ketë Serbia, kurrë nuk do të mundë të destabilizojë Kosovën. Shqiptarët duhet të jenë të vendosur për të bërë detyrën e tyre ndaj atdheut e jo të tremben se po i ha Serbia. Kush të trembet, le të shkojë të jetojë e të jetë i qetë në Serbi. Është krejt e palogjikshme të shihet armiku si superior, se tremb qytetarët e vendit tënd. Për një mendim dhe deklaram të tillë ligjërisht duhet të mbahen qëndrime të repta.

11. Ky raport e hiperbolizon fuqinë e Serbisë, duke e bërë atë zot të Ballkanit, pa dhënë asnjë argument për këtë. Mendoj se politikë e këtyre shteteve ballkanike nuk janë aq në nivel mediokër sa trajtohen në këtë

raport, pasi ne jemi dëshmitarë të zhvillimeve dhe bëjmë vlerësime të ndodhive. Masat për sigurinë merren në çdo shtet dhe secili prej tyre ka një strategji të sigurisë. Puna duhet përqendruar se si mund të ndihmohet siguria e vendit, jo si të tremben shtetet e Ballkanit me gogolin Serbi. Vlerësoj se mënyra si flitet në këtë raport është shumë zhvlerësuese për politikë e shteteve ballkanike krahasuar me politikën e Serbisë, e cila qenka një politikë që mund të shkatërrojë gjithçka në Ballkan. Prandaj, rekomandoj të mos merret seriozisht, sepse nuk është e vërtetë.

12. Nisma për "Ballkanin e hapur" nuk është dhe nuk mund të jetë nismë e Serbisë, siç e trajton ky shkrim, që, për fat të keq, e trajton Serbinë si zot të Ballkanit. Dihet që Procesi i Berlinit është një nismë e udhëhequr nga Gjermania me mandat për ta lehtësuar bashkëpunimin rajonal ndërmjet gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, si Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë – për t'u mundësuar këtyre vendeve që t'i bashkohen BE-së. Kjo agjendë e lidhshmërisë u fillua si një komponent i rëndësishëm që synonte lidhjen e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në fushat e transportit dhe të energjisë, që më vonë u zgjerua në shkëmbime rinore dhe marrëdhënie ekonomike etj. Kështu, "Ballkani i hapur" dhe Procesi i Berlinit nuk kanë asnjë ndryshim. Po t'u referohesh marrëveshjeve, duket se thjesht bëhet shtrirja në praktikën e terrenit të atij procesi. Prandaj ky proces duhet të merret si zhvillim, kurse të zhvillosh nuk do të thotë të mos bësh kujdes për të avancuar interesat e shtetit tënd. Kjo është normale.

13. Të paraqitesh sot me mendimin se Shqipëria qenka me mendësi komuniste dhe nostalgjike për Serbinë duke anashkalluar Kosovën, do të thotë të jesh armik i tërbuar i shqiptarëve dhe i shqiptarizmit në përgjithësi. Por, për fat të keq, ky raport përpiket të paraqesë dy kategori shqiptarësh, shqiptarë të Republikës së Shqipërisë dhe shqiptarë të Republikës së Kosovës, por që ata shqiptarë të Republikës së Shqipërisë historikisht as kanë dashur të dinë për shqiptarët e Republikës së Kosovës. Kjo tregon një kundërshtiqiptarizëm të egër dhe përçmues i asaj pjesë të shqiptarëve që banojnë në Republikën e Shqipërisë, që raporti shpreh keqardhje për pjesën e shqiptarëve që banojnë në Republikën e Kosovës. Vlerësoj se ky qëndrim është një shërbim i madh që i bëhet Serbisë, se edhe ajo historikisht është përpjekur t'i ndajë në 'Shiftari' dhe 'Allbanci'.

14. Përpjekjet në këtë raport për të krijuar përçarje midis shtetit të Shqipërisë dhe të Kosovës, duke pretenduar se prej vitit 1912, shteti i Shqipërisë paska

sakrifikuat idealizmin e Kosovës, si dhe t'u thuhet shqiptarëve që banojnë në Republikën e Kosovës të kenë kujdes e të ruhen nga shqiptarët që banojnë në Republikën e Shqipërisë se ata e shpërdorojnë idealizmin e tyre dhe përfitojnë për interesat e tyre nga ky idealizëm, apo se në Shqipëri tashmë është ngulitur ideja se Kosova paraqet pengesë të bezdisshme për marrëdhëniet miqësore me Serbinë; ose se çështja e Kosovës për Shqipërinë politike dhe ekonomike kundrohet si sakrificë, të cilën ajo e bën në dobi të një ideje tashmë të vjetruar nacionaliste, siç deklarohet në këtë raport, vlerësoj se është kundërshqiptarizëm i kulluar.

15. Sipas këtij raporti, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, në veçantë kryetari i saj, ka një përbuzje të theksuar për Republikën e Shqipërisë dhe ka dëshirë e nuk përton të shpifë në një mënyrë të tillë që do ta kishin zili edhe akademikët serbë!

16. Ky është një raport kundërshqiptar, më i rëndë se raporti i Dik Matit, i cili merret me një periudhë të caktuar dhe të shkurtër akuzash kundërshqiptare dhe kryesisht kundër Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kurse ky raport i dytë, që, për fat të keq, shkruhet nga një shqiptar në emër të institucionit më të lartë shkencor të Republikës së Kosovës, përpigjet të na e përbaltë gjithë historinë nga kohët e hershme deri në ditët tona. Nuk kishim nevojë për këtë raport alla Dik Marti, që e shumëfishon fuqinë goditëse kundërshqiptare!

17. Në këtë raport, përveç që bëhet thirrje që Republika e Kosovës të bëjë kujdes e të ruhet nga rreziqet e kërcënimit që i vijnë nga Republika e Shqipërisë, shkohet edhe më tej, duke vlerësuar se Republika e Shqipërisë, paska prishur edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe e paska bërë të vajtueshme gjendjen e saj deri edhe kundërshtarë të Republikës së Kosovës prej kur nga ky shtet është larguar Gruevski, që, siç duket, paska qenë i fuqishëm t'i mbrojë shqiptarët në Maqedoni nga Shqipëria. Ndërsa unë që mendoj se e njoh gjendjen edhe në Maqedoninë e Veriut, mund t'u them me siguri të plotë se shqiptarët më të fuqishëm se sot për të qenë me dinjitet dhe të sigurt në trojet e tyre nuk kanë qenë kurrë. Dhe, pavarësisht se nuk pretendohet se janë arritur majat, mund të themi se Shqiptarët në Ballkan, të cilët kanë një histori të pasur e dinamike, ndryshe nga errësira që përhap akademiku Kraja; në këtë kohë që jetojmë, historisë së tyre i kanë vënë kurora lavdie. Lavdi historike konsideroj Luftën Çlirimtare të Kosovës, që krijoi shtetin e Kosovës, duke i bërë të lirë dy milionë shqiptarë dhe duke bërë që Kosova të jetë një

shtet i njohur nga më shumë se gjysma e shteteve të botës. Po ashtu një kurorë lavdie konsiderohet sakrificat e burrave të Kosovës Lindore që bënë Luftën për Çlirimin e Kosovës Lindore dhe nëpërmjet së cilës bënë që bota të kuptojë përfundimisht se ato treva janë treva të banuara prej shqiptarëve historikisht. Kurora tjetër është Lufta Çlirimtare në Maqedoninë e Veriut, e cila i bëri shqiptarët autoritet në atë shtet, që deri dje i vriste vetëm pse protestonin për universitet. Prandaj, duhet të bëjmë vlerësime reale për zhvillimet historike dhe është madhështi t'u themi faleminderit të gjithë atyre që ndërmorën dhe udhëhoqën këto luftëra që i bënë shqiptarët më të autoritetshëm se asnjëherë më parë.

18. Edhe zhvillimet brenda Kosovës, ky shkrim gazetaresk përpigjet t'i pluhurosë. Duket sikur shpresohet akoma se mund të kthehet Kosova në Serbi. Nëse është ky mendim, duhet ta largojë menjëherë kush e ka, se luftëtarët që e mundën Serbinë në vitet 1997–1999 janë gjallë, e edhe kur të mos jenë, populli shqiptar do të ketë fuqi të mbajë veten të lirë.

19. Tërheq vëmendjen deklarimi në këtë raport të një tentative për ndarje të Kosovës. Por në fakt deri sot nuk është parë i dokumentuar ky term, përveç në debatet politike dhe analizat mediatike, ku secili flet si i pëlqen dhe i jep të drejtë vetes. Ndërsa është dëgjuar qysh para çlirimit të Kosovës dhe pas çlirimit për ndryshim të kufijve të Kosovës për të kaluar në atë të ndryshuar nga Beogradi në vitin 1953, kur edhe Kosova Lindore ishte pjesë e Kosovës, dhe mendoj se që nesër do ta bëja këtë ndryshim kufijsh, pa më shkuar fare në mendje se po gaboj kombëtarisht.

20. Ky raport arrin të ketë guximin të krijojë një grup kundër-Kosovë, në të cilin janë Çubriloviqi, Qosiqi dhe Hashim Thaçi. Pasi të korrigjohet raporti, zbulohet se nga shqiptarët nuk është vetëm Hashim Thaçi në grupin kundër-Kosovë, por futen të gjithë ish-liderët e UÇK-së, pra, të gjithë udhëheqësit e Luftës Çlirimtare të Kosovës. Ashtu sikurse në këtë grup armiqësor kundër-Kosovë sipas këtij raporti, ka edhe në Maqedoninë e Veriut dhe fillimisht evidencohet vetëm Ali Ahmeti, por meqenëse siç duket u vlerësua se është pak vetëm emri i tij, u kalua në variantin e dytë, sipas të cilit disa liderë shqiptarë të Maqedonisë së Veriut, që do ta pranonin në qetësi ndarjen e Kosovës.

21. Qëndrimi që i vë vulën gjithë kundërshqiptarizmit të këtij shkrimi gazetaresk është fakti se përpigjet të ligjërojë akuzat ndaj Luftës Çlirimtare të Kosovës, në nivelin që i ngre ato raporti i Dik Martit. Por duhet marrë në konsideratë se të gjitha këto që i ligjëron ky raport si krime të luftës e krime kundër njerëzimit, në

aktakuzën e gjykatës kanë rënë thuasje të gjitha, pasi ishin të montuara e të përpunuara nga prokuroria serbe në Beograd me ndihmën shqiptarë e ndërkombëtarë. Prandaj, vlerësoj se, meqenëse këto akuzat të formuluar nga Dik Marti kanë rënë, siç duket, duhej një dëshmitar i ri, i cili realisht duhet të shkojë në Hagë ta vërtetojë akuzën e tij. E ky është zotëri Mehmet Kraja, i cili ndoshta ka informacione më të thelluara se prokuroria e Serbisë.

Bibliografia

1. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980
2. *Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor*, analizë e ASHAK-ut, përpiluar nga kryetari i asaj akademie, Mehmet Kraja, dhjetor 2022
3. Ligj nr. 8417, date 21.10.1998 – *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* – preambula
4. *Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve* (draft), vjeshtë 1986
5. *Memorandum i Kishës Serbe për Kosovën* – koment i RADIO B-92, dt. 10.08.2003
6. <https://kosovapress.com/%e2%80%8bscholz-te-pershpejtohet-nor-malizimi-i-raporteve-kosove-serbi/> (20.01.2023)
7. <https://www.botasot.info/lajme/1319167/cka-permban-memorandumi-2-i-akademise-se-shken-cave-dhe-arteve-te-serbise-sanu-per-kosoven/>, 25.12.2022
8. Prof. dr. Sabit Syla, Instituti i Historisë – Prishtinë, *Reagim lidhur me analizën politike të Mehmet Krajës 'Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor'*, <https://www.epokaere.com/reagim-lidhur-me-analizen-politike-te-mehmet-krajes-synimet-destabilizuese-te-serbise-ne-kosove-dhe-ne-ballkanin-perendimor/>, 20 janar 2023
9. <https://nacionale.com/politike/analiza-e-krajes-ashak-u-percahet-pritet-deklarate-publike-rreth-akuzave>, nga Mirlind Behluli
10. ASHAK distancohet nga Mehmet Kraja për analizën "shkencore", nga Armand Matoshi, 23 dhjetor 2022
11. <https://telegrafi.com/pdk-publikimi-ashak-ut-eshte-pam-flet-anti-shqiptar/nga-Memli-Krasniqi,21.12.2022>
12. <https://www.radiokosovaelire.com/behxhet-pacolli-reagon-kunder-mehmet-krajes-per-analizen-e-tij-antishqiptare-ne-emer-te-ashak-ut/>, nga Behxhet Pacolli, 23.12.2022
13. <https://www.radiokosovaelire.com/behxhet-sh-shala-raporti-analitik-i-mehmet-krajes-me-i-demshem-sesa-raporti-i-dik-martit/nga-Behxhet-Sh-Shala,23.12.2022>
14. <https://www.gazetaexpress.com/>

[mehmeti-cfare-deshi-cfare-tha-mehmeti/, nga Enver Hasani, 23.12.2022](https://nacionale.com/opinion/e-dhe-nje-skandal-i-radhes-i-ashak-ut-asgje-e-re-ne-horizont,nga-Imer-Topanica,16.01.2023)
15. <https://nacionale.com/opinion/e-dhe-nje-skandal-i-radhes-i-ashak-ut-asgje-e-re-ne-horizont,nga-Imer-Topanica,16.01.2023>

Referencat

- i *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, faqe 31
- ii Aty.
- iii *Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor*, analizë e ASHAK-ut, përpiluar nga kryetari i asaj akademie, Mehmet Kraja, dhjetor 2022, faqe 1
- iv Aty, 1
- v *Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve* (draft), vjeshtë 1986, faqe 12
- vi *Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor*, analizë e ASHAK-ut, përpiluar nga kryetari i asaj akademie, Mehmet Kraja, dhjetor 2022, faqe 1
- vii Aty, faqe 2.
- viii Aty, faqe 3.
- ix Aty, faqe 4.
- x Aty, faqe 7.
- xi Aty.
- xii *Memorandum i Kishës Serbe për Kosovën* – koment i RADIO B-92, dt.10.08.2003
- xiii *Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor*, analizë e ASHAK-ut, përpiluar nga kryetari i asaj akademie Mehmet Kraja, dhjetor 2022, faqe 7
- xiv *Memorandum i Kishës Serbe për Kosovën* – koment i RADIOS B-92, dt.10.08.2003
- xv Aty.
- xvi *Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor*, analizë e ASHAK-ut, përpiluar nga kryetari i asaj akademie, Mehmet Kraja, dhjetor 2022, faqe 7
- xvii Aty, faqe 10.
- xviii Aty, faqe 10-11.
- xix Aty, faqe 11.
- xx Aty, faqe 12.
- xxi Aty, faqe 17.
- xxii Aty, faqe 20-21.
- xxiii <https://kosovapress.com/%e2%80%8bscholz-te-pershpejtohet-nor-malizimi-i-raporteve-kosove-serbi/> (20.01.2023)
- xxiv Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor, analizë e ASHAK, përpiluar nga kryetari i asaj akademie Mehmet Kraja, dhjetor 2022, faqe 21
- xxv Aty, faqe 21.
- xxvi Aty, faqe 21-22.
- xxvii Aty, faqe 22.
- xxviii Aty, faqe 23-24.
- xxix Aty, faqe 24.
- xxx Aty, faqe 24-25.
- xxxi Aty, faqe 23-24.
- xxxii Ligj nr. 8417, datë 21.10.1998 – *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* – preambula
- xxxiii *Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor*, analizë e ASHAK-ut, përpiluar nga kryetari i asaj akademie, Mehmet Kraja, dhjetor 2022, faqe 26

- xxxiv Aty.
xxxv Aty, faqe 30-31.
xxxvi Aty, faqe 31-32.
xxxvii Aty, faqe 31-32.
xxxviii Aty, faqe 33-34.
xxxix <https://www.botasot.info/lajme/1319167/cka-permban-memorandumi-2-i-akademise-se-shken-cave-dhe-arteve-te-serbise-sanu-per-kosoven/>, 25.12.2022
- xl *Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor*, analizë e ASHAK-ut, përpiluar nga kryetari i asaj akademie, Mehmet Kraja, dhjetor 2022, faqe 34
- xli Aty, faqe 34.
- xlii Prof. dr. Sabit Syla, Instituti i Historisë – Prishtinë, *Reagim lidhur me analizën politike të Mehmet Krajës 'Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor'*, <https://www.epokaere.com/reagim-lidhur-me-analizen-politike-te-mehmet-krajes-synimet-destabilizuese-te-serbise-ne-kosove-dhe-ne-ballkanin-perendimor/>, 20 janar 2023
- xliii Aty.
- xliv Aty.
- xlv Aty.
- xlvi Aty.
- xlvii Aty.
- xlviii Aty.
- xlix Aty.
- l ASHAK distancohet nga Mehmet Kraja për analizën "shkencore", nga Armand Matoshi, 23 dhjetor 2022
- li <https://telegrafi.com/pdk-publikimi-ashak-ut-eshte-pam-flet-anti-shqiptar/nga-Memli-Krasniqi,21.12.2022>
- lii Aty.
- liii <https://www.radiokosovaelire.com/behxhet-pacolli-reagon-kunder-mehmet-krajes-per-analizen-e-tij-antishqiptare-ne-emer-te-ashak-ut/>, nga Behxhet Pacolli, 23.12.2022
- liv Aty.
- lv Aty.
- lvi Aty.
- lvii Aty.
- lviii <https://www.radiokosovaelire.com/behxhet-sh-shala-raporti-analitik-i-mehmet-krajes-me-i-demshem-sesa-raporti-i-dik-martit/nga-Behxhet-Sh-Shala,23.12.2022>
- lix <https://www.gazetaexpress.com/mehmeti-cfare-deshi-cfare-tha-mehmeti/,nga-Enver-Hasani,23.12.2022>
- lx Aty.
- lxi Aty.
- lxii Aty.
- lxiii Aty.
- lxiv Aty.
- lxv <https://nacionale.com/opinion/e-dhe-nje-skandal-i-radhes-i-ashak-ut-asgje-e-re-ne-horizont,nga-Imer-Topanica,16.01.2023>
- lxvi Aty.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Prishtina shkarkon Munishin

Klubi më i madh në Kosovë, Prishtina, të hënën e ka shkarkuar Ismet Munishin nga detyra e trajnerit. Ky reagim i kryeqytetasve erdhi vetëm një ditë pas humbjes nga Malisheva. Përkohësisht në krye të kësaj skuadre do të jetë ndihmëstrajneri i Munishit, Debatik Curri

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 MARS - "Jam trajneri më i mirë në Kosovë", kjo ishte deklarata e Ismet Munishit që e ka dhënë ditë më parë, por pa kaluar muaji ai është shkarkuar nga detyra e trajnerit në skuadrën e Prishtinës. Klubi më i madh në vend njoftoi të hënën se bordi vendosi ta ndërpriste bashkëpunimin me Munishin derisa e ka falënderuar

për punën e bërë në këtë klub. "Bordi i FC Prishtinës ka vendosur ta ndërpriste bashkëpunimin me trajnerin Ismet Munishi. Një vendim i tillë ka ardhur për shkak të mosarritjes së rezultateve të dëshiruara në ndeshjet e fundit. FC Prishtina e falënderon përzemësisht Munishin për punën e bërë në skuadër", thuhet në njoftimin e skuadrës kryeqytetase. Po në këtë njoftim skuadra e

Prishtinës ka njoftuar se pozitën e Munishit deri në vendimin e ri do ta ushtrojë trajneri Debatik Curri dhe ndihmësit e tjerë. Vendimtare në shkarkimin e Munishit ka qenë humbja që pësoi Prishtina të dielën nga Malisheva. Ky klub ka filluar menjëherë kërkimin e një trajneri të ri, derisa janë në opSION disa emra. Një nga ta është ish-përzgjedhësi i Kosovës, Edmond Rugova, por në listën e kryeqytetasve janë edhe ish-



trajneri i Prishtinës, Ramiz Krasniqi, Ardian Nuhiu që më herët e ka drejtuar Dritën e Gjilanit. Prishtina aktualisht renditet në vendin e katërt me 32

pikë të grumbulluara. Nga 25 ndeshjet e zhvilluara, "bardhekaltër"-it kanë regjistruar tetë fitore, tetë barazime dhe nëntë humbje.

Sonte dy ndeshje të zjarrta në Ligën e Kampionëve



MANCHESTER, 13 MARS (ER) - Kampioni në fuqi i Premierligës, Manchester City, kërkon ta sigurojë kualifikimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve pas ndeshjes që e zhvillon sonte (e martë) ndaj RB Leipzigit. Në ndeshjen e parë klubi gjerman arriti të barazojë ndaj Cityt në "Red Bull Arena" me rezultat 1-1. Pavarësisht prej rezultatit në ndeshjen e parë, në këtë ndeshje favorite është

skuadra e Manchester Cityt, pasi ka potencial të jashtëzakonshëm dhe luan para shikuesve të vet. Lajm i mirë për Pep Guardiolen është se i ka të gjithë futbollistët e gatshëm për këtë ndeshje, kurse Leipzig pritet të jetë pa Nkunkun, Schlagerin, Gulacsin dhe Diallon. Edhe ndeshja tjetër në mes të Portos dhe Interit pritet të jetë shumë interesante, pasi rezultati i


ndeshjes së parë 1-0 në favor të italianëve lë mundësinë e hapur për kualifikim për të dyja skuadrat. Deri tash në çerekfinale janë kualifikuar Bayern Munchen, Milan, Chelsea dhe Benfica.

TË MËRKURËN TAKOHEN:
21:00 Manchester City - RB Leipzig
21:00 Porto - Inter

KF Llapi: Dëmi kalon vlerën e 10 mijë eurove, presim ndihmën e FFK-së

"Epoka e re"

PODUJEVË, 13 MARS - KF Llapi ka reaguar një ditë pas incidentit të shkaktuar pas ndeshjes kundër Ballkanit nga tifozët mysafirë. Kryesia e klubit llapjan, pas një analize të thellë, e ka quajtur të papranueshëm veprimin e tifozëve të Ballkanit. KF Llapi dhe FC Ballkani treguan futboll të mirë, cilësor dhe rivalizues. Ndeshja e djeshme ishte hijeshia e këtij sezoni sa i përket ndeshjes, kurse sa i përket tifozëve të skuadrave gjatë ndeshjes nuk kishte asnjë përleshje fizike mes tifozëve sepse nuk kishin mundësi të



përballeshin pasi që tifozët tanë ishin vendosur në veri, kurse tifozët mysafirë në jug. "Pas përfundimit të ndeshjes, tifozët mysafirë, të revoltuar nga humbja e ekipit të tyre, filluan t'i



dëmtojnë ulëset e tribunës në të cilat ishin të vendosur. Kjo gjë është e papranueshme në sport dhe duhet të dënohet rreptë pa marrë parasysh kushdo që të jetë. Ne kemi raporte të

shkëlqyeshme mes dy kryesive dhe jemi rivalë në fushë, por miq dhe shokë jashtë fushës. Ne edhe pse jemi dëmtuar rëndë si klub, gjithmonë do ta respektojmë kryesinë e FC Ballkanit dhe vëllezërit Kabashi pasi që ata nuk kanë të bëjnë me këto gjëra, por disa tifozë të pandërgjegjshëm shkaktuan këtë dëm të madh dhe të panevojshëm", thuhet në reagimin e Llapi. Skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina pret që personat që u identifikuan në incident ta marrin dënimin e merituar. Skuadra e Llapi ka njoftuar se dëmi i shkaktuar është mbi 10 mijë euro dhe pret që të

ndihmohet nga Federata e Futbollit për intervenimin e sajimit të këtij dëmi. "E dini të gjithë se çfarë sakrifice kemi bërë dhe vazhdojmë të bëjmë në vëllezërit Batatina për ta ngritur infrastrukturën në këtë nivel dhe të dëmtohet pa asnjë nevojë, kjo gjë është e papranueshme si dhe e dënueshme. Dëmi i shkaktuar, sipas ekspertëve të dëmit, kalon vlerën e 10 mijë euro. Shpresojmë që FFK-ja të na mbështesë dhe ne të intervenojmë menjëherë për rregullimin e ulëseve sepse për ne si klub është e pamundshme ta shohim ashtu arenën "Zahir Pajaziti", thuhet në reagimin e skuadrës llapjane.

Rama i dhuron Krasniqit 'Hyjneshën në Fron'

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim boksierin Robin Krasniqin, me ç'rast i ka dhuruar "Hyjneshën në Fron". Kryetari i kryeqytetit ka thënë se

një kampion i vërtetë nuk përcaktohet vetëm nga fitoret, por nga përkushtimi, këmbëngulja, karakteri dhe shpirti i tij. "Një kampion i vërtetë nuk përcaktohet vetëm nga fitoret, por nga

përkushtimi, këmbëngulja, karakteri dhe shpirti i tij. Robin Krasniqi, ju mishëroni të gjitha këto cilësi dhe jo vetëm. Faleminderit që e keni vënë vendin tonë në hartat botërore dhe që na bëni gjithmonë

krenar me arritjet tuaja. Në shenjë mirënjohjeje e admirimi, të dhurojmë Hyjneshën në Fron – simbol i vërtetë i qëndrueshmërisë dhe forcës, ashtu sikur jeni edhe ju!", ka shkruar Rama në "Facebook".



Gojani ndahet me Vëllaznimit

Gjakovë, 13 mars - Trajneri Arsim Gojani dhe pjesa e tjetër e shtabit teknik në skuadrën e Vëllaznimit kanë dhënë dorëheqje. Lajmin e ka konfirmuar vetë skuadra kuqezi. "Pas

rezultateve negative të katër xhirove të para, kryetrajneri Arsim Gojani dhe shtabi teknik kanë ofruar dorëheqje të përvokueshme. Pas ndeshjes së sotme është

mbajtur mbledhja e bordit drejtues të klubit, ku është miratuar dorëheqja e shtabit teknik. Falënderojmë kryetrajnerin Gojani dhe shtabin teknik për kontributin e dhënë

dhe angazhimin tyre të palodhshëm gjatë këtyre tre muajve", thuhet në njoftimin e klubit gjakovar. Skuadra e Vëllaznimit renditet në vendin e fundit në Ligën e Parë, Grupi A.



Marko Jovanovski, 'Ylli i javës' në Superligë

Ferizaj, 13 mars - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 25-të në Albi Mall Superligë i ka takuar portierit të FC Ferizaj, Marko Jovanovski, i cili pati paraqitje të shkëlqyeshme në ndeshjen kundër Trepçës '89. Ai me disa pritje fantastike ia mohoi golin skuadrës mitrovicase, duke qenë më i merituari që Ferizaj arriti t'i arkëtojë pikët e plota në "Riza Lushta" ndaj njërit prej rivalëve në luftën për mbijetesë në elitë. "Normalisht qëllimi ynë është të qëndrojmë në Albi Mall Superligë. Edhe rezultatet në këtë stinor tregojnë se sa e mirë është atmosfera në klub. Më së vështiri është ta kthesh besimin te njerëzit, por ne këtë e kemi bërë falë paraqitjeve të mira në këtë



stinor. Ne besojmë në arritjen e objektivit tonë dhe me lojërën e mira kemi bërë që të na besojnë e përkrahin të gjithë. Ky çmim është një shpërblim për angazhimin që po e bëj jo vetëm unë, por e tërë skuadra, prandaj këtë çmim ua dedikoj të gjithë

bashkëlojtarëve. Uroj që secili lojtar i FC Ferizaj ta marrë këtë çmim nga një herë dhe ajo çfarë është më e rëndësishmja, në fund të kampionatit t'i gëzohemi të gjithë arritjes së objektivit - qëndrimit në Superligë", ka thënë Marko Jovanovski.

Denveri regjistron humbjen e tretë radhazi, lakersat ngecin dhe rrezikojnë 'play off'-in

DENVER, 13 MARS - Humbja e tretë radhazi për Denverin në kampionat, që nuk rrezikon kreun e renditjes në Perëndim. Nuggetsit u mund me rezultat 122-120 nga Brooklyn, sfidë ku shtatë lojtarë të ekipit mik realizuan mbi 10 pikë, përfshirë titullarët. Për Denverin, Jokiqi realizoi një "triple double", me 35 pikë, 20 rebounde dhe 11 asistime, por që mbetën për statistikë. Pas tri fitoresh ndalet ekipi i lakersave, që u mund me rezultat 112-108 në fushën e tij nga New York. Randle me 33 pikë e Barrett me 30 pikë bënë dallimin në fushë për njujorkezët, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Russellit për vendësit. Ekipi i Oklahomës, falë 21 pikëve e 10 asistime të Jalen Williamsit, mundi



me rezultat 102-90 San Antonion. Philadelphia kërkon kreun në Lindje pas fitores së pestë radhazi, këtë herë ndaj Washingtonit me shifrat 112-93. Për Philadelphian u dallua Embiid me 34 pikë. Fitoi

edhe Clevelandit, që mundi me rezultat 114-108 Charlotten, ndeshje ku u dallua Garlandi me 28 pikë. Ndërsa New Orleans, falë 41 pikëve të Trey Murphys, mundi me rezultat 127-110 Portlandin.

REZULTATET

Denver - Brooklyn	120-122
Charlotte - Cleveland	108-114
Philadelphia - Washington	112-93
New Orleans - Portland	127-110
San Antonio - Oklahoma	90-102
Lakers - New York	108-112

Vieri: Do të dilja golashënues me këtë ekip që ka Interi

Ish-sulmuesi i Interit, Christian Vieri, ka analizuar Interin e këtij sezoni. Sulmuesi italian ka thënë sikur të ishte pjesë e këtij ekipi

të Interit, atëherë do të dilte gjithnjë si golashënuesi më i mirë në Serinë A. "Interi krijon mbi 10 raste shënimi për ndeshje kur luan në shtëpi. I

ka Dumfries dhe Dimarco që shërbejnë mirë nga krahët, Barellan që është një organizator në qendër të mesfushës. Ka dhe një

sulmues si Lukaku që pozicionohet në sulm dhe shërbehet mirë nga bashkëlojtarët, por nuk ka dhënë shumë rezultat. Nëse

unë do të luaja në këtë ekip që Interi ka tani, do të dilja golashënuesi më i mirë në çdo sezon të Serisë A", ka thënë Vieri.

SHKURT

Tifozët e Interit kërkojnë rikthimin e Contes

Pozita e Simone Inzaghit si trajner i Interit është e lidhur shumë me ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Portos. Tifozët nuk janë të kënaqur me trajnerin aktual dhe kanë kërkuar rikthimin e Antonio Contes, i cili pritet të largohet në fund të edicionit nga Tottenham Hotspuri. Interi e ka fituar ndeshjen e parë ndaj Portos, ndërsa në Serinë A ka humbur garën për titull.

Mulleri nuk ftohet për dy ndeshjet e radhës

Anëtari i Bayern Munchenit, Thomas Muller, nuk do të jetë pjesë e listës së Gjermanisë për dy ndeshjet e radhës. Këta e ka konfirmuar trajneri Hansi Flick. Mungesa e 33-vjeçarit vjen për shkak se Flick dëshiron t'u japë hapësirë lojtarëve të rinj. "Kjo është diskutuar me të. Unë dua t'u jap një shans lojtarëve më të rinj me ekipin kombëtar, por kjo nuk do të thotë se ai nuk është në planet e mia për Kampionatin Evropian 2024. Pse duhet t'ia mbyll derën një lojtari të tillë përgjithmonë? Shikoni rëndësinë e tij aktuale për Bayernin. Ai është me të vërtetë i rëndësishëm dhe unë jam shumë i lumtur për të", ka thënë Flick. Gjermania ndeshjen e parë për këtë vit e zhvillon më 25 mars në miqësoren ndaj Perusë, ndërsa tri ditë më vonë takohet me Belgjikën.

Ancelotti: Jemi favoritë ndaj Liverpoolit, por duhet të kemi kujdes

Real Madridi ka shënuar fitore në ndeshjen e parë kundër Liverpoolit (5-2) në "Anfield". Trajneri Carlo Ancelotti ka thënë se skuadra e tij është favorite për t'u kualifikuar në çerekfinale, por duhet të ketë kujdes në ndeshjen kthyesë që zhvillohet të mërkurën në Madrid. "E kemi një përvojë nga sezoni i kaluar kundër Chelseat. Nuk mund ta fshehim se jemi favoritë për të shkuar më tej, por nuk duhet të harrojmë se janë edhe 90 minuta për t'u luajtur dhe duhet t'i luajmë me të njëjtën frymë si në 'Anfield'. Avantazhi që kemi nuk duhet të na bëjë të flemë mbi dafina. Kjo ndeshje mund të paraqesë plot kurthe, ndaj duhet të bëjmë shumë kujdes", ka thënë Ancelotti.

Katër yjet që synon PSG-ja në verë

Paris Saint-Germain është goditur kur është eliminuar nga Liga e Kampionëve. Mediet franceze kanë raportuar se PSG-ja dëshiron të marrë Erling Haalandin, në përpjekjen për të krijuar një partneritet të frikshëm sulmues me Mbappen. PSG-ja do të ishte e interesuar të aktivizonte klauzolën e norvegjezit, e cila vlerësohet në 200 milionë euro dhe mund ta kompensojë duke larguar Neymarin dhe Messin. Në "radarin" e klubit kampion të Francës janë edhe Bernardo Silva, Victor Osimhen dhe Goncalo Ramos.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina



DREJTORIA E ARSIMIT
03-111/01-53806/23
Datë: 14.03.2023

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës:

RISHPALLË KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:

- Drejtor/e në SHML "Hoxhë Kadri Prishtina", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në SHML "Gjimnazi i Specializuar Matematikor", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në SHML "7 Shtatori", Komuna e Prishtinës;
- Zëvendës drejtor në SHML "Hoxhë Kadri Prishtina", Komuna e Prishtinës;

Institucioni: Komuna e Prishtinës
Drejtorja: Drejtoria për Arsim
Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtoria e Arsimit
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vite;

Qëllimi i vendit të punës: Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

1. Informata të përgjithshme

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 14.03.2023 deri më datën 28.03.2023;
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikojë një e më shumë shkolla. Në rastet e tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

*Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

2. Kushtet

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
 - Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 - Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
 - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 - Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve¹;

¹ Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, të dorëzohet dëshmi nga MASHTI përkatëse.

- Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
 - Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
 - Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera, dhe
 - Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor/eshë.
- Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurren.²

3. Dokumentet e kërkuara

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
 - Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët³;
- Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor⁴;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike⁵;
- Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës⁶;

² Shihni UA 05/2015 Normativ për Mësim dhe Arsimin e Profesionit.

³ Përpos dokumenteve të cekura në pikën 3.5, D.K.A. Prishtinë do të kërkojë nga inspektoratit për Arsim nëse kandidatët që kanë konkuruar kanë raste të mbyllura apo të hapura kundër tyre.

⁴ Shihni Formularin B/L për kryerjen e përkrahjes së dokumenteve, si dhe Formularin H - Udhëzimin e përgatitjes e portfolios profesionale.

⁵ Shihni Formularin I - M odel i Deklaratës në Betim.

⁶ Shihni Formularin H - Udhëzimin e përgatitjes e portfolios profesionale, porpo ashtu Formularin B/L rreth kryerjes së përkrahjes së dokumenteve.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorë

Drejtori ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë për zëvendës drejtorë

Zëvendës drejtori i IEAAP ka përgjegjësi të mbështetjes dhe ndihmësive punën e drejtorit për të siguruar administrimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor, si vijon:

- Përkujdeset dhe përcjell mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ndihmon në krijimin e klimës pozitive në institucionin shkollor;
- Monitoron dhe mentoron mësimdhënësit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Përpunon statistikat e suksesit të nxënësve dhe të dhënat tjera në periudha të caktuara;
- Përgatit raport periodik për mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor;
- Kontrollon ditaret e klasës së paku njëherë në një periudhë mësimore dhe udhëzon mësimdhënësit për mbajtjen e shënimeve në mënyrën e duhur;

- 5.6. Ndhmon dhe përkrah mekanizmat e institucionit shkollor për menaxhimin e cilësisë së performancës së institucionit;
- 5.7. Zëvendëson mësimdhënësit në rastet kur mungojnë;
- 5.8. Pranon, kontrollon dhe sistemon përgatitjen e planeve mësimore të mësimdhënësve;
- 5.9. Zëvendëson dhe përfaqëson drejtorin/eshën e institucionit shkollor sipas nevojës;
- 5.10. Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/ esha i/e institucionit shkollor, në pajtim me ligjin.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

6. Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatëse

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, në linkun e mëposhtëm gjeni Planet zhvillimor të IEAA-ve të Komunës të Prishtinës, si vijon: <https://prishtinaonline.com/drejtorite/arsimit/planet-zhvillimore-ieea>

Për çdo problematikë teknike në sigurimin e Planit Zhvillimor të IEAA-së përkatëse, mund të drejtoheni në Drejtorinë Komunale të Arsimit.

7. Vegëzat elektronike

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojmë të gjithë kandidatët që t'i lexojnë me kujdes të gjitha shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhës nga Komisioni i emëruar.

Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020 për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe-pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe-aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/>

Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020 - dukë përfshirë Forumularet të cilat janë kyçe për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendësdrejtor të IEAAP në bazë të dëshmimeve të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokoll i Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku: <https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-drejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iea/>

Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH) 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional/>

Shtojca 4 - Udhëzues për kandidatët për fazën e intervistës

Qëllimi i këtij dokumenti është që të i jap disa informata kandidatëve rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të presin kandidatët gjatë ditës së intervistave.

Linku:

https://prishtinaonline.com/uploads/udhezues_per_kandidatet_per_fazen_e_intervistes_per_kandidatet_ne_pozita_udheheqese_te_institucioneve_edukativo-arsimore_docx.pdf

Shtojca 5 - Dokument informues për vëzhguesit e Komisioneve përzgjedhëse

Për hir të transparencës maksimale për kandidatët, vëzhguesit si dhe qytetarët e interesuar, më poshtë gjeni shtojcën bazë e cila do të përdoret nga Komisioni gjatë punës së tyre, dhe që është në përputhje me UA151/2020.

Linku:

https://prishtinaonline.com/uploads/1dokumenti_informues_per_vezhguesit_e_komisioneve.pdf



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E ARSIMIT
03-111/01-53807/23
Datë: 14.03.2023

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës, shpallë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:

1. Drejtor/e në SHML “Prek Jakova”, Komuna e Prishtinës;
2. Drejtor/e në SHML “28 Nëntori”, Komuna e Prishtinës;
3. Drejtor/e në SHML “Gjin Gazulli”, Komuna e Prishtinës;
4. Drejtor/e në SHML “Dr. Ali Sokoli” “,Komuna e Prishtinës;
5. Drejtor/e në SHML “Eqrem Çabej” Komuna e Prishtinës;
6. Drejtor/e në SHML “Medreseja Alauddin”, Komuna e Prishtinës;
7. Zëvendësdrejtor në SHML “Ahmet Gashi”, Komuna e Prishtinës;

Institucioni: Komuna e Prishtinës
Drejtoria: Drejtoria për Arsim
Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtoria e Arsimit
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vite;

Qëllimi i vendit të punës: Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

1. Informata të përgjithshme

- 1.1. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 14.03.2023 deri më datën 28.03.2023;
- 1.2. Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
- 1.3. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- 1.4. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- 1.5. Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
- 1.6. Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuar në MASHTI;
- 1.7. Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- 1.8. Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikojë në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- 1.9. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
- 1.10. Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

*Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

2. Kushtet

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- 2.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 2.2. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
 - 2.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 - 2.2.2. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
 - 2.2.3. Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 - 2.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- 2.3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve¹;

¹ Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, i, të dorëzojë dëshmi nga MASHT përkatëse.

- 2.4. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimet të KSHLM;
- 2.5. Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
 - 2.5.1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
 - 2.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera, dhe
 - 2.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor/eshë.
- 2.6. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.²

3. Dokumentet e kërkuara

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:

- 3.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- 3.2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
 - 3.2.1. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
- 3.3. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
- 3.4. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- 3.5. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët³;
- 3.6. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor⁴;
- 3.7. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike⁵;
- 3.8. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës⁶;

² Shihni UA 05/2015 Normativi për Mësimin dhe Menaxhimin në Arsimin e Profesionit.

³ Përpos dokumenteve të caktuara në pikën 3.5, D.K.A. Prishtinë do të kërkojë nga Inspektorati për Arsimin nëse kandidatët që kanë konkurruar kanë raste të mbajtura apo të hapura kundër tyre.

⁴ Shihni Formularin B/1 për kryerjen e përkrahjes së punës në arsimin e mesëm të lartë dhe Formularin H - Udhëzimin e përgatitjes së portfolios profesionale.

⁵ Shihni Formularin I - M odeli i Deklaratës në Betim .

⁶ Shihni Formularin H - Udhëzimin e përgatitjes së portfolios profesionale, porpo ashtu Formularin B/1 rreth kryerjes së përkrahjes së punës në arsimin e mesëm të lartë.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorë

Drejtori ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- 4.1. Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- 4.2. Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- 4.3. Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- 4.4. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- 4.5. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmeve tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- 4.6. Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- 4.7. Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- 4.8. Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- 4.9. Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
- 4.10. Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë për zëvendësdrejtorë

Zëvendësdrejtori i IEAAP ka përgjegjësi të mbështetës dhe ndihmojë punën e drejtorit për të siguruar administrimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor, si vijon:

- 5.1. Përkujdeset dhe përcjell mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ndihmon në krijimin e klimës pozitive në institucionin shkollor;
- 5.2. Monitoron dhe mentoron mësimdhënësit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- 5.3. Përpunon statistikat e suksesit të nxënësve dhe të dhënat tjera në periudha të caktuara;
- 5.4. Përgatitë raport periodik për mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor;
- 5.5. Kontrollon ditarët e klasës së paku njëherë në një periudhë mësimore dhe udhëzon mësimdhënësit për mbajtjen e shënimeve në mënyrën e duhur;
- 5.6. Ndihmon dhe përkrah mekanizmat e institucionit shkollor për menaxhimin e cilësisë së performancës së institucionit;

- 5.3. Përpunon statistikat e suksesit të nxënësve dhe të dhënat tjera në periudha të caktuara;
- 5.4. Përgatitë raport periodik për mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor;
- 5.5. Kontrollon ditarët e klasës së paku njëherë në një periudhë mësimore dhe udhëzon mësimdhënësit për mbajtjen e shënimeve në mënyrën e duhur;
- 5.6. Ndihmon dhe përkrah mekanizmat e institucionit shkollor për menaxhimin e cilësisë së performancës së institucionit;
- 5.7. Zëvendëson mësimdhënësit në rastet kur mungojnë;
- 5.8. Pranon, kontrollon dhe sistemon përgatitjen e planeve mësimore të mësimdhënësve;
- 5.9. Zëvendëson dhe përfaqëson drejtorin/eshën e institucionit shkollor sipas nevojës;
- 5.10. Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/ esha i/e institucionit shkollor, në pajtim me ligjin.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

6. Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatëse

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portfolios profesionale, në linkun e mëposhtëm gjeni Planin zhvillimor të IEAA-ve të Komunës të Prishtinës, si vijon: <https://prishtinaonline.com/drejtorite/arsimit/planet-zhvillimore-ieea>

Për çdo problematikë teknike në sigurimin e Planit Zhvillimor të IEAA-së përkatëse, mund të drejtoheni në Drejtorinë Komonale të Arsimit.

7. Vegëzat elektronike

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojmë te gjithë kandidatet që t'i lexojnë me kujdes të gjitha Shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhës nga Komisioni i emëruar.

Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020 për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe-pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe-aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/>

Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020 - duke përfshirë Formularët të cilat janë kyçe për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendësdrejtor të IEAAP në bazë të dëshmimeve të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokoll i Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku: <https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formulet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-drejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iaa/>

Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH) 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional/>

Shtojca 4 - Udhëzues për kandidatët për fazën e intervistës

Qëllimi i këtij dokumenti është që të i jap disa informata kandidatëve rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të presin kandidatët gjatë ditës së intervistave.

Linku:

https://prishtinaonline.com/uploads/udhezues_per_kandidatet_per_fazen_e_intervistes_per_kandidatet_ne_pozita_udheheqese_te_institucioneve_edukativo-arsimore.docx.pdf

Shtojca 5 - Dokument informues për vëzhguesit e Komisioneve përzgjedhëse

Për hir të transparencës maksimale për kandidatët, vëzhguesit si dhe qytetarët e interesuar, më poshtë gjeni shtojcën bazë e cila do të përdoret nga Komisioni gjatë punës së tyre, dhe që është në përputhje me UA151/2020.

Linku:

https://prishtinaonline.com/uploads/1dokumenti_informues_per_vezhguesit_e_komisioneve.pdf



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E ARSIMIT
03-111/01-53810/23
Datë: 14.03.2023

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës, shpallë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:

- Drejtor/e në IP "Dielli", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në IP "Yllkat", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në IP "Xixëllonjat", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në IP "Buzëqeshja", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në IP "Ardhmëria", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në IP "Gëzimi Ynë", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në IP "Fatosat", Komuna e Prishtinës;
- Drejtor/e në IP "Lulevera", Komuna e Prishtinës.

Institucioni: Komuna e Prishtinës
Drejtorja: Drejtoria për Arsim
Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtorja e Arsimit
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vite;

Qëllimi i vendit të punës: Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

1. Informata të përgjithshme

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 14.03.2023 deri më datën 28.03.2023;
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikoj në një e më shumë shkolla. Në rastet e tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

*Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

2. Kushtet

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
 - Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 - Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
 - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 - Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve¹;

- Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
 - Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
 - Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera, dhe
 - Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor/eshës.
- Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.²

3. Dokumentet e kërkuara

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
 - Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënua për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët³;
- Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor⁴;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike⁵;
- Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës⁶;

² Shihni UA 05/2015 Normativ për Mësim dhe Nivesite Arsimi të Profesional

³ Përpas dokumenteve të cekua në pikën 3.5, DKA Prishtinë do të kërkojë nga Inspektoriati për Arsim nëse kandidatët që kanë konkuruar kanë raste të mbyllura apo të hapura akudër tyre.

⁴ Shihni Formularin B/1 për kryerjen e përkrahjes së dokumenteve, si dhe Formularin H - Udhëzimin e përgatitjes e portfolios profesionale.

⁵ Shihni Formularin I - M odeli i Deklaratës në Betim .

⁶ Shihni Formularin H - Udhëzimin e përgatitjes e portfolios profesionale, porpo ashtu Formularin B/1 rreth kryerjes së përkrahjes së dokumenteve.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorë

Drejtori ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

¹ Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, të dorëzohet dëshmi nga MASHT përkatëse.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

5. Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatëse

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, në linkun e mëposhtëm gjeni Planin zhvillimor të IEAA-ve të Komunës të Prishtinës, si vijon: <https://prishtinaonline.com/drejtorite/arsimit/planet-zhvillimore-ieea>

Për çdo problematikë teknike në sigurimin e Planit Zhvillimor të IEAA-së përkatëse, mund të drejtoheni në Drejtorinë Komunale të Arsimit.

6. Vegëzat elektronike

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojmë të gjithë kandidatet që t'i lexojnë me kujdes të gjitha Shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhës nga Komisioni i emëruar.

Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020 për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe-pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe-aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/>

Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020 - dukë përfshirë Forumularët të cilat janë kyçe për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatën për drejtor/zëvendës drejtor të IEAAP në bazë të dëshmimeve të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokollin e Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku: <https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-drejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iea/>

Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH) 05/2015 Normativi për Mësimdhenesit e Arsimit Profesional

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional/>

Shtojca 4 - Udhëzues për kandidatët për fazën e intervistës

Qëllimi i këtij dokumenti është që të i jap disa informata kandidatëve rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të presin kandidatët gjatë ditës së intervistave.

Linku:

https://prishtinaonline.com/uploads/udhezues_per_kandidatet_per_fazen_e_intervistes_per_kandidatet_ne_pozita_udheheqese_te_institucioneve_edukativo-arsimore_docx.pdf

Shtojca 5 - Dokument informues për vëzhguesit e Komisioneve përzgjedhëse

Për hir të transparencës maksimale për kandidatët, vëzhguesit si dhe qytetarët e interesuar, më poshtë gjeni shtojcën bazë e cila do të përdoret nga Komisioni gjatë punës së tyre, dhe që është në përputhje me UA151/2020.

Linku:

https://prishtinaonline.com/uploads/1dokumenti_informues_per_vezhguesit_e_komisioneve.pdf

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaiik 33.98 MWp (25 ha) në Prilep komuna e Deçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.05.2023 në ora 10:30 në hapësirat Shkollës Filllore “Sylejman Vokshi” kilometri i 5 – të, rruga Deçan – Gjakovë, Fshati Prilep, Komuna Deçan do të organizohet debat publik nga Kompania “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/71925674037?pwd=QvZPneyDVy3xzGjumBb4MYScT3LtsX.1>

Meeting ID: 719 2567 4037

Passcode: 1tn90Q

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan për impiantin fotovoltaiik 33.98 MWp (25 ha) në Prilep komuna e Deçanit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaiik 15.44 MWp (15 ha) në Rastavicë komuna e Deçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.05.2023 në ora 10:00 në hapësirat Shkollës Filllore “Sylejman Vokshi” kilometri i 5 – të, rruga Deçan – Gjakovë, Fshati Prilep, Komuna Deçan do të organizohet debat publik nga Kompania “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/71925674037?pwd=QvZPneyDVy3xzGjumBb4MYScT3LtsX.1>

Meeting ID: 719 2567 4037

Passcode: 1tn90Q

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “Lokaj Solar” Sh.p.k Prilep, Deçan për impiantin fotovoltaiik 15.44 MWp (15 ha) në Rastavicë komuna e Deçanit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi.

I. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Njesisë Operative.

Përgaditja profesionale: Baçelor.

Përvoja e punës: Së paku 3 vjet në Menaxhim.

Numri i kryesve: 1.

Kushtet të veçanta:

- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe bashkëpunimi me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Njohja e punës me kompjuter në MS Office.

Paga Bazë: 702.66 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Orari: I plotë.

Vendi i punës: Mitrovicë (Regjional).

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Kryen dhe organizon punët mbrenda njesisë,
- Është përgjegjës për konsumatorët, furnizimin me ujë dhe shërbime të UZ,
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive,
- Drejton dhe përgatit të dhënat komerciale të kompanisë për planin e biznesit,
- Analizon klimën e treguesve dhe tendencat e biznesit në aspektin komercial për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen,
- Monitoron procesin e faturimit dhe shitjeve, nivelin e performancës në njësi, dhe llogaritë e arkëtueshme,
- Është përgjegjës në mirëmbajtjen dhe rregullimin e rrjetit të ujësllësit dhe kanalizimit,
- Bënë planifikimin kohë pas kohe të materialit të nevojshëm për kyqje në objekte të reja,
- Planifikon kujdestarin në festa dhe në ditët e pushimit,
- Kujdeset për intervenimin e kohë pas kohe të shërbimit të mirëmbajtjes në menjanimin e prishjeve në rrjetin e ujësllësit dhe kanalizimit,
- Merr pjesë në formimin e ofertave dhe përcaktimin e punëve në punimin e tyre,
- Bënë projektet në rekonstrukcionin e rrjetit të ujit dhe kanalizimit,
- Bënë planifikimin dhe rradhitjen e fuqisë punëtore brenda sektorit për mirëmbajtjen dhe punë të tjera në bashkëpunim me udhëheqësin e departamentit,
- Bënë lëshuarjen e urdhërave dhe kontrollon punën jashtë orarit të punës mbrenda sektorit me marrëveshje me udhëheqësit e departamenteve,
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesave të Drejtorëve përgjegjës,
- Për punën që kryen i përgjigjet Drejtorëve Regjional.

II. Emërtimi i vendit të punës: Shef i Cilësisë së Ujit dhe Burimeve.

Përgaditja profesionale: Baçelor në (Kimi, Mikrobiologji, Teknologji).

Përvoja e punës: Së paku 3 vjet.

Numri i kryesve: 1.

Kushtet të veçanta:

- Të zotëroj aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese,
- Aftësi të shkëlqyera organizative dhe udhëheqëse,
- Njohja e punës me kompjuter, programe softuerike (aplikacione) që funksionojnë në kuadër të Ndërmarrjes.

Paga bazë: 677.57 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Orari: I plotë.

Vendi i punës: Mitrovicë (Regjional).

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Bënë menaxhimin e cilësisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor përmes analizimit të parametrevave të rregulluara me legjislacionin në fuqi për ujin e pijshëm;
- Mbikëqyrë punën e laborantëve dhe mostruesve në zbatimin e planit operacional dhe jep rekomandimet e nevojshme në sigurimin e cilësisë organizon dhe mbikëqyrë të gjitha punët që kanë të bëjnë me cilësinë e ujit që furnizohet përmes sistemit të ujësllësit i cili menaxhohet nga KRU Mitrovica në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë burimet e ujit, impiantet e trajtimit, rezervuarët, rrjetin shpërndarës deri të konsumatori;
- Menaxhon dhe është përgjegjës për punën e stafit i cili punon në marrjen dhe testimin e mostrave të ujit në laboratorin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik të KRU Mitrovica, ku përmes analizave të bëra konstatohet cilësia e ujit;

- Është përgjegjës për hartimin e Planit të Monitorimit Operacional i cili duhet të jetë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi për cilësinë e ujit të pijshëm (aktualisht nr. 10/2021 Për Cilësi të Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor) dhe në konsultim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike;
- Në bazë të planit operacional përcakton frekuencën e mostrimit dhe vendin e marrjes së mostrave të ujit në ITU dhe në sistemin e ujit;
- Kontrollon punën ditore për cilësi të ujit në ITU dhe në sistemin shpërndarës të ujit dhe përgaditë raporte të punës ditore dhe periodike;
- Kujdeset për sigurimin e kushteve optimale për punën e laboratorit përfshirë furnizimin me kohë të reagencave, mjeteve të punës, mjeteve mbrojtëse dhe paisjeve laboratorike;
- Merr pjesë në emër të KRU Mitrovica në takime, punëtori dhe forume tjera me pale relevante të interesit;
- Bashkëpunon ngushtë me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHP) si dhe institucionet tjera në adresimin e çështjeve dhe problemeve tjera lidhur me cilësinë e ujit të pijshëm përfshirë edhe Shoqatën e Ndërmarrjeve të Ujësllësit dhe Kanalizimeve (SHUKOS), Këshillin Ndërmarrës për Ujëra (KNMU), Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU) dhe njëherë zbaton rekomandimet e tyre;
- Bashkëpunon ngushtë me departamentin teknik (drejtorin teknik, menaxherat e impiantit dhe menaxherat e sistemit shpërndarës të ujit dhe të njësive operative të KRU Mitrovica) dhe jep rekomandimet e nevojshme profesionale për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm sipas standardeve të kërkuara;
- Kujdeset për gjendjen e sistemit shpërndarës të ujit dhe gjendjen e rezervuarëve akumuluese me ujë dhe jep rekomandimet profesionale dhe preventive në eliminimin e defekteve dhe shmangie të rreziqeve të vërejtura të cilat mund të ndikojnë në dëmtimin e cilësisë të ujit;
- Bashkëpunon ngushtë me të gjitha departamentet dhe njësit në nivel të Kompanisë;
- Merr masat mbrojtëse dhe paralajmëruese për mbrojtjen e burimeve të ujit (kufizimin e zonave mbrojtëse me rrethojë dhe vendosjen e shenjave paralajmëruese në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm aktualisht UA nr. 15/2017 për Kriteret për Caktimin e Zonave Sanitare të Burimeve të ujit);
- Monitoron gjendjen e zonave mbrojtëse të burimit, bën vlerësimin faktik të gjendjes ekzistuese dhe rekomandon masat që sipas nevojës duhet të ndërmerren;
- Siguron që kompania të zbatojë obligimet ligjore të përcaktuara në Ligjin për Ujëra, aktet nënligjore dhe aktet tjera normative sa i përket mbrojtjes së burimeve të miratuara nga institucionet përgjegjëse (Qeveria, Ministria e mjedisit etj);
- Bashkëpunon ngushtë me inspektoratin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe organet komunale për zbatimin e masave mbrojtëse për mbrojtje të burimeve të ujit;
- Monitoron gjendjen e mbrojtjes së zonës së furnizimit nga e cila furnizohet Impianti i Trajtit të Ujit dhe burimeve të sistemeve të vogla të cilat janë në menaxhimin e KRU "Mitrovica" sh.a. dhe sipas nevojës merr masat e duhura;
- Për punën që kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

III. Emërtimi i vendit të punës: Dozator.

Përgaditja profesionale: Shkolla e Mesme Teknike - Dega Kimi – Biologji.

Përvoja e punës: Së paku 1 vit.

Numri i kryesve: 1.

Paga Bazë : 446.69 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Orari: I plotë.

Vendi i punës: Mitrovicë (Regjional).

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat,
- Kryejnë të gjitha punët rreth dozimit të substancave kimike për pastrimin e ujit,
- Bënë përgaditjen e tretjes së Sulfat-Aluminit në koncentrimin e përcaktuara nga ana e Inxhinierit të procesit në rastet kur përdoret si koagulant,
- Bënë përgaditjen e tretjeve të polielektrolitëve anionik dhe kationik në aparaturat përkatëse,
- Varësisht nga kualiteti i ujit të patrajtuar merr vendim për dozimin e Klorurit-Ferrik apo Sulfat-Aluminit si koagulant,
- Në rastet e ndërrimit të koagulantit e ka për obligim që të përshtat sistemin e punës së pompave dozuese dhe valvulat e ndryshme sipas kërkesave teknike të koagulantit përkatës,
- Ka për obligim që të bëjnë dozimin e koagulantit sipas lartësisë së turbiditetit të ujit të patrajtuar,
- Bënë dozimin e klorit si mjet paraoksidues në para klorim dhe si mjet dezinfektues në klorimin përfundimtar,
- Dozimin e klorit e bëjnë në mënyrë proporcionale sipas rrjedhjes së ujit të patrajtuar dhe ujit të trajtuar, apo sipas kërkesës për vlerën e klorit rezidual,
- Sipas urdhërit të Inxhinierit të procesit përdor Ozonin ose Klorin si paraoksidues, e po ashtu përdor edhe Karbonin aktiv me rastin e paraqitjes së nevojës të përcaktuar nga analizat laboratorike,
- Kujdeset për ndërrimin e kontejnerëve me klor,
- Kujdeset për mirëmbajtjen dhe kalibrimin e sondës në aparaturën e Analizatorit të klorit rezidual,
- Është i obliguar që gjatë punës të përdor mjetet mbrojtëse në punë,
- Kontrollon mënyrën dhe kualitetin e koagulimit, flokulimit, sedimentimit si dhe filtrimit të ujit të trajtuar,
- Bashkëpunon me laborantin dhe s'bashku bëjnë korrigjime rreth përmirësimit të kualitetit të ujit,

- Bashkëpunon ngushtë me operatorin për të gjitha veprimet me ndikim në cilësinë e ujit,
- Mbanë shënime të qarta në fletoret e objekteve përkatëse për gjendjen e aparaturës dhe veprimet e ndërmarrura,
- Është i obliguar që pranimit-dorzimitin e ndërrimit ta bëjë në prezencën fizike të dozatorit të ndërrimit përkatës
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërimit të Udhëheqësit/es,
- Për punën që kryen i përgjigjet Inxhinierit të Procesit/es apo Menaxherit/es të Përpunimit të Ujit.

IV. Emërtimi i vendit të punës: **Operator / Dispiqer (ITU).**

Përgaditja profesionale: **Bachelor i TI (e preferushme), ose Shkolla e Mesme Teknike.**

Përvoja e punës: **Së paku 1 vit.**

Numri i kryesve: **2.**

Kushtet të veçanta:

- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe bashkëpunimi me Menaxhmentin e Kompanisë.

Paga Bazë: **464.26 Euro**, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Orari: **I plotë.**

Vendi i punës: **Mitrovicë (Regjional).**

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat,
- Operon me të gjitha pajisjet e procesit të trajtimit,
- Përmes sistemit të kontrollit SCADA operon me sistemin e pompave në stacionin e furnizimit,
- Operon me stacionin e pompave të ujit të trajtuar për mbushje dhe kontrollë të rezervuarit kryesor,
- Bënë balancimin hidraulik në hyrje dhe dalje të Impiantit,
- Bënë balancimin hidraulik ndërmjet niveleve në flokulator, sedimentues, fusha filtruese, rezervuarin e ujit të filtruar, rezervuarin e dozimit dhe kontaktit të Klorit me ujë, si dhe në rezervuarin mbledhës të ujit të trajtuar,
- Siguron sistemin e punës dhe shpejtësinë e filtrimit të ujit nëpërmjet filtrave,
- Operon me sistemin e tërësishëm për larjen e filtrave,
- Siguron balancimin hidraulik të rezervuareve të mbajtjes së ujit pas larjes së filtrave,
- Operon me sistemin e pompave të reciklimit të ujit pas larjes së filtrave
- Operon me sistemin e përzierësve në sistemin e koagulimit dhe flokulimit,
- Përcakton kohën e punës së mbledhjes së lymit në sedimentues, dhe siguron punën normale të mekanizmit mbledhës dhe sistemin e pompimit të lymit nga sedimentuesit,
- Operon me aparaturën e Gjeneratorit të Ozonit në rastin e përdorimit të Ozonit si paraoksidues,
- Operon me aparaturën e tërësishme të tharjes së lymit, siç janë: Aparatura për përgaditjen dhe dozimin e polielektrolitëve, Pompat e dozimit të lymit nga sedimentuesit e lymit, si dhe me Centrifugat tharëse të lymit,
- Operon me aparaturën e dozimit të Natriumhipokloritit në kordinim me dozatorin,
- Operon me aparaturën e dozimit të Karbonit aktiv në kordinim me dozatorin,
- Operon me sistemin e furnizimit të ujit brenda ITU-së,
- Operon me sistemin e furnizimit të ujit në stacionin e Klorinimit,
- Operon së bashku me dozatorin me aparaturën për përgaditjen dhe dozimin e polielkrolitit për trajtim të ujit,
- Ndihmon dozatorin në rastet e vështirësive në sistemin e dozimit të koagulantit,
- Ndihmon dozatorin me rastin e ndërrimit dhe kyçjes në punë të kontejnerit me Klor,
- Ndihmon dozatorin në testimin e aparaturës për neutralizimin kimik të Klorit,
- Shlyen alarmet e paraqitura në ekranet e operimit në të gjitha paisjet e procesit të trajtimit,
- Eliminon defektet e mundshme elektrike dhe mekanike sipas manualit ekzistues për operim, dhe manualeve të hartuara nga Inxhinierët përkatës,
- Udhëheqë ditarin e punës së dispeçerit dhe në te evidenton të gjitha ndryshimet dhe prishjet të cilat lajmërohen gjatë ndërrimit,
- Është i obliguar që çdo prishje të përshkruajnë detalisht në ditar dhe kohën e ndodhjes së defektit,
- Në ndërrim organizon punën për Laborant dhe Dozator,
- Nëpërmjet pompistit dhe sistemit SCADA kontrollon punën e të gjitha paisjeve elektromakinere dhe funksionimin e sistemit automatik në stacionin thithës,
- Në rast nevojë ndihmon dozatorin në përgaditjen e tretjes së Sulfat-Aluminit,
- Është i obliguar të dorëzojë dhomën e operimit në gjendje të pastër (gjendje e pastër higjienike),
- Është i obliguar që pranimit-dorzimitin e ndërrimit ta bëjë në prezencën fizike të operatorit të ndërrimit përkatës,
- Çdo vizitë e bërë në fabrikë jashtë personelit të fabrikës është i obliguar paraprakisht ta njoftoj përgjegjësin e tij,
- Gjatë punës është i obliguar që të mbajë mjetet mbrojtëse në punë,
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërimit të Udhëheqësit/es,
- Për punën që kryen i përgjigjet Inxhinierit/es të Procesit apo Menaxherit/es të Përpunimit të Ujit.

Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare apo diploma e shkollës së mesme (kopja duhet të jetë e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Kopja e letërnjoftimit.

Mënyra e aplikimit:

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.a. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>, si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike apo përmes emailit zyrtar: burimet.njerzore@kru-mitrovica.com
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.
- Konkursi do të jetë i hapur nga data **14.03.2023 deri me datën 28.03.2023.**
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranura të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.
- Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatët nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkangjesin dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtit nuk do të i nënshtrohen procedurës së rekrutimit.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "GRAND CAFFE" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810133603 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "GRAND CAFFE" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810133603 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "GRAND CAFFE" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810133603 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumessedetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Aulona Morina shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Dr. Xheladin Deda".

- "D.P.H.CITIZEN'S" shpall të pavlefshme arkën fiskale të biznesit D.P.H CITIZEN'S me NR. SERIK TE ARKES"GK03300576".

- Hetem Zeqiri shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Isuf Rama shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Arkitekt Sinani".

- Asllan Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 1 deri 8 ë shkollës fillore "Migjeni".

- Edona Përparim Nuza nga Gjakovashpall të pavlefshme diplomën e U.P. "Ukshin Hoti" në Prizren viti akademik 2010/2011 me nr. 58.

- Rinora Islami nga Mitrovica shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës, me nr. KO-33499/A-05-20, të lëshuar me datë: 02.06.2021 datë skadimit 02.06.2026.

- Rinora Islami nga Mitrovica shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Xheladin Deda" Mitrovicë.

- Hajrulla Sofiu nga Dragashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV të shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Edona Rezniqui nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi" Farmaci.

- Gëzim Maroshi nga Damjan kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh fillore "Hamez Cena" Damjan kk Gjakovë.

- Besfort Parashumti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues